

Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti VI (XX) - Nr. 24 (177) ISSN: 2305-655X

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJË | PSIKOLOGJË | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

24

2018

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI VI (XX) 2018, NR. 24 (177)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2018

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI VI (XX), korrik, gusht, shtator 2018 nr. 24 (177)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtore: Dorian Demetja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, dekan, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti European i Tiranës
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Pamje e xhamisë Burrel, 1939, foto Sh. Pici.

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al
www.zanimalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Kur'ani në kohën e sotme,
**Dr. Enes Kariç, Fakulteti i Studimeve Islame, Sarajevë,
Bosnje & Hercegovinë5**
2. Nevoja e ringjalljes së trashëgimisë intelektualo-shpirtërore,
MA. Ervis Jangulli20
3. Koncepti i reformës në Islam,
Haki Sahitaj, KU Bedër29

Studime

4. Mevlana Xhelaluddin Rumi - Simbol i dashurisë (I),
MA. Dorian Demetja, KMSH36
5. Një analizë e veprave të Hoxhë Hasan Tahsinut,
Burbuçe Meta, KU Bedër46
6. Analiza e artikujve të Salih Vuçiternit në revistën “Zani i Naltë”,
Zamira Islami, KU Bedër54

Histori

7. Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909),
**Syrja bej Vlora, pjesa e II-rë,
editor Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA.....63**

Përkthime

8. Es-Sarahsi, Shems‘ul-eimmeh (Dielli i dijetarëve),
Dr. Osman Taştan86

Personalitet

9. Sheh Ibrahim Karbunara100

Retrospektivë

10. Nisjativa te reja për bashkëpunim midis feve (Pjesa e parë)102

11. Abstracts in English108

12. Rregullat e shkrimit114



Kur'ani në kohën e sotme

Dr. Enes Kariç
Fakulteti i Studimeve Islame, Sarajevë,
Bosnje e Hercegovinë

Abstrakt

Metoda tradicionale e komentimit dhe e interpretimit të mendimit kuranor nuk mund të kishte vlerë të përbershme. Ajo ka qenë e përcaktuar dhe e kushtëzuar nga rrethanat e atëbershme. Përpunimi i parë, komentimi dhe zbatimi i mendimit kuranor, edhe në qoftë se do të ishin më adekuatë, megjithatë, ata do të duhej të llogarisnin natyrën dhe nivelin e shoqërisë së atëbershme. Kush mund të pohojë se për mendimin kuranor, që është i rëndësishëm për të gjitha kohërat, për të gjitha vendet dhe situatat, mund të thuhet se ishte formulim i natyrshëm, që do të ketë rëndësi për gjithë kohërat. Një pohim i tillë do të ishte plotësisht absurditet. Çdo moment historik merr nga Fjala e Zotit aq sa i dubet në momentin e dhënë, sipas nivelit të zhvillimit të jetës.

Çdo gjeneratë dubet të japë kontributin e vet për përpunimin e mendimit kuranor, aq sa dëshiron të jetojë me frymën e tij dhe të kërkojë tek ai zgjidhjen e çështjeve që jeta ofron, e cila është dinamike, e, sipas kësaj, në ballafaqimet e përbershme me probleme të reja dhe me dilema shumë të koklavitura.

Metoda tradicionale e komentimit dhe e interpretimit të mendimit kuranor nuk mund të kishte vlerë të përbershme. Ajo ka qenë e përcaktuar dhe e kushtëzuar nga rrethanat e atëbershme.

Përpunimi i parë, komentimi dhe zbatimi i mendimit kuranor, edhe në qoftë se do të ishin më adekuatë, megjithatë, ata do të duhej të llogarisnin natyrën dhe nivelin e shoqërisë së atëbershme. Kush mund të pohojë se për mendimin kuranor,

që është i rëndësishëm për të gjitha kohërat, për të gjitha vendet dhe rastet (ndodhitë), mund të thuhet se ishte formulim i natyrshëm, që do të ketë rëndësi për gjithë kohërat. Një pohim i tillë do të ishte plotësisht absurditet. Çdo moment historik merr nga Fjala e Zotit aq sa i duhet në momentin e dhënë, sipas nivelit të zhvillimit të jetës.

Gjeneratat e para e kuptonin, e komentonin dhe e përpunonin Kur'anin sipas kërkesave dhe mundësive vetjake. Për rrjedhojë, kuptimet e tilla, edhe në rast se ishin të paprekshme në kohën e vet, dhe njëherazi të përshtatshme, nuk mund të ishin të rëndësishme përgjithnjë dhe as mund të gjykohen si një formulim a përpunim i natyrshëm i mendimit islam.

Çdo gjeneratë duhet të japë kontributin e vet për përpunimin e mendimit kuranor, aq sa dëshiron të jetojë me frymën e tij dhe të kërkojë tek ai zgjidhjen e çështjeve që jeta ofron, e cila është dinamike, e, sipas kësaj, në ballafaqimet e përhershme me probleme të reja dhe me dilema shumë të koklavitura.

Ekziston edhe një fakt tjetër, i cili, në një masë të madhe, e ka anashkaluar metodën e komentimit tradicional. Për shembull, vetë tradita nuk ofron përherë garanci të plotë autentike. Ekziston pohimi i pakundërshtueshëm se në përkthim janë futur shumë gjëra të pasigurta, të gënjeshtërt, madje edhe gjëra të

shtuara me vetëdije. Janë të njohur autorët (muhadithët-hadithologët) që kanë zbuluar futjen e një numri të madh të haditheve të trilluara (meudu). Për këtë flet më mirë fakti që Buhariu nga 600.000 mijë hadithe, ka zgjedhur vetëm 5-6 mijë si autentike (të vërteta), të cilat i ka shënuar në koleksionin e vet të famshëm. Të gjithë të tjerët i ka konsideruar si të pasigurt.

Në rrugë të ndryshme, në mënyra të ndryshme dhe për motive të ndryshme, janë bërë komentime jo të sakta. Këtu, padyshim, ka pasur edhe motive me qëllim të mirë. Disa dijetarë janë sjellë me mjaft tolerancë ndaj përkthimeve apokrifine (vepër që gabimisht i atribuohet një autori), të cilat kishin si qëllim nxitjen e kurajës të një cilësie pozitive për një punë të mirë, respektivisht shmangien nga vepra e keqe (tergib dhe terhib). Të tjerët kanë futur hadithe të gënjeshtërt, që të argumentojnë pikëpamjet e veta. Këtë e bënin zakonisht përfaqësuesit e fraksioneve të ndryshme të deformatuara; pra kishte ndërhyrje armiqësore. Kjo është e ashtuquajtura “israilijat” dhe “nesranijat”. Disa komentues, për fat të keq, janë sjellë në mënyrë shumë të butë me këtë lloj përkthimi. Komentimi i Ibn Hazmit është plot me përkthime të tilla. Më tepër do t'i përshtatej emërtimi rrëfime fantastike sesa tefsir (koment). Aty do të gjeni çudira dhe tregime të pabesueshme, baza e të cilave është Bibla. Pikërisht për këtë, në mjediset

e zakonshme, është lexuar me endje dhe është botuar në një tirazh më të madh. Pikërisht për këtë shkak është kritikuar ashpër Kajroja, e sidomos Ez'heri, që e lejuan dhe e mundësuan këtë.

Komentimi tradicional është e qartë se ka filluar me një zhvillim të rezervuar të mendimit islam. Ai këtë mendim e ka mbajtur në nivelin e tij fillestar. Më e keqja është se kjo ka mundësuar ndikimin e shumë absurditeteve tendencioze të huaja dhe mendimeve të huaja armiqësore. Në komentime të tilla, më së shumti kontradiktore, ka qenë e pamundur të zbulohet ajo që është e sigurt dhe ajo që mund të pranohet.

Metoda racionale prezantonte një hap të natyrshëm për komentimin e mëtejshëm të mendimit kuranor. Jeta zhvillohej dhe nxirrte probleme të reja për të cilat duhej gjetur zgjidhje. Metoda racionale mund ta plotësonte këtë kërkesë.

Nuk ishte e lehtë të kalohej nga komentimi tradicional në atë racional të Kur'anit, edhe nëse kushtet e impononte këtë. Përkushtimi dhe besnikëria e madhe e gjeneratave të para, në radhë të parë e gjeneratës së sahabeve dhe tabiinëve, dhe kultivimi i njëlloj "shenjtërie" ndaj tyre, kanë kontribuar, shpeshherë, negativisht për ato gjëra që u atribuoheshin atyre dhe nuk kanë lejuar asnjë lloj tërheqjeje nga ato që kanë thënë, sepse gjykohej se ato ishin fjalët e të Dërguarit të Allahut.

Çdo ndryshim ndiqet e shoqërohet nga vështirësitë dhe rezistencat. Njerëzit ruajnë me kujdes atë që kanë e më të cilën janë mësuar. Sipas ligjit të inercisë dëshirojnë të ruajnë gjendjen ekzistuese.

E ç'mund të themi kur flitet për ndryshimet që lidhen me Fjalën e të Madhit Zot? Këtu duhet treguar një kujdes shumë i madh. Dihet se një numër i madh i sahabeve është munduar të tregojë çdo gjë për komentimin e tekstit të Kur'anit.

Në përgjithësi kuptohet se komentimi *bir-re'ji*, për shembull, komentimi i bazuar në ixhtihad, me arsyetim dhe konkluzion vetjak, ka hasur në rezistencë dhe pengesa. Kur vjen çështja për Fjalën e Zotit, duhet treguar kujdes i veçantë. Që këtej, del si domosdoshmëri që t'u tërhiqet vëmendja atyre që duan ta komentojnë Kur'anin sipas mendimit të vet. "Komentimi i Kur'anit *bir-re'ji* është kufër (femohim)" (Men fesserel-Kur'ane bi-re'jii fekad kefere). "Kush e komenton Kur'anin *bir-re'ji* dhe e komenton drejt, përsëri gabon". (Men fesserel-Kur'ane bir-re'jii ve esabe fekad ahtae).

Me këtë duket sheshit se synohet të qëndrohet në vendnumëro dhe të mos mundësohet komentimi i papërgjegjshëm i Kur'anit që nuk bazohet dhe që del nga korniza e mësimave të Islamit. Është e qartë plotësisht se Fjala e Zotit nuk mund të kuptohet saktë dhe as të pranohet pa njohur thellë jetën. Me metodën

racionale duhet nënkuptuar shfrytëzimi i mjeteve shkencore, arritjet, zbulimet dhe qëllimet e njohjes së jetës, studimet dhe zbatimi i mendimeve islame. Kjo metodë nuk e mohon plotësisht komentimin tradicional. Kjo do të thotë pranim dhe vlerësim i traditës, por jo flakje (mohim) të saj. Procesi i komentimit të Kur'anit është zhvilluar me vazhdimësinë që nuk u ndërpre dhe e nuk u ndalua asnjëherë.

Autorët e parë të metodës rationale ekzegjeze vetëm sa e kanë hapur procesin, të cilin duhet ta vazhdonin, ta zhvillonin e ta zgjeronin më tutje, ta pasuronin me përvojën e arritur dhe ta përputhnin (përshtasin) me kërkesat e reja të jetës. Komentuesit e parë, duke i shërbyer kësaj metode, provuan që t'u japin përgjigje kërkesave të reja të kohës. Kjo vihet re qartë në veprat e tyre. Nuk është e rastësishme që të dominojnë çështjet e akaidit, mbrojtja e mësimëve të ehli-sunnetit, porositë e fikhut, rregullat e gjuhës, çështjet në disavantazh të tekstit kuranor (ixhazi), etj. Islami, në atë kohë (Raziu vdiq në vitin 606 hixhri, Bejdaviu 682..., Neseifu 710, Ebu Suudi 982), u ballafaqua me kuptime të ndryshme, me mendime dhe dilema, të cilat duheshin vlerësuar respektivisht, t'i pranonin ose t'i hidhnin poshtë. Procesi antikulturor ishte në rend të ditës. Ishte e domosdoshme të përcaktohej qëndrimi ndaj disa

shkollave të filozofisë helenistike, si për shembull ndaj shkollës perse, sidomos ndaj filozofisë së Zarathustras, themeluesit të Mazdeizmit. Islami u ballafaqua me mësimet e vjetra të Budizmit dhe Brahmanizmit, etj. Islami e qartësoi që në fillim qëndrimin ndaj politeistëve, hebrenjve dhe kristianëve për dispozitat kuranore, sepse në kohën e Shpalljes Hyjnore është ballafaquar me këto ideologji. Asokohe nuk kishte asnjë lloj dileme dhe as ndonjë paqartësi. Me politeistët nuk mund të kishte asnjë lloj kompromisi. Politeizmit, si formë besimi, i kishte kaluar koha, ishte vjetruar, pra ishte i destinuar të zhdukej, të shfarosej. Kristianizmin dhe Hebraizmin Kur'ani i quajti ehli-kitab, duke ua njohur statusin e ekzistencës dhe nxori porosi për këtë.

Përballja e mëvonshme me shfaqjet, lëvizjet dhe mësimet e ndryshme, kërkonte që të vendosej për vlerësimin dhe pozicionin e tyre, për mbajtjen dhe marrëdhënien ndaj tyre. Mendimi kuranor duhet të ishte vazhdimisht aktiv ndaj ngjarjeve jetësore. Ai duhej vazhdimisht të evidentohet ndaj formave të reja të jetës dhe mundësive të kuptimit njerëzor dhe vlerësimit të kërkesave. Nuk guxonte të mbyllej në një kuptim të caktuar, sepse ai shprehte një kërkesë të veçantë dhe mundësi në momentin e dhënë. Mënyra se si është kuptuar mendimi kuranor,

në një periudhë kohore, dhe se si është aplikuar sipas mundësive dhe kushteve e rrethanave të asaj kohe, nuk mund të jetë vazhdimisht e vlefshme për të gjitha kohërat. Mendimi i pashtershëm i Fjalës së Zotit zbulohet shkallë-shkallë, krahas zhvillimit të jetës. Prandaj, është detyrë e domosdoshme që kjo fjalë të mësohet vazhdimisht, të mësohet dhe kuptimi i saj të zbulohet paralelisht me zhvillimin e jetës.

Ç'është e vërteta, kjo është detyra kryesore e ekzegjesë si dituri e veçantë e Kur'anit. Është i pabazuar pohimi se autorët e hershëm (mufessirët) në ekzegjezë kanë thënë fjalën e natyrshme dhe se kësaj fjale nuk ke ç't'i shtosh, sikurse pretendon Nubehani. Sipas tij, çdo përpjekje për një interpretim të ri dhe përpunim të mendimit kuranor, paraqet një deformim të vrazhdë, madje edhe mohim të besimit islam (kufr). Duhet thënë se ky mendim është i prapambetur dhe i dëmshëm, sepse e mbyll mendimin kuranor vetëm në një kuptim të kushtëzuar me mundësi të përcaktuara, e, ajo që është më e rëndësishme, zvogëlon mundësinë dhe nuk u jep mundësi gjeneratave të mëvonshme që të njihen nga afër me Fjalën e Zotit, ta mësojnë e të jetojnë sipas saj. Kërkesa për komentim dhe përpunim të Fjalës së Zotit sot nuk është më e pakët se në kohën e kaluar, kur u përpunua dhe u pranua për herë të parë. Fjala e Zotit ndodhet në të njëjtën situatë.

Në përpunimin dhe pranimin e parë ajo u vendos në mundësitë e atëhershme, në hapësirën dhe kohën e përcaktuar, duke synuar rrjedhën e jetës sipas modeleve dhe mundësive të dhëna. Në komentimin dhe pranimin e parë asgjë nuk mund të ishte utopike, për shembull mbi mundësitë dhe kërkesat e momentit të dhënë mbi mundësitë e dhëna, kërkesat në një kohë dhe hapësirë të përcaktuar. Sipas kësaj, ky përpunim dhe pranim ka qenë i kufizuar në një kohë të përcaktuar. Nuk mund të ishte e vlefshme përjetësisht. Për fat të keq, kështu ka ndodhur, që këtij përpunimi t'i jepej, me çdo çmim, një vlerë e përjetshme. Këtu njerëzorja ka fituar statusin hyjnor. Kuptimi njerëzor, që ishte i kufizuar, i kushtëzuar dhe i determinuar nga kërkesat dhe mundësitë e momentit e ka ndryshuar Fjalën e Zotit. Ai fitoi statusin e paprekshmërisë dhe të pacenueshmërisë.

Kështu, Fjala e Zotit u gjend para një përpunimi të ri e të pashmangshëm. Përpunimi i hershëm ka qenë i mbisunduar dhe frenues i zhvillimit të mendimit kuranor, duke u mbyllur kështu në format e tejkaluara. Ai tashmë nuk mund ta paraqesë Islamin, i cili, në këtë sferë, ka pësuar një dëm të rëndë.

Situata e sotme është jashtëzakonisht e përshtatshme, sepse ajo na ofron të gjitha mundësitë nga ky zhvillim bashkëkohor që

të kalojmë te përpunimi i ri. Ne tashmë kemi mundësi të shumta që të kuptojmë më thellë, më gjerë e më qartë shumë probleme, ide, shfaqje të ndryshme, ngjarje dhe procese që përmend Kur'ani krahasuar me gjeneratat e mëparshme. Nuk mund të nënvlerësojmë komentuesit (mufessirët) e hershëm, filozofët dhe teologët myslimanë, për këtë arsye apologjetët, të cilët në mënyrën e vet, sipas mundësive ekzistuese, trajtonin çështjet materiale (hejula), atomin (dherretun), zëvendësimin e natës me ditën (ihtilafull-lejli uen-nehar), krijimin e qiejve e të Tokës (halkus-semuati uel-erdi), ekzistencën e njeriut dhe shpirtit të tij, misionin e njeriut në tokë (halifetull-llahi fil-erdi) etj.

Ne sot mund ta vëzhgojmë më thellë principin “shura” nëpërmjet sistemeve të ndryshme për kërkimin e së vërtetës, princip që inicion të drejtën për pjesëmarrjen dhe vendimin vetjak për të ardhmen. Principi i zekatit, gjithashtu inicion synimin e përhershëm për vënien e së drejtës sociale, të barazisë ndërmjet gjithë njerëzve dhe kapërcimin e dallimeve klasore, të cilat kanë provokuar përleshjet më të mëdha historike. Detyra për faljen e namazit inicion një element jashtëzakonisht kuptimplotë në jetën e njeriut pa të cilin ai nuk mund të vërtetojë dhe argumentojë ekzistencën e vet. Bëhet fjalë për vlerat etiko-morale e shpirtërore me të cilat njeriu fitoi

statusin njeri. Këto vlera e bëjnë njeriun, njeri. Këto e kanë dalluar nga kafshët. Me këto vlera ai (njeriu) ka fituar vlerat më të mëdha.

Të gjitha këto vlera jeta sot i ka vendosur në plan të parë dhe i aktualizon në maksimum. Janë vendosur dhe zhvilluar sisteme, sidomos filozofike, politiko-shoqërore e ekonomike, të cilat i kanë vënë detyrë vetes që t'i sendërtojnë (t'i vënë në jetë) këto vlera. Për këtë arsye, është e domosdoshme të bëhet një interpretim i ri i Fjalës së Zotit, ku do të zbulohet ajo që ofron në këto momente dhe vlerat e përgjithshme që u përmendën më lart, të cilat e thellojnë edhe më tepër kërkesën e domosdoshme të ekzistencës njerëzore. Jeta sot kërkon doemos që të kalohet në një aspekt të ri të komentimit të Fjalës së të Madhit Zot. Komentimet e mëparshme, pa dyshim, kanë mbërritur deri te ne me modelet dhe kërkesat e jetës dhe nuk mund të gjykohen si mendime adekuate të Kur'anit, p.sh. si të tilla që i ofron sot njeriut.

Në botën islame gjithnjë e më tepër po piqej ky mendim. Atë e ka shprehur më fuqishëm Xhemaludin Afgani, Shejh Muhamed Abduh dhe më vonë një numër i madh i mendimtarëve të shquar, shkencëtarëve dhe autorëve në tërë botën. Ky mendim zgjerohej gradualisht, gjente dhe bënte për vete mbrojtësit e vet.

Procesi i kalimit të ri për të mësuar dhe zbuluar mendimin kuranor, që vazhdon ende, nuk është aspak i thjeshtë. Komplikimi i tij vjen që nga zanafilla dhe zhvillohet në një moment jashtëzakonisht të ndërlikuar. Myslimanët, në mënyrë të hapur, ndodhen gjithnjë e më tepër në kthesën dhe udhëkryqin delikat. Ajo që është më karakteristike, por edhe më fatalja, është çështja e daljes nga një situatë e mbyllur, nga një situatë e tërheqjes në vetvete, në një botë të re, të cilën e kanë rregulluar të tjerët sipas traditave të veta, sipas kuptimeve të veta, sipas principeve vetjake dhe e kanë përshtatur sipas interesave të veta. Përndimi gjatë historisë e ka goditur dy herë Islamit duke provuar që t'u imponojë myslimanëve këndvështrimin e vet ndaj botës. Prandaj, duke pasur kujdes për trajtimin e temës, ne na intereson një provë tjetër që njihet me emrin kolonializëm. Krahas të mirave materiale, kolonializmi, sigurisht, i ka hapur dyert botës islame, që të hyjë në botën e re dhe të mundohet t'ia imponojë këtë botë me synimin që të sigurojë eksploatimin për një periudhë të gjatë në botën islame. Ai nuk është kënaqur vetëm me shfrytëzimin dhe plaçkitjen, por dëshiron që të robërojë edhe shpirtat njerëzorë, duke imponuar mënyrën e vet të jetesës, botëkuptimin dhe vlerat e veta. Këtë e ka bërë në mënyra të ndryshme.

Zgjimi i ri në botën islame dhe lëvizja për ringjalljen e mendimit islam, të cilët ekzistojnë dhe zhvillohen në rrethane të tilla, nuk mund të kuptohen e të mbeten pa u pasqyruar në to gjurmë të sigurta të përpjekjeve që u përmenden.

Dr. Muhamed Behiji te zgjimi i ri dhe ringjallja e mendimit islam, zbulon dy tendenca bazë: e para është properëndimore, e cila qëndron te mendimi i vet për të ndikuar direkt mendimin e vet dhe e gjykon me modelin e vet. Tendenca e dytë është ajo që i kundërvihet kolonializmit dhe synon që të çlirohet nga trysnia e mendimit evropian dhe nga eurocentrizmi. E para, në krye të së cilës qëndronte Ahmed Khan nga India, e më vonë Mirza Gulam Ahmedi, quhej *texhdid*, ripërtëritja e (Ittixhahu t-Texhdid), kurse e dyta, që udhëhiqej nga Sejjid Xhemaludin Afgani dhe Shejh Muhamed Abduh quhej “El-Ittixhah-el-Islahi” ose “Ittixhah tashih el-mefahim - rregullimi i kuptimeve të gabuara”. Të dyja lëvizjet, lëvizja e Ahmed Khanit dhe lëvizja e Xhemaludin Afganit dhe Sheh Muhamed Abduhus janë shfaqur nga gjysma e dytë e shekullit nëntëmbëdhjetë.

Lëvizja e Ahmed Khanit dominohet plotësisht nga mendimi dhe interesat perëndimore, e ky dominim, i ndërgjegjshëm apo jo, i qëllimshëm ose jo, ka qenë në shërbim të kolonializmit. Ka qenë plotësisht e natyrshme dhe në zhvillimin

shpirtëror të shoqërisë që më i forti dhe më i zhvilluari të sundojë mbi të dobëtin dhe të pazhvilluarin. Kjo vërtetohet me rregullin social që e zbuloi Halduni (El-maglubu muleun bi ma indel-galibi). Perëndimi, siç e theksuam, në këtë progres shkencor, teknik, material dhe kulturor me të vërtetë ka shkëlqyer dhe ka verbuar shumicën. Nuk e di se sa mund të pohohet dhe vërtetohet që Ahmed Kahni dhe të tjerët si mercenarë dhe tradhtarë kanë qenë të ndërgjegjshëm në shërbim të kolonizatorëve. Është më e besueshme që, për hir të kompleksitetit të vlerave më të pakta, kanë qenë të rrëmbyer nga mendimi evropian dhe e kanë marrë atë si model për mendimet e veta. Kjo shihet më qartë te komentimi i Kur'anit nga Ahmed Khani ku ai ka punuar që nga 1880 deri në vitin 1890. Aty ndikimi i mendimeve laiko-pozitiviste, madje edhe materialiste, shprehet plotësisht. Ai përpiqet që mendimin kuranor t'ia nënshtrojë kuptimit dhe përvojës perëndimore. Mashtrimet duken sheshit me dimensionet e kësaj toke, me të cilët, përsëri, që është shumë më e rrezikshme dhe që të çon te synimet e pasojave, identifikohet me historinë njerëzore dhe ndryshimet e saj. Askush nuk mund ta mohojë se mendimi kuranor duke ardhur me anën e Shpalljes, kalon te fjala, fiton dimensionin tokësor dhe bëhet pjesë e aspektit të botës dhe vendoset në hapësirën dhe kohën e përcaktuar.

Por ajo me këtë nuk e humbet dimensionin e lartë jashtëtokësor, atë Hyjnoren, që qëndron mbi të gjitha kohërat dhe hapësirat dhe që nuk u nënshtrohet ndryshimeve.

Ahmed Khani, sipas tërë gjykimeve, te komentimi i mendimit kuranor nuk e përfill dhe nuk e merr në konsideratë këtë dimension bazë. Me sa shihet, e bën këtë, siç shprehet Xhemaludin Latiçi, qëllimisht, me synimin që të manipulojë sa më mirë me Islamin.

Në vargum e anëtarëve të revistës “El-Uruetul-Uthka”, e cila bashkë me Sheh Muhamed Abdahun ka botuar në Londër në veprën “Er-Red-du aled-Dehrijin” Xhemaludin Afganiu ka zbuluar mjaftueshëm rolin e dyshimtë të Ahmed Khanit. Komentimi i tij kuranor flet më mirë për këtë gjë. Ai është plot përdhosje, ndryshime të teksteve kuranore. Baza e tij, duke qenë në përputhje me rolin e tij karrierist, është përpjekur të zvogëlojë kuptimin e Islamit si faktor në jetën e myslimanëve. Fuqitë koloniale e dinin fort mirë se Islami është një forcë që i bashkon dhe i drejton myslimanët, prandaj duhej përçarë dhe çliruar me çdo kusht nga kjo fuqi. Ahmed Khani e mori këtë rol dhe u përpoq ta arrinte, duke iu dorëzuar plotësisht udhës për revizionimin e mendimit kuranor. Në përpjekjen e ashtuquajtur për njësimin e të gjithë religjioneve, ai, në fakt, i mohon ato dhe fton braktisjen e tyre, duke pohuar hapur, me qëllim

që të mashtrojë myslimanët, se sekreti i përparimit të Evropës qëndron te shmangia e ndikimit të religjioneve. Krahas të tjerave, ka mohuar shpalljen dhe Dërgesën si dukuri e mbinatyrshme. Ka mohuar detyrën e ixhtihadit dhe i ka dhënë komentim arbitrar.

Duke luftuar në Indi më 1879, Afgani në revistën e përmendur, ka pranuar se disa njerëz fjalëmirë dhe mendjelehtë kanë shkruar pas Ahmed Khanit dhe kanë pranuar synimet e tij të gabuara dhe qëllimkëqija. Si përgjigje dhe paralajmërim për mashtrimet e Ahmed Khanit shkroi veprën e përmendur “Er-Redu aled-dehrijjin”, që është botuar në dy gjuhë; urdu dhe perse. Më vonë Sheh Muhamed Abduhu e ka përkthyer në gjuhën arabe.

Motivitet politik për sjelljen e Ahmed Khanit, ideve të tij dhe përcaktimeve thelbësore, mund t'i shtohet si alternativë edhe një motiv tjetër. Problemi i kuptimeve të tij të pasakta, mund të vërehet edhe nëpërmjet marrëdhënies së tij me shkencën. Ai, pa dyshim, është anëtar i pozitivizmit, që redukton diturinë shkencore në përvojën e thjeshtë, e cila mund të verifikohet në mënyrë empirike duke vëzhguar çështjet e mendimit, thelbin e gjërave, substancat, vlerat etj., me absurditet. Një metodë e tillë te kalimi i komentimit të Kur'anit është krejtësisht e pasaktë. Kur'ani nuk mohon faktet dhe as kuptimin e

dijeve të sakta. Ai u jep atyre një rol dominues në sferën e vet ku është plotësisht i përcaktuar sipas dukurive, proceseve dhe ndodhive. Faktet janë vetëm manifestime dhe shenja të thelbit (ajete) që qëndron “pas” dhe “qëndron” jashtë tyre ku mund të gjejmë vetëm një përgjigje “përse”, por jo si, për të cilat, përgjigjen diturite ekzakte. Kur'ani, me dimensionin e tij të madh e mbitokësor, depërton barrierën e pozitivizmit dhe mundëson të kuptuarit e çdo gjëje që ekziston dhe vëzhgimin e thelbësore.

Gabimet e Ahmed Khanit, në këtë aspekt, nuk kanë qenë të vetmet. Të tilla lajthitje mund të thuhet se ka pasur thuajse në të gjithë hapësirën islame. Për të gjithë mendimi evropian ka qenë model e që nuk duhej ta dramatizonin më tepër. Duke e vështruar këtë çështje duhet të kishim parasysh një kërkesë mjaft të ndjeshme për të lëvizur më përpara. Qëndrimi në vendnumërim shekullor ka fituar njollën e “turpit të madh”. Duhej lëvizur dhe shkruar më tej. Nuk mund të pritej më. Gjeneratat e reja nuk mund të frenoheshin dhe të mbaheshin në pasiguri. Në këtë kohë, fatkeqësisht, nuk kishte kush t'i drejtonte, t'i orientonte dhe t'u tregonte për vlerat e veta. Përfundimi, ndërkohë, ofronte çdo gjë, por në mënyrën dhe për interesin e vet. Ai shfrytëzonte vakumin ekzistues dhe impononte mendimin e vet, e, jo vetëm politikën, por edhe këndvështrimin, vlerat dhe sjelljen e vet.

Ahmed Khani ka qenë produkt i kësaj situate. I dukej se mendimi dhe përvoja e Perëndimit i ofronin shumë më tepër se tradita e vet, për të cilën dinte shumë pak dhe që në tradhtinë e vet të fundit i dukej shumë primitive. Kuptimi i tij, pavarësisht nga kjo, ka qenë i motivuar nga qëndrimi vetjak në shërbim të kolonializmit apo përcaktimit të sinqertë për mendimin perëndimor dhe bazuar nga kjo bindje, mund të vështrohen, vlerësohen si pikënisje edhe shfaqja dhe lëvizja e Kadianizmit. Kjo lëvizje e deformuar në të dy degët e saj, ka shkuar edhe më tutje në largimin nga mësimet islame dhe vendosjen e plotë në shërbim të Perëndimit si bartës i kolonializmit. Mirza Gulam Ahmedit, themelues i Kadianizmit, nuk nguron aspak që të shpallet zyrtarisht se ka qenë në shërbim të kolonializmit. Mund të konkludohet me krenari e mund të thuhet: “...që pjesën më të madhe të aktivitetit të jetës sime e kam kaluar duke ndihmuar dhe përkrahur plotësisht politikën e shtetit anglez. Kam shkruar dhe kam publikuar kaq libra për ndalimin e xhihadit (luftës) dhe për detyrimin e plotë ndaj nënshtrimit dhe besnikërinë për drejtuesit anglezë, saqë mund të mbusheshin dhjetë biblioteka”. Të gjithë këta libra janë publikuar në vendet e botës islame: Egjipt, Siri, Palestinë dhe Afganistan. Ky nuk është i vetmi gabim i Mirza Gulam Ahmedit. Ai shprehet hapur se është mishërim i Isait dhe i Muhamedit a.s. dhe që, sipas kësaj, edhe ai është i dërguari i Zotit.

Pa hezitim pohon se ai merr Shpalljen Hyjnore. Kalifi i tij i dytë Mirza Beshir Ahmedit pohon se Mirza Gulami është më i preferuari dhe më i përzgjedhuri i gjithë të dërguarve të Zotit, madje edhe se i më të mëdhenjve (ulul-azm). Dhe më tutje pohon se nuk ekziston asnjë ndryshim ndërmjet shokëve të Mirza Gulam Ahmedit dhe shokëve (sahabeve) të Muhamedit a.s. Ndryshimi i vetëm qëndron se disa ishin shokë të të dërguarit të parë, ndërsa të dytët të të dërguarit të dytë. Në të vërtetë, - thonë ata, - Mirza është Muhamedi siç thuhet në Kur’an: “...emrin e ka Ahmed” (ismuhu Ahmed, Saf 6/4). Ai pohon se Isai a.s. pas vdekjes imagjinare ka shkuar në Kashmir të Indisë, ku ka përhapur mësimet e veta dhe ka vdekur në vitin 120 të jetës së vet. Varri, siç thonë, ndodhet akoma atje. Sipas komentimit të tyre, xhihadit përjashton çdo përdorim force, nuk duhet të luftojnë duke përdorur forcën për çlirimin e tyre.

Këto dhe gabime të ngjashme me to, kanë ardhur deri te shprehjet për përkthimin dhe komentimin e Kur’anit. Më i njohur është përkthimi i Muhamed Aliut në gjuhën angleze i publikuar në vitin 1920. I njëjti autor ka publikuar librin me titull “Islam”. Përkthimi dhe komentimi i tij është përkthyer në gjuhën turke (Omer Riza) dhe nga turqishtja në serbokroatisht nga Panxha Çausheviç.

Te ne, në bashkësinë tonë islame, ky përkthim ka provokuar polemika serioze dhe kundërshtime justifikuese. Në botimin e dytë u hoqën disa pjesë të komentimit. Më në fund, e tëra kjo, për publikun tonë është bërë e njohur. Kadrijanitë ekzistojnë me këtë emër ose me emrin Ahmedij, të cilët veprojnë akoma, edhe pse me Kushtetutën Pakistaneze janë shpallur grup i përjashtuar nga Islami. Ata janë shumë aktivë në Evropë. Bashkësia Islame në Jugosllavi deri tani ka qenë e imunizuar nga ndikimi i çfarëdoshëm i këtij sektori. Ndërkohë, duhet pasur kujdes, që punonjësit tanë, anëtarë të Bashkësisë Islame, gjatë punës së përkohshme jashtë shtetit, të mos bien nën ndikimin e tyre. Për parashikime të tilla ekzistojnë supozime të justifikuara.

Pionierët e zgjimit të vërtetë islam, rimëkëmbin mendimin islam dhe kalojnë te mësimi i Kur'anit: Xhemaludin Afgani, Sheh Muhamed Abduhu, Dr. Muhamed Ikbali dhe të tjerët janë përballur gjatë punës së tyre me pengesa të mëdha. Ata duhet të luftonin në shumë fronte. Të gjithë ata qenë përballur me fuqitë kolonialiste, të cilat në këtë apo në atë mënyrë synonin pakësimin, madje edhe dobësimin e ndikimit islam duke bashkëpunuar me forcat konservatore të vetë mjediset islame dhe me grupet sektare kolonialiste. Por, duket sikur janë ndarë, ose nën ndikimin e rrethanave, u janë dhënë detyra të veçanta.

Xhemaludin Afgani, siç e kemi theksuar, është ballafaquar më ashpër me lëvizjen e Ahmed Khanit. Vepra e shkruar, që ka lënë pas vetes, ka lidhje me këtë fraksion, me zbulimin dhe demaskimin e tij.

Sheh Muhamed Abduhus i ka takuar rolin, krahas të tjerëve, i ballafaqimit me orientalistët, të cilët janë përpjekur që të justifikojnë teorikisht kolonializmin dhe ta përjetësojnë, duke imponuar mendimin e Perëndimit dhe duke nënvleftësuar mësimet islame, vlerat e tij dhe tërësinë e trashëguar shpirtërore. Janë të njohura polemikat e tij me Hanutin, kontaktet personale dhe diskutimet me filozofin Renan, i cili gjatë predikimeve të tij në Sorbonë të Parisit, në mars të vitit 1883 nën titullin "...Islami dhe shkenca", ka pohuar se Islami pengon zhvillimin e mendimit njerëzor.

Ai ka sjellë si argument besimin të mrekullia (mu'xhize), fatin (kada ue kader) dhe gjërat e natyrës së fshehtë (gajbijat). Këtij përkthimi iu kthye edhe Afgani kur ishte me banim në Paris në të njëjtin vit. Përgjigja e tij u publikua në "...Journal des debats". Sheh Muhamed Abduhu në përgjigjen e tij ka sqaruar pa mëdyshje se konkluzionet e Renanit bazohen në paraqitjet e gabuara plotësisht dhe në mosnjohjen e mësimëve të Islamit.

Dr. Muhamed Ikbali është përballur me kohë me Kadrijanitë më parë se kushdo tjetër.

Ai ka luftuar më fort kundër gabimeve të tyre. Më vonë këtë qëndrim e kanë mbajtur edhe Meududi dhe Hasan Nedeviu. Në veprën e vet të njohur “Bazat e fesë islame” (Reconstruction of Religious in Islam) flet për metodat dhe mjetet e kësaj rimëkëmbje, duke kundërshtuar në këtë mënyrë te Kadijanitë çdo rol të rimëkëmbjes.

Këto kanë qenë role të posaçme e të njëjta të këtyre pionierëve të parë për rimëkëmbjen e mendimit islam. Roli i tyre i përbashkët për trasimin e orientimit të ri e të njëjtë në fushën e komentimit bashkëkohor të mendimit islam kërkon vëmendje të veçantë. Këtë do ta zbulojmë më mirë dhe më bukur te veprat e Sheh Muhamed Abduhus. Këtë ai e ka shprehur në mënyrën më të saktë dhe të pakundërshtueshme sidomos te komentimi i vet i Kur’anit, të cilin e ka botuar nxënësi i tij i denjë, korrekt e besnik, Reshid Ridai. Për forcimin dhe zgjerimin e lëvizjes për rimëkëmbjen e mendimit islam, për ndreqjen e gabimeve dhe kuptimeve, Reshid Ridai ka bërë shumë. Roli i tij në këtë aspekt është i paçmuar. Te mësimet e pionierëve për ripërtëritjen islame, mendimet e tyre, jeta dhe mundësitë, vepra e Reshid Ridasë “Tarihul-Ustadhil-Imam el-Shejh Muhammed Abduhu”, paraqet një burim të çmuar. Neve, para së gjithash, na intereson metoda e Sheh Muhamed Abduhus për kalimin

tek interpretimi i ri i mendimit islam për mësimin e Kur’anit. Ai e ka shpjeguar këtë më së miri kur thotë se misioni dhe qëndrimi i tij mund të përmbliidhen në dy detyra: Çlirimi i mendimit nga çdo sjellje steriliteti, fishkjeje dhe kuptimi i Islamit në mënyrën e kuptuar gjeneratat e kaluara para përçarjes dhe fraksioneve.

Sipas kuptimit të Sheh Muhamed Abduhus, të mësuarit e Fjalës së Zotit duhet të synojë zbulimin e asaj që ajo ofron ne dhe kohës sonë lidhur me kërkesat dhe mundësitë tona. Ne nuk mund dhe nuk duhet të kënaqemi me atë që kanë zbuluar gjeneratat e para. Pengesa më e madhe në këtë rrugë ka qenë “taklidi” dhe, si pasojë e kësaj, ndalimi i ixhtihadit. Me këtë është bërë i pamundur zhvillimi i mëtejshëm i çdo lloj mendimi islam. Sheh Muhamed Abduhu e ka qëmtuar më mirë, e ka përjetuar më fort dhe më thellë këtë. Që këtëj burojnë thirrjet e tij të forta për krijimin e mendimit të lirë dhe njëherazi çlirimin e plotë nga taklidi. Njeriu duhet të shfrytëzojë arsyen, sepse kjo është dhurata më e madhe e të Plotfuqishmit dhe me këtë e ka dalluar nga krijesat e tjera, duke i vënë në dispozicion gjithçka që është në tokë dhe në qiej, duke i caktuar rolin e zëvendësit të vet mbi tokë (kalif). Për këtë arsye ai mundi ta marrë përsipër amanetin, të cilin e refuzuan qiejt, toka dhe malet.

Një rol të tillë jetik Kur'ani ia cakton çdo myslimani. Realiteti mysliman me të cilin është ballafaquar Sheh Abduhu paraqet kundërshtinë e plotë me të gjitha këto. Duhet kuptuar plotësisht reagimi i tij i ashpër dhe gjykimi i këtij realiteti, i cili nuk kishte asgjë të përbashkët me Islamin. E tëra ajo ishte e drejtuar te vdekja, izolimi i plotë nga jeta, sjellja pasive ndaj jetës, dorëzimi i fatit (teuakul), vuajtja, toleranca ndaj çdo të keqeje pa iu kundërvënë (sabar) dhe pajtimi me çdo gjë që ndodh (kada dhe kader), gjë që në tërësi paraqet mohimin e plotë të mësimave islame.

Kërkesa themelore e tij është që Islami të kuptohet si mendim i gjallë dinamik, që është i hapur dhe që i ofron jetës aq sa i duhet në momentin e dhënë dhe sa i aftë është myslimani që të zbulojë, hulumtojë në të, duke i shërbyer kështu gjithë mjeteve dhe arritjeve bashkëkohore.

Nuk është aspak e çuditshme që kuptime të tilla rezistonin në kohën e Sheh Muhamed Abduhus. Sheh Ulejsi (rektori i atëhershëm i Ez-herit) pranoi mësimet e Sheh Muhamed Abduhus. Për më tepër, por jo në atë masë, ekzistojnë rezistenca të përcaktuara. Pak kohë më parë, Dr. Abdulhalim Mahmudi, rektor i Ez-herit iu nënshtrua disa mendimeve të Abduhus dhe Ikbalit.

Procese të tilla dhe mospajtimet në procesin e zhvillimit të mendimit njerëzor janë plotësisht normale dhe të domosdoshme. Ne nuk do t'u

kthehemi atyre kur bëhet fjalë për mospajtim të zakonshëm. Duhet pak më tepër vullnet, besim reciprok dhe vështrim më objektiv që mospajtimi të shmanget. Ai që ka qëllim të mirë, e ka plotësisht të lehtë të zbulojë se cili është nënteksti i fjalëve përshtatje, vendosje dhe interpretim i ri. Është plotësisht arbitrare, e gabuar dhe qëllimkeq të mendosh se bëhet fjalë për ndryshimin dhe revizionimin e mësimave islame. Këtu bëhet fjalë për ndryshimin e mendimit njerëzor, për paraqitjen e njerëzve që kanë mbijetuar dhe ku mendimi islam është mbyllur dhe ngurtësuar. Sheh Muhamed Abduhu dhe bashkëpunëtorët e tij janë përpjekur që të japin ndihmesën e vet për çlirimin e këtij mendimi. A mund t'ua mohojë njeri këtë të drejtë?

Nuk mund të pohohet që në vazhden e mëtejshme të procesit të rindërtimit dhe zgjimit që kanë hapur Afgani, Abduhu dhe Ikbali, nuk ka pasur deviacione dhe ndikime të pikëpamjeve perëndimore. Kjo është parë qartë te disa autorë. Te disa mendime të hershme të Dr. Taha Huseinit shihen qartë gjurmët e ndikimit të mendimit perëndimor në lidhje me Kur'anin dhe Muhamedin a.s. Ai pothuajse ka pranuar shpjegimin perëndimor për zanafillën e Islamit. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me Sheh Ali Abdurrazik-in. Kuptimi i tij për Islamin si religion, që fokusohet vetëm në anën moralo-shpirtërore të jetës së njeriut, paraqet kopjen e pikëpamjes kristiano-perëndimore

për fenë. E njëjta gjë mund të dallohet edhe tek autorët e tjerë e që nuk duhet dramatizuar aspak. Trysnia e kërkesës ndaj përfshirjes së jetës aktive, dalja nga gjendja shekullore e qetësisë dhe hyrja në procesin e kthesës për të ardhmen, ka qenë kaq e papërballueshme dhe e fuqishme, saqë nuk linte shumë kohë për mendime të thella dhe serioze. Është e rëndësishme që puna ka nisur dhe po vazhdon më tej. Është plotësisht e kuptueshme që në këtë rrugë mund të priten hulumtime, devijime dhe luhatje. Kjo luhatje, zbulim dhe gjetja e vetvetes duket sheshit dhe vazhdon gjithnjë.

Nuk duhet harruar që ky hulumtim, si simbol i zgjimit, po ndodh në një moment shumë të veçantë, i cili është jashtëzakonisht i pasur me mendime të ndryshme, me sisteme, me ndikime dhe ndryshime revolucionare. Çdo gjë kalon në provim. Të gjitha vlerat e mëparshme dhe tërë historia janë vënë në pikëpyetje. Duket se duan të thonë se historia fillon me një lëvizje të përcaktuar ose nga një revolucion i përcaktuar. Kështu njerëzimi tani ndodhet në një situatë pa stabilitet, të panjohur dhe pa mbështetje shpirtërore, e cila do të rrënjoste shpresën dhe besimin për një të ardhme më të mirë dhe triumfin e së vërtetës. Kështu përftohet përshtypja që jeta e njeriut të paraqitet si absurd i vërtetë apo si vetëkënaqje me kërkesat materiale të ekzistencës njerëzore (materializëm). Kjo, ndërkohë, sipas

mësimeve islame, është diçka më tepër se e tëra. Nuk është absurde as kënaqësi e thjeshtë e pasionit.

“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre për t’u zbavitur”. (Duhan, 44:38)

“Zoti ynë, këto nuk i ke krijuar pa qëllim. Ti qofsh i lëvduar!” (Al Imran, 3:191)

“Pse, a mendoni ju se ju kemi krijuar pa një qëllim?” (Mu’minun, 23:115).

Mes komentuesve më të shquar të Kur’anit bëjnë pjesë Sheh Muhamed Abduhuja, Reshid Ridai, Meragiju, Sheltuti, Behiji, Kasimi, Kutbiu etj. Nuk mendojmë që t’u hyjmë këtu analizave të hollësishme të karakteristikave bazë dhe metodave të këtyre autorëve. Qëllimi i këtij shkrimi është që të pasqyrojë një pjesë historike e zhvillimit të metodave për komentimin racional të Kur’anit krahas vërejtjeve të përgjithshme.

Krahas atyre që u thanë, është karakteristike të përkthimet e reja këmbëngulja që të zbulohet përputhja e plotë ndërmjet arsyes dhe Revelatës. Shpallja nuk mund t’i kundërvihet arsyes. Të dyja janë dhënë si udhëheqje dhe të dyja rrjedhin nga i njëjti burim. Vetëm qëllimi i keq i njërit apo tjetrit mund të çonte te mospërputhja e detyruar. Porosia Hyjnore merr parasysh njeriun, ashtu siç është, ka parasysh mundësitë e tij, natyrën e tij, gjendjen ku ai jeton në këtë botë, ka parasysh mundësitë e ndryshimeve me të cilat ai përballet duke jetuar në

këto situata. Për këtë arsye, nuk mund të ketë asnjë mospërputhje ndërmjet Fjalës së Zotit dhe botës ku ajo zbatohet dhe shndërrohet në aksion. Bota dhe jeta në të vërtetë paraqesin të njëjtën mendim dhe aksion, të njëjtën teori dhe praktikë. Këtu Mendimi Hyjnor, duke kaluar në aksion dhe veprim, gjen vend në kohë e hapësirë dhe zbret në histori, duke fituar kështu pasqyrimin e botës ekzistuese.

Lidhja e mendimit të Kur'anit me jetën, me kërkesat e ndryshimeve të saj, me dilemat dhe kërkesat thelbësore, është veçori e komentimit bashkëkohor. Kur'ani është ruajtur shumë gjatë në raft. Nuk mund të merrej e të kapej me dorë. Ai, pra, është diçka Hyjnore që duhet të jetë larg nesh dhe nga bota laike. Në rast se zbret në jetë do të dhunohet, do të çnderohet. Megjithëkëtë, ai (Kur'ani) u lexohej më tepër të sëmureve dhe të vdekurve. Në kohën tonë të zgjimit e të përtëritjes, një marrëdhënie e tillë duhej ndërruar. Që këndeje është e justifikuar kërkesa që Kur'ani t'i kthehet njeriut të gjallë dhe problemeve të jetës së tij, sepse për këtë është destinuar. Kjo tendencë, pa dyshim, rrjedh te të gjithë komentimet bashkëkohore.

Te Sheh Muhamed Abduhu-ja është vërejtur veçanërisht përpjekja që të shmanget çdo mospajtım ndërmjet Islamit dhe shkencës. Edhe njëherë e theksojmë se Sheh Abduhu-ja nuk sjell asgjë të re. Shumë kohë më parë për këtë çështje kanë shkruar shumë

autorë. Disa autorë të rinj kanë shkruar shumë larg dhe e kanë kaluar masën e kërkesës. Në këtë aspekt vendin e parë e zë i përmenduri Ahmed Khani, i cili ka provuar në tefsirin (komentin) e vet që jo vetëm të pajtojë Islamit me shkencën, por edhe të pajtojë të gjithë religjionet e të krijojë sintezën e Islamit, të Kristianizmit dhe Judaizmit. Për tefsirin e egjiptianit Tantauij thuhet se tek ai ndodhet çdo gjë më tepër se tefsir. Ky është kodi (përmbledhje ligjesh) i arritjeve shkencore dhe i njohurive në aspekte të ndryshme të jetës, të cilat janë marrë nga burime të pabesueshme e të pasigurta.

Bibliografia (marrë nga “The encyclopaedia of Islam” Leiden, 1981, f. 427-429, e përcaktuar për Kur'anin)

1. El-Mus'haf esh-Sherif , ose El-Kur'an el-Kerim, Kajro, 1344/1924, Botimi standard egjiptian i Kur'anit.

2. Abdul-Baki, “El-Mu'xhem el-mufehres li-elfadh el-Kur'an el-Kerim”, Kajro, 1364/1945, botim i ri 1388/1968 përputhet me botimin standard egjiptian.

3. Corani textus arabicus dhe Concordantiae corani arabicae, botoi G. Flugel, Leipzig, në vitin 1834 dhe 1842 përsëri ribotuar, p.sh. Ridgewood, N.J., v. 1965.

**Përktheu
Ismail Dizdari**

Nevoja e ringjalljes së trashëgimisë intelektualo-shpirtërore

MA. Ervis Jangulli

Abstrakt

Epoka moderne dhe postmoderne janë ngritur mbi disa koncepte, paradigma e botëkuptime. Koha jonë përmban në ngrehinën e vet problematika dhe sfida të ndryshme. Edhe shoqëria myslimane, nëse do ta përfytyrojmë si një trup më vete, gjendet përballë sfidave të shumta. Përballë problematikave bashkëkohore shoqëria myslimane dubet ta ofrojë zgjidhjen dhe melhemin brenda suazave të trashëgimisë islame. Sëmundja e këtij shekulli është mbisundimi i një zhvillimi shkencor-teknologjik i bazuar në botëkuptimin materialist dhe egocentrik, njëherazi i tëhuajësuar nga etika e spiritualiteti. Shoqëria myslimane gjendet në pozicionin inferior për shkak të mosmarrjes përsipër të trashëgimisë intelektualo-shpirtërore të traditës islame. Trashëgimia intelektualo-shpirtërore është nevojë urgjente për shoqëritë myslimane, që ta vendosin në skenë për të ofruar zgjidhje ndaj sfidave. Kjo trashëgimi mund të emërtobet me termin pasim i Islamit tradicional, pra të burimeve parësore të fesë dhe pasurinë e shtjellimit të këtyre burimeve nga mendimtarët, teologët, mistikët, filozofët dhe urtarët përgjatë shekujve. Kjo jo vetëm parandalon rënien e mëtejshme në greminat e formuara nga myslimanë radikalë apo modernistë, por edhe risjell një vizion në shoqëritë myslimane për t'u përballur denjësisht me sfidat e kohës dhe, në fund të fundit, të fitojë qëllimin real të çdo individi. Qëllimi i fundmë i traditës islame është arritja e përsosmërisë shpirtërore tek individi.

Fjalë kyçe: modernizmi, shkencizmi, ringjallja, trashëgimia, trashëgimia islame.

Hyrje

Para së gjithash, për t'i paraprirë çdo lloj ambiguiteti që mund të paraqitet në këtë temë, lejomëni të lëvroj disa koncepte kyçe, që ndërtojnë strukturën bazë të kësaj teze. Sqarimi i tyre është diç(ka) që s'mund të lihet mënjanë dhe skajshmërisht i çmuar për ta vendosur idenë time brenda kontureve të duhura.

Shekulli në të cilin jetojmë ka tipar kryesor modernizmin, të qenët modern dhe anti-traditional. Sfida e myslimanëve kuptohet më lehtë në përkufizimin dhe shtjellimin e këtyre dy koncepteve. Në kuptimin më të thellë të fjalës modern nuk nënkupton atë që është 'në hap me kohën', e as atë që është e suksesshme në zaptimin e natyrës, por të shkëputurën nga transcendentja dhe parimet e përhershme, që i janë zbuluar njeriut përmes shpalljes. Modernizmi nënkupton njerëzoren profane të ndarë nga burimi Hyjnor, e kësaj të nënshtrueshme ndaj modave kalimtare të mendimit dhe tekave ndryshuese të egos.¹ Modernizmi është botëkuptimi në të cilin është ndërtuar ngrehina e epokës bashkëkohore, që është përjashtuese ndaj fenomeneve dhe aspekteve shpirtërore dhe e flak

1. Edin Q. Lohja, Parathënie, në S. H. Nasr, *Udbërrëfjes i të riut mysliman në botën moderne*, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2007), f. 13.

tutje botëkuptimin tradicional ku fizika e metafizika, trupi e shpirti bashkëjetonin në harmoni e paqe.

Nga ana tjetër qëndron tradita dhe tradicionalja ku nuk nënkuptoj zakonet a shprehite e ngulitura në rrjedhën kohore të një qytetërimi nga përsëritja horizontale, por të vërteta me karakter mbiindividual. Me 'traditë' nënkuptohet e shenjta që i është zbritur njeriut përmes shpalljes, bashkë me shpalosjen dhe zhvillimin e mesazhit hyjnor. Kjo kundërvënie mes traditës e modernes është në rrafshin parimor, që do të thotë e kritikoj modernizmin në premisat bazë për t'i larguar perdet që e bëjnë iluzionaren të duket si reale dhe negative si pozitive.²

Pa bërë përshkrime të shkoqitura e të detajuara, veçoria dhe elementi më qendror në epokën moderne është botëkuptimi materialisto-shkencor, që i rri përfund qytetërimin dhe botës moderne. 'Përparimi' e 'zhvillimi' i ashtuquajtur në këtë epokë është vetëm në rrafshin fizik dhe material ku 'teknologjia e fundit' është produkti më ashikar i këtij zhvillimi. Ky 'zhvillim' është kritikuar për dëmet e mëdha që ka sjellë sidomos në shkatërrimin e mjedisit dhe vrasjet e luftërat e tmerrshme botërore, prapëseprapë mbahet me krenari egoiste si të jetë stadi më i lartë i zhvillimit. Në fakt, ky farë zhvillimi nga qytetërimi tradicional konsiderohet më i ulëti

2. Po aty, f. 13.

edhe për vetë faktin se e tëhuajëson njeriun nga realiteti e natyrshmëria e tij edhe për angazhimin e tepërt me dimensionin më të ulët në realitetin ontologjik, që konsiston me realitetin fizik e material. Modernistët nuk mund të përfytyrojnë asnjë shkencë tjetër përveç asaj që merret me gjëra materiale, sepse pikëpamja sasiore mund të zbatohet vetëm në ato; kurse pretendimi që cilësia të reduktohet në sasi është gjëja më karakteristike në shkencën bashkëkohore.³ Qytetërimi bashkëkohor është sasiore, e thënë tjetërsoj, materialist⁴ (brenda këtij konteksti dua të theksoj se shkenca materialiste është derivat dhe produkt i filozofisë materialiste që u zhvillua në Perëndim qysh prej shekullit XVI e më pas, sepse në fillim lind ideja më pas konkretizohet në prodhim dhe produkt).

Termi materializëm përdoret për të identifikuar një shkollë filozofike që ia atribuon origjinën e ekzistencës materies dhe që mohon ekzistencën e gjithçkaje jomateriale ose përtejmateriale. Materializmi nënkupton edhe marrjen në konsideratë vetëm kënaqësitë materiale e fizike të jetës së individit dhe shpërfill nevojat shpirtërore dhe synimet e objektivat eskatologjike të tij.⁵

Pa u zgjatur më tej, thelbi i epokës moderne është reduksionizmi, që qëndron në zemrën e botëkuptimit materialisto-shkencor. Botëkuptimi modern shkencor është materialist e reduksionist dhe është gati-gati totalisht i kundërt me botëkuptimin tradicional se si ato e shihnin njeriun, botën dhe kozmosin dhe pothuaj nuk kanë pika të përbashkëta në rrafshin parimor mbi të cilin ato ngrihen.

Kjo vihet re edhe në premisat që formojnë themelet e botëkuptimeve gjegjëse, por gjithashtu edhe në qëllimet dhe synimet e tyre përfundimtare; shkenca tradicionale islame dhe shkencizmi modern. Themelet epistemologjike ndryshojnë te botëkuptimi tradicional islam dhe ai modern. Botëkuptimi modern materialist është individualist, që mohon çfarëdo parimi, që qëndron sipëror ndaj individit dhe si pasojë krejt qytetërimi modern reduktohet në të gjithë sektorët e tij në elemente thjesht njerëzore.⁶ Ndërsa botëkuptimi e shkenca tradicionale islame bazohet në dritën e arsyes (racios) dhe intelektit dhe aty ku arsyeja e intelektit nuk e gëzojnë sigurinë apodialektike, me të (sigurinë e vërtetë) mund

3. Rene Guenon, *Kriza e Botës Bashkëkohore*, shqip. Rene Guenon (Tiranë, 2012), f. 166.

4. *Po aty*, f. 173.

5. Suat Yildirim, Degradimi Mbarëbotëror Prej Materializmit Shkencor kuruar prej

Ali Unal, *Perspektivat Islame rreth Shkencës - Dija dhe Përgjegjësitë* -, shqip. Dritan Hoxha (Tiranë: Prizmi, 2014), f. 141.

6. Rene Guenon, *Kriza e Botës Bashkëkohore*, shqip. Rene Guenon (Tiranë 2012), f. 109.

të na pajisë drita e besimit.⁷ Po ashtu qëllimi përfundimtar i këtij botëkuptimi modern është thjesht të njihet bota fizike si një realitet i pavarur dhe thjesht të bëjë një ‘zhvillim a përparim’ teknologjik në emër të lehtësimit të kushteve të jetës njerëzore edhe pse më shumë ia ka vështirësuar për arsye të tëhuajësimit që i ka shkaktuar. Ndërkohë, prapavijat metafizike dhe qëllimi përfundimtar i botëkuptimit tradicional islam, është t’i lidhë nivelet e ulëta të qenies dhe realitetit me më të lartat dhe e konsideron botën fizike të jetë thjesht rrafshi më i ulët në realitetin hierarkik të gjithësisë, duke pasqyruar Urtinë e Allahut.⁸

Thelbi i idesë sime është gjendja e tmerrshme inferiore e myslimanëve në tërësi nga ‘zhvillimi dhe përparimi’ artificial dhe i kufizuar i epokës moderne ku me filozofinë materialiste e shkencën reduksioniste është thjesht një ‘ngjitje’ iluzioniste dhe më pas (sipas shumë filozofëve dhe teoricienëve të njohur në perëndim teksa parashohin/parashikojnë) një rënie teposhtë pa shpëtim për vetveten. Kjo gjendje inferioriteti me të cilën përballen myslimanët vjen si

pasojë e mosnjohjes së pasurisë së trashëgimisë intelektuale-shpirtërore të traditës islame nga njëra anë dhe mosnjohja në esencë e natyrës së qytetërimit modern e postmodern kryesisht në perëndim. Teksa në shekujt e fundit qindra orientalistë janë vërsulur drejt lindjes për të njohur fenë dhe botëkuptimin e myslimanëve, nga ana tjetër, myslimanët nuk e njohin në thelb natyrën dhe esencën e botëkuptimit modern. Kjo disfatë i shtohet humbjes dhe shkëputjes që kanë myslimanët e sotëm me trashëgiminë e tyre intelektuale-shpirtërore.

Ringjallja e traditës intelektuale-shpirtërore islame

Njohja e trashëgimisë/traditës dhe vënia në skenën e këtij shekulli mund të zgjidhë shumë nyje të pazgjidhura dhe të ofrojë shërim për shumë sëmundje të pashërueshme, që kanë pllakosur shoqëritë e këtij shekulli. Ndër mendimtarët dhe intelektualët, të cilët kanë dhënë kontribut të vyer në ringjalljen e trashëgimisë islame në shekullin e fundit mund të përmendim: Muhamed Ikbali, Alija Izetbegoviç, Ismail Faruki, Sejid Nakib Attas e të tjerë.

E para gjë që duhet të kemi parasysh është se ekzistojnë dy mënyra/lloje bazë të dijes/njohjes: *nakli* dhe *akli*, ku e para ka të bëjë me dituritë e transmetuara dhe e

7. Ismail faruki, *Përkufizimi i tradicionalizmit islam*, shqip. Ermira Dani (Erasmus Qendra studimore fetare, 2014).

8. S. H. Nasr, *Udhërrëfyes i të riut mysliman në botën moderne*, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2007), f. 234.

dyta me dituritë intelektuale. Dija e transmetuar është kur merret nga dikush tjetër dhe përcillet brez pas brezi, ku tipari kryesor dhe specifik për këtë lloj dije është taklidi (imitimi).⁹ Ndërsa dija intelektuale është e arritshme/gjetshme vetëm brenda vetes sonë duke 'stërvit mendjen' do shpreheshin filozofët dhe duke 'dëllirë zemrën' do thoshin mistikët. Karakteristika specifike se si arrihet është tahkiku (realizimi dhe vërtetësia).

Dija e transmetuar është e përhapur pothuaj kudo, në çdo fe e kulturë dhe nuk është arsyeja thelbësore e stagnimit të botës myslimane.

Kurse sa i përket dijes intelektuale është dija që ofron siguri të plotë në thellësitë e shpirtave tanë. Dija intelektuale arrihet nëpërmjet tahkikut, që përbën të njohurit e gjërave duke ua verifikuar e realizuar vërtetësinë dhe realitetin vetë. Nuk mund të verifikohet vërtetësia dhe realiteti i gjërave pa i njohur ato drejtpërsëdrejti, në vetvete, pa ndihmën e askujt veç Zotit.¹⁰ Duke pasur në vëmendje këtë lloj ndarjeje, kuptohet se ajo që po vuajmë ne sot është zhdukja kryesisht, jo krejtësisht, e trashëgimisë së dijes intelektuale. Në qytetërimin islam,

9. William C. Chittick, *Shkencë E Kozmosit, Shkencë E Shpirtit, Përshtatsia e kozmologjisë islame në botën moderne*, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2011, ribotim), f. 36.

10. Po aty, f. 56.

kërkimi i dijes intelektuale (kryesisht) është ndërmarrë në dy lëmenj të gjerë të diturisë, nëse do ta themi shkurt, gjegjësisht filozofia dhe sufizmi (mistika).

Tradita e pamasë intelektuale e Islamit në konturet e saj madhështore zotëron/përmban një thesar të paanë mendimi. Tradita e tij në lëmin e veprimtarisë intelektuale është ndër më të pasurat e qytetërimeve të botës. Pikërisht kjo traditë e stërpasur (tradita intelektuale) me dy lëmenjtë e gjerë të diturisë (filozofia e sufizmi) ka shtjelluar dhe është fokusuar në katër tema bazë dhe të mirëfillta për tahkik (realizim): metafizika, kozmologjia, psikologjia shpirtërore dhe etika.¹¹

Metafizika është studimi i realitetit të parë dhe të fundit, që përshkon të gjitha dukuritë. Tema e diskutimit është Zoti ku shpesh ai quhet me emra të përgjithshëm si "Qenia", "i Domosdoshmi", apo "i Vërteti". Mendimi dhe intelektu duhet përqendruar vetëm tek i Vërteti që, në fakt, është vetëm Zoti, në bazë të shehadeit ku dëshmia La ilahe il-la'Llah, që është realiteti i epërm i Islamit, pohon dhe afirmon se i Vërteti është vetëm Ai.¹²

Njëshmëria e Allahut, teuhidi është parimi i parë islam dhe i çdo gjëje islame.¹³ Me fjalë të tjera ky kryeparim,

11. Po aty, f. 58.

12. Po aty, f. 58.

13. Ismail Faruki, *Përkuftizimi i tradicionalizmit islam*, shqip. Ermira Dani (Erasmus Qendra Studimore Fetare, 2014).

mbi të gjitha është shpirtëror dhe intelektual para se të jetë praktik, por normalisht përfshin çdo detaj të botëkuptimit islam, duke qenë rrënja dhe thelbi i këtij botëkuptimi. Në botë sot për sot janë të paktë intelektualët e mirëfilltë myslimanë në kuptimin e konceptit që përkufizova më sipër. Nuk ka shumë mendimtarë myslimanë anembanë botës që të mendojnë njëqind për qind në mënyrë islame. Po ç'është thotë të mendosh në mënyrë islame?

Të mendosh në mënyrë islame, do të thotë ta përdorësh mendjen në mënyrë që të përkojë me synimet e Kur'anit dhe Sunetit. Ku qëllimi dhe synimi i tërë fesë islame është t'i sjellë njerëzit në harmoni me mënyrën, në të cilën janë gjërat në të vërtetë. Me fjalë të tjera, t'i rikthejë në praninë e Zotit, nga e cila edhe dolën.¹⁴ Teuhidi është kryeparimi që mendimi ynë duhet të çelë dhe të japë fryte. Ismail Faruki nënrendit disa parime të rëndësishme që burojnë drejtpërdrejt nga Njeshmëria e Allahut, siç janë:

1- Njësimi i krijimit që rrjedh logjikshëm nga Njeshmëria e Allahut.

2- Njësimi i së vërtetës dhe njësimi i diturisë, që do të thotë se arsyeja mund të ketë iluzionet e veta mirëpo duhet edhe afirmimi nga burimi i pagabueshëm i shpalljes.

14. William C. Chittick, *Shkencë E Kozmosit, Shkencë E Shpirtit, Përshtatsia e kozmologjisë islame në botën moderne*, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Tiranë:Zemra e Traditës, 2011, ribotim), f. 42-43.

3- Njësimi i jetës ku nënkupton se të gjitha veprimtaritë e jetës janë të njësuara dhe jo të ndara në profane dhe të shenjta.

4- Njësimi i njerëzimit që nënkupton jo etnocentrizëm (racizëm dhe superioritet në nacionalizëm).¹⁵

Para se të kaloj te tema e dytë madhore e përshtatshme për tahkik (realizim) duhet të ritheksoj edhe njëherë se, dija intelektuale dhe mendimi i të kuptuarit intelektual është i një rëndësie madhore. Me fjalët e njerit prej mjeshtrëve më të mëdhenj të traditës intelektuale Mevlana Xhelaluddin Rumi na kujton për përparësinë e mendimit në vargjet e tij:

Vëlla, ti je bash një ky mendim –
e pjesa tjetër veç koca e ind.
N'mendofsh ti drandofile,
je vetë drandofilishte,
e n'paç në mendje ferra,
qymyr për furrë qi digjet.¹⁶

Tema e dytë bazë është kozmologjia, që ka qenë fushë e denjë që njeriu të bënte tahkik (realizim) dhe nga fushat që mendimtarët, urtarët e filozofët janë angazhuar më së tepërmi.

15. Ismail Faruki, *Përkufizimi i tradicionalizmit islam*, shqip. Ermira Dani (Erasmus Qendra Studimore Fetare, 2014).

16. William C. Chittick, *Shkencë E Kozmosit, Shkencë E Shpirtit, Përshtatsia e kozmologjisë islame në botën moderne*, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Tiranë:Zemra e Traditës, 2011, ribotim), f. 71.

Kozmologjia është lëmi i shfaqjes dhe zhdukjes së gjithësisë.¹⁷ Gjithësia është një libër i madh ku shpalosen dhe manifestohen këtu e tani, orë e çast Emrat dhe Atributet e Zotit e që janë ajete (shenja) të Zotit.

Tema e tretë, që është psikologjia shpirtërore, merret me njohjen e thellë të shpirtit të njeriut që po ashtu si kozmosi është/ bëhet çdo moment vendmanifestim / vendshpalosje, vendpasqyrim i Emrave të Bukur të Zotit e që janë ajete (shenja) të Zotit.

E fundit, etika që është lëmi i urtisë praktike dhe raporteve ndërvetjake. Angazhohet në përfitimin e virtyteve për shpirtin e kthimin e tyre në natyrë të dytë dhe po kështu konsiston në ndjekjen e udhëzimeve të Zotit për t'i kryer veprimtaritë në harmoni me të Vërtetin, kozmosin dhe qeniet e tjera njerëzore.

Shihet qartë dhe kuptohet natyrshëm se fokusi dhe pika esenciale e këtyre temave qendërzohej te nefsi-vetja. Vetja njerëzore (nefsi) është çështja kyç, sepse vetëm ajo mund ta arrijë njohjen e Zotit e të kozmosit.¹⁸ Kjo realizohet duke përpunuar fuqinë e saj të brendshme, që quhet intelekt (akl), ose zemër (kalb). Për ta përpunuar këtë fuqi, njerëzit duhet të njohin natyrën e vetes (nefsit) së tyre,

17. Po aty, f. 58.

18. Po aty, f. 59.

gjë e cila nuk mund të njihet kurrsesi nga jashtë, por vetëm nga brenda. Një vetënjohje e tillë konsiderohet e mbështetur në realizim, verifikim e jo në imitim. Prandaj kjo vetënjohje është urë e sigurt në njohjen e Zotit duke qenë se vetënjohja dhe njohja e Zotit e shprehur te shehadeti La ilahe il-Allah janë që të dyja të rrënjësura thellë në tahkik (realizim e verifikim).

Pikë tjetër e rëndësishme që vihet në skenë nga tradita intelektualo-shpirtërore islame dhe një nga synimet e saj thelbësore është thyerja e guaskës së dogmatizmit, që do të thotë të kapërcesh përtej dogmatizmit.¹⁹ Një nga personalitetet më të spikatur brenda kësaj tradite, Imam Gazaliu, e sulmon shpesh mendësinë dogmatike, duke shpjeguar se shpeshherë dija e transmetuar bëhet perde që pengon arritjen e të kuptuarit intelektual.

Synim tjetër i rëndësishëm i traditës intelektualo-shpirtërore pas kapërcimit të mendimit dogmatik është të gjejë bërthamën dhe të njohë Realitetin e Vërtetë për vete dhe të pohuarit e absolutshmërisë së të Vërtetit. Metodologjia e tahkikut beson se inteligjenca njerëzore është e puqshme me të Vërtetin dhe se i Vërteti është një. Nuk duhet harruar se shpallja cek si dijen intelektuale, ashtu edhe të transmetuarën. Madje, këto dy lëmenj vihen re te dy gjysmat e Shehadetit, ku gjysma

19. Po aty, f. 86.

e parë cek teuhidin – themelin e tërë dijes intelektuale, ndërsa e dyta profetësinë – parimin e dijes së transmetuar, fetare.²⁰ Gjithsesi fokusi mbetet vetëm te dija intelektuale e arritshme kryesisht te dy subjekte, siç janë filozofia dhe sufizmi dhe e trajtuar në katër sferat e mëdha që janë hulumtuar nga mjeshtrit e mëdhenj intelektualë myslimanë.

Nëse do përpiqemi t'u gjejmë një truall të përbashkët gjithë synimeve dhe tipareve të trashëgimisë intelektuale islame, padyshim ajo është vizioni njësuës, që kjo traditë e përmban me shumë xhelozit/krenari. Shkencat e ndryshme nuk kuptoheshin të ndara siç kuptohen sot që po sundon tekthirizmi (me i bë gjërat shumë), mirëpo bashkëharmonizoheshin dhe shiheshin si lëmenj ndërplotësues. Sa më shumë zbulohej dhe hulumtohej te bota e jashtme (kozmozologjia), aq më tepër individit arrinte të thellohej e të depërtonte në botën e brendshme (psikologji shpirtërore). Në fund të fundit, qendra ku çdo gjë rrethohej dhe pika kyç ishte njohja e nefsit (vetes) dhe pikërisht ky ishte edhe qëllimi i studimeve intelektuale-shpirtërore: njohja dhe përkryerja e vetes njerëzore. Duke përdorur shprehjen e famshme të Ibn Arabiut, synimi i jetës njerëzore ishte arritja e pozitës së një “njeriu të përkryer” (insan kamil).

20. *Po aty*, f. 89.

Përfundim

Siç u theksua që në hyrje të këtij materiali, shekulli i tanishëm dhe shoqëria moderne përëndimore i ofron sfida të panumërta dhe pothuaj në të gjitha lëmenjtë shoqërisë myslimane. Sfidat e shtruara nga Perëndimi ndaj botës myslimane gjatë kësaj periudhe shtrihen në të gjitha nivelet e ekzistencës, në atë ushtarake, ekonomike, sociale, kulturore dhe intelektuale.²¹ Duke qenë, mbi të gjitha, kjo sfidë intelektuale, reagimi i parë i myslimanëve ka qenë pikërisht në këtë spektër. Kësaj i shtohet edhe fakti se problemi më i madh i Perëndimit ose “idhulli më i adhurar apo fetishizuar i njerëzve modernë prej gati dyqind vjetësh ka qenë shkenca”.²² Kështu që, përballja dhe qëndrimi më i denjë i myslimanëve, në mënyrë që të jenë në harmoni me shpirtin dhe thelbin e fesë islame dhe traditën e tyre, konsiston në atë se myslimanët duhet të bëjnë çdo përpjekje ta ringjallin mendimin dhe traditën intelektual-shpirtërore që ata e kanë në zemrën e rrjedhës së historisë. Pa u njohur ‘autoritetet’ me të cilat nënkuptohen pikat e përbashkëta të hulumtimit intelektual të tyre, do ishte gati e pamundur ecja në shinat

21. Osman Bakar, Reagimi i intelektualëve myslimanë ndaj shkencës moderne në librin “The History and Philosophy of Islamic Science”, shqip. Rezart Beka, (Ersamus Qendra Studimore Fetare, 2014).

22. Kuruar prej Ali Unal, *Perspektivat Islame rreth Shkencës - Dija dhe Përgjegjësitë* -, shqip. Dritan Hoxha (Tiranë: Prizmi, 2014), f. 51.

e traditës intelektual-shpirtërore që ofron vetë Islami, Kur'ani dhe Suneti. Njohja e Ibn Sinës, Imam Gazaliut, Ibn Arabiut, Sadruddin Konjaviut, Mevlana Xhelaluddin Rumiut e shumë mjeshtërve kolosë të kësaj tradite, që kanë thyer guaskën e dogmatizmit dhe janë realizuar në potencialin e tyre më të lartë, do ishte hapi i parë drejt rrugës së gjatë të kësaj tradite. Nëse njëri prej këtyre mjeshtërve do udhëtonte nga ajo epokë te kjo e sotmja, teksa do të kundronte botën e sotme myslimane, do të tromaksej e do të shushatej se sa larg jemi nga tradita jonë intelektual-shpirtërore e me sa mijëra vogëlsira angazhohemi me tërë kapacitetin tonë dhe, nga ana tjetër, se sa problematika

të imta e të dobëta po e mbysin botën moderne. Bota moderne është artificiale në zhvillimin e saj, ashtu siç mund të fryhet një tullumbace dhe plasja e tij është sa e kollajtë aq edhe e afërt. Ndërsa trashëgimia jonë intelektual-shpirtërore është e qëndrueshme dhe tejkohore, që ofron perspektivë për këdo, prandaj mund të thuhet në mënyrë të bindur se kjo duhet ringjallur te zemra e mendja e çdo myslimani dhe kjo rrugë duhet ndërmarrë nga intelijenca myslimane. Kur të realizohet kjo, teuhidi triumfon dhe zotrat e shumtë modernë thyhen dhe shuhen, se përndryshe shohim çdo ditë se zotrat modernë adhurohen, duke u kamufluar në emra dhe stile modernistë.

Bibliografia

Bakar, Osman. *Reagimi i intelektualëve myslimanë ndaj shkencës moderne*, përkth. nga Rezart Beka, Ersamus; Qendra Studimore Fetare, 2014.

Chittick, C. William. *Shkencë E Kozmosit, Shkencë E Shpirtit – Përshatësia e kozmologjisë islame në botën moderne*, përkth. nga Edin Q. Lohja, Tiranë: Zemra e Traditës, 2011.

Faruki, Ismail. *Përkufizimi i tradicionalizmit islam*, përkth. nga Ermira Dani, Erasmus; Qendra Studimore Fetare, 2014.

Guenon, Rene. *Krizë e Botës Bashkëkohore*, përkth nga Rene Guenon, Tiranë, 2012.

Nasr, S. Husein. *Udhërrëfyes i të riut mysliman në botën moderne*, përkth, nga Edin Q. Lohja, Tiranë: Zemra e Traditës, 2007.

Unal, Ali. *Perspektivat Islame rreth Shkencës – Dija dhe Përgjegjësitë* – përkth. nga Dritan Hoxha, Tiranë: Prizmi, 2014.

Yildirim, Suat. *Degradimi Mbarëbotëror Prej Materializmit Shkencor, në librin e kuruar prej Unal, Ali. Islame rreth Shkencës – Dija dhe Përgjegjësitë* – përkth. nga Dritan Hoxha, Tiranë: Prizmi, 2014.

Koncepti i reformës në Islam

Haki Sahitaj
Kolegji Universitar Bedër

Abstrakt

Islami, feja që u bë pjesë e një shoqërie të gjerë, që së bashku i dhanë një qytetërim botës, me një shpejtësi dhe cilësi marramendëse. Nga shkencat fetare e deri tek ato empirike, nga arti, muzika e letërsia, filozofia e metodologjia e deri tek arkitektura, Islami sfidoi të gjitha qytetërimet dhe arritjet kohore. Por sot, myslimanët janë bërë një shoqëri që nuk po mund të cilësohen ndryshe veçse një shoqëri e prapambetur, regresive, të gërryer shpirtërisht e të rënë moralisht. Larg arritjeve të mëdha shkencore, të ngecur në vetëkritikën teologjike, në mbylljen e ixhtihadit, të pavarur politikisht e të mundur ekonomikisht. Meqë Islami si fe nuk lindi si pasojë e faktorëve socialë, e as nuk u nxit si nxitje e një kulture, por veten e shfaqti vetëm si përpjekje për të jetësuar tashmë shpalljen e re që i kishte zbritur në kohën e profetit Muhamed a.s. fe kjo që me botëkuptimin e vet kapërcen kohën dhe hapësirën. Është pikërisht ky fakt që Islamit nuk e shihet si faktor dhe arritje historike, që lindi dhe tanimë njihet dhe fundin, dhe se duhet të pranohet të tjera kultura, të tjera ide, të tjera praktika. Islami mbetet ligji i Zotit, që synohet të jetohet deri në fund, dhe është pikërisht ky botëkuptim që i ka shtyrë intelektualët myslimanë të thirrën në reforma islame. Por kjo fjalë ka nxitur debate dhe përplasje nga shumë myslimanë të tjerë, aq sa e kanë refuzuar si të tillë. Thirrjet për reforma në Islam kohëve të fundit nuk mungojnë as nga palët jomyslimane, siç janë orientalistët, njohës e kritikë të Islamit, që vijnë nga qarqe të ndryshme akademike. Por ky koncept sot si edhe shumë koncepte të tjera gjendet në një mjegullë terminologjike, saqë është e vështirë të vendoset se çfarë përfshin diskursi rreth “reformës”.

Hyrje

Islami është një fe që tërë veprimtarinë njerëzore, por dhe ekzistencën, e nis nga koncepti i njëshmërisë së Zotit (teuhidi). Çdo gjë lëviz dhe funksionon në bazë të këtij parimi. Që të mos prishet asnjëherë kjo harmoni, feja islame ka ngërthyer në vetvete të gjitha parimet për ta ruajtur përherë këtë harmoni, rend në kozmos dhe në jetën njerëzore. Prandaj, sa herë që në shoqërinë myslimane janë shfaqur kriza, korrupsione, regres, konflikte, kanë qenë si pasojë e mos harmonizimit të elementeve njerëzore dhe fetare. Sot, kur shoqëria myslimane po përjeton disfatat më të rënda shpirtërore, intelektuale e kulturore, prej myslimanëve u kërkohet që të rilexojnë edhe një herë vlerat etike dhe studimin e problemeve bashkëkohore. Më saktë, një thirrje për rizgjim të myslimanëve. Thirrjet janë të hershme dhe vazhdojnë edhe sot. Por, thirrja për reforma - ndonëse e domosdoshme - mund të thuhet se nuk ka qenë aq e qartë, se për çfarë reforme bëhet fjalë. Nga ku nis kjo reformë, çfarë synohet të reformohet konkretisht? Ku fillon dhe me çka kjo reformë? Janë vetëm disa nga pikëpyetjet e gjithsecilit nga ne për reformën islame. Përgjigjet mund të jenë të ndryshme, kjo në natyrshmërinë e saj, ngaqë duhet të kemi parasysh kohën, rrethanat dhe sfidat në të cilën gjendej çdo reformator në kohën e tij.

Çfarë është reforma islame?

Historia e mendimit islam është shënuar nga tradita e revitalizimit të brendshëm dhe reformës së ngulitur në parimet e islahut (reformës) dhe texhdidit (ripërtëritjes). Qëllimi përfundimtar ka qenë që të sjellin realitetet ekzistuese dhe ndryshimet shoqërore në përputhje me standardin transcendent dhe universal të Kur'anit dhe Sunetit, duke menduar një proces të restaurimit dhe reformës.¹ Tërë pasuria intelektuale, shpirtërore dhe civilizuese që doli në skenën historike, ishte falë këtij përkushtimi dhe kësaj besnikërie ndaj shpirtit islam. Sfidat për myslimanët nuk mbaruan, me mbylljen e shpalljes hyjnore. Përkundrazi, koha dhe vendet sillnin sfida të reja, që kërkonin për një proces të vazhduar leximi e rileximi, të një interpretimi të besueshëm e përtëritës, që shpie në formulimin e rregullave ligjore të përshtatura (fetva).² Historia na tregon se myslimanët kohë pas kohe kanë formuar një rrjetëzim hierarkik të gjërave dhe interesit që vështirë mund të thyhet ose ndryshohet.³ Sot, kur moderniteti ka sjellur

1. Mohammad Hashim Kemali, Tajdid, Islah and civilisational renewal in Islam, f. 1 (484), <http://www.iais.org.my/icr/index.php/icr/article/view/367/345>

2. Tarik Ramadani, Reforma rrënjësore/ Etika Islame dhe emancipimi, Furkan ISM, Shkup, 2017, f. 13.

3. Nexhat Ibrahim, Fjalë pas fjale, Logos A, Shkup, 2016, f. 161.

kompleksitetin dhe sfidat e llojit të vet, ky rilexim është i domosdoshëm, jo vetëm për ta ruajtur substancën e Islamit, por për ta bërë atë element transformues në rendin e sotëm bashkëkohor. Këto sfida prekën edhe universin intelektual, metodik e konceptual. Rrëmuja, që u shkaktua nga ndikimet e filozofisë, shkencës, ideologjia e kultura perëndimore, i çuan myslimanët në një huti intelektuale. Kjo për faktin se rezultati i këtij ndikimi do shkaktonte ndryshime dhe kufizime në kuptimin e termave kryesorë që e projektojnë botëkuptimin e rrjedhur nga shpallja.⁴ Në këtë pikë tërheq vërejtjen edhe H. Nasër.⁵ Po ashtu edhe Dr. Jusuf el-Kardavi do shprehë se shumë konflikte janë shkaktuar si pasojë e përkufizimeve

4. Sejjid Muhammed Nakib el-Attas, Hyrje në metafizikën e Islamit, Logos-A, Shkup, 2011, f. 30.

5. Ai pohon se në kontrast me dijetarinë islame tradicionale, ku në të gjitha degët e shkencave termat përkufizohen qartë dhe përdoren gjithmonë me kuptim specifik, gjatë shekullit të kaluar, në mesin e një morie myslimanësh të modernizuar që merren me traditën e tyre, është shfaqur një prirje drejt dykuptimisë dhe përdorimit të shkujdesur të shumë termave të rëndësishëm, e cila pasqyron një gjendje mendore të ngatërruar dhe mungesë mendimi rigoroz, për të mos thënë më tepër. Fjalë e shprehje janë përdorur nga shumë prej tyre në një mënyrë që e nxjerr sheshit gjendjen e tronditjes kulturore dhe shpesh ndjesinë e inferioritetit karshi Perëndimit, nga e cila vuajnë. Shih Sejjid Husein Naser, Islami dhe derti i njeriut modern, Kreu 10.

të koncepteve. Historikisht dallimet terminologjike kanë çuar në ndarje e polemika.⁶ Sipas kësaj nuk duhet kuptuar se reforma lindi vetëm kur qytetërimi perëndimor me anë të kolonializmit preku rendin politik, ekonomik, por edhe epistemik të botës myslimane. Mirëpo, në fillimet e veta Islami sfidohej në kërkesën për të kuptuar dhe rilexuar sa më drejtë harmoninë brenda teksteve të shenjta, qasjen ndaj tyre dhe leximin e drejtë. Kjo kërkesë në terma njihet si texhdidu-din, pra ripërtëritje e fesë. Kur shfletojmë librat që flasin për texhdidin shohim se aty fillohet me shkencat fetare. Edhe Zekerija Karabell, kur shkruan për Epokën e reformave myslimane, shek. XIX dhe XX e vlerëson si epoka e artë e lëvizjeve reformatore.⁷ Kjo për arsye se nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX Perëndimi po intensifikohej mbi të gjitha pjesët e botës myslimane, dhe me pushtimin e shumë tokave të tyre. Algjeria dhe Tunizia ranë në duart e Francës, bashkë me Marokun. Egjipti u pushtua më 1882. Anglia po zgjeronte ndikimin e vet mbi Persinë dhe Ballkanin etj. Këto ndryshime gjeo-politike bënë që bota myslimane të reagojë shpejt me anë të shumë reformave. Mirëpo duhet pranuar

6. Dr. Jusuf el-Kardavi, Rizgjimi Islam ndërmjet mospajtimit të ligjshëm dhe përçarjes së urrejtur, Vëll. II, Prishtinë, 2002, f. 103.

7. Edukata Islame, Viti XLV nr. 10, Prishtinë, 2016, f. 103.

se reagimet e myslimanëve kishin edhe kahje të ndryshme. Një pjesë e mirë e shkolluar e myslimanëve në Perëndim mendonin se këto reforma duhet të shkonin në përvetësimin dhe pranimin e vlerave moderne. Duke i marrë për bazë themelet e shkencës dhe filozofisë perëndimore, ata pohuan se ishte koha për një valë të re ndryshimesh. Në anën tjetër kishim dhe pjesën që refuzuan me çdo çmim këto vlera. Por modeli i shteteve myslimane sipas atyre perëndimore thuajse ishte bërë i pashmangshëm. Myslimanët besonin se vlerat e Islamit ishin të mjaftueshme për ta bërë të ardhmen e tyre më të mirë, me zgjedhje më adekuate dhe pse nuk ishin konkurruese me Perëndimin. Mirëpo shoqëritë myslimane ishin bërë aq pasive, saqë besnikërinë ndaj fesë e shihnin vetëm në ruajtjen dhe imitimimin e vlerave të së kaluarës. Dhe se përgjigjet eventuale për çështjet që parashtronte koha, ua përgatiste Perëndimi.⁸ Apo shprehur me fjalët e Theodore von Laue, ishte vetëm çështje kohe kur perëndimi do të (po)bëhej shembull obligues.⁹ Shohim se thuajse të gjithë ishin pajtuar se balanca kishte ndryshuar vendosmërisht kundër myslimanëve dhe ishte kthyer në favor të Perëndimit.¹⁰ Dhe thirrja për reformë ishte se si të qëndrohej i pavarur.

8. Nexhat Ibrahim, po aty, f. 235.

9. Shih Dr. Murad Hofmann, Islami si alternativë, Furkan ISM, Shkup, 2000, f. 16.

10. Zachary Karabell, po aty, f. 102.

Koncepti i reformës pas shek. XX

Rreth konceptit të reformës janë dhënë përkufizime të shumta, në varësi të rrethanave dhe sfidave me të cilat është përballur shoqëria myslimane.¹¹

Muhamed H. Kemali shkruan se në kontekstin modern, parimisht ky koncept ka të bëjë me zhvillimet që ndodhën në shek. e XX, me dijetarët si M. Abduhu (v. 1905), M. Reshid Rida (v. 1935) dhe udhëheqësin e tyre Xhemaluddin Afganiun (vd. 1897).¹² E njohur ndryshe edhe si lëvizja panislamiste (el-Vahdetu'l-islamijje).¹³ Por kur bëhet fjalë për termin reformë shumë intelektualë e kanë refuzuar përdorimin e saj, kjo për tre arsye: E para, ngaqë kjo nënkupton ndryshim të Islamit, duke e ndryshuar për ta përshtatur me kohën. Dr. Jusuf el-Kardavi në qasjen që u bën karakteristikave të lëvizjes islame, thotë se thuajse të gjitha lëvizjet kanë frikë nga reformat. Pavarësisht se bëhet thirrje për ixhtihad, ajo në aspektin praktik dhe organizativ anon nga imitimi dhe ruajtja e së vjetrës.¹⁴ E dyta,

11. Për një shtjellim më të gjerë të këtij koncepti të shikohet punimi M. Hashim Kemal, Tajdid, Islah and civilisational renewal in Islam, f. 10-13.

12. Mohammad Hashim Kemal, po aty, f. 10 (493)

13. Mendohet se Xh. Afgani dhe M. Abduhu janë promotorët kryesorë të kësaj lëvizjeje. Për më gjerë të shikohet Nexhat Ibrahim, Rilindja Islame, Logos-A, Shkup, 2015, f. 141-153.

14. Dr. Jusuf el-Kardavi, Ku qëndron problemi, Prishtinë, 2002, f. 54-9.

se kjo fjalë është e huazuar nga tradita e krishterë për t'i shkaktuar Islamit të pasojë evolucion si Krishterimi. Siç do të shkruante Mehdi Hasan në një artikull me titull *Why Islam doesn't need a reformation* (Pse Islami nuk ka nevojë për reformim). Pikërisht ngaqë Islami nuk ka nevojë për një reformim të llojit të fesë së krishterë do pohonte ai.¹⁵ E treta, bazohet në karakterin universal dhe të pakohë të mësimëve të Islamit, që, si rrjedhojë, thotë argumenti, nuk ka nevojë për reformë dhe se mund të zbatohen në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet.¹⁶ Por ajo që realisht synohet të pohohet me reformë, është leximi kritik, kapërcimi i frikës së ndryshimit për diçka që në realitet është pjesë e vetë Islamit dhe jo diç e bartur. Krahas reformës është dhe koncepti i *texhdidit*¹⁷, i përdorur thujtë paralelisht me *islahun*. Koncept ky i përkthyer si përtëritje, rilindje apo edhe rigjenerim. Megjithatë T. Ramadani

15. <https://www.theguardian.com/commentisfree/2015/may/17/islam-reformation-extremism-muslim-martin-luther-europe>

16. Tarik Ramadani, po aty, f. 25.

17. Për një punim më të gjerë rreth këtij koncepti, nevoja për të, përdorimi dhe definimi sipas tradicionalistëve, evropianëve, dhe myslimanëve modernë të shihet vepra e Dr. Ahmed bin Muhammed el-Lehejib, *Texhdidu-din leda itixhai akalanij-islamijje'l-muasar*, Rijad, Mexheletu'l-bejan, 1432h. Po ashtu dhe vepra e Dr. Bistami Muhammed Said, *Të kuptuarit e ripërtëritjes së fesë*, është vepër ku trajtohet gjerësisht ky koncept, shih *Mefhum Texhdidu-din*, Merkezu Tesilu Dirasat ve Buhuth, 2012.

për këto dy koncepte shprehet se të dy nocionet japin idenë e njëjtë të reformës dhe njëkohësisht janë komplementare, meqë i pari pikësëpari (por jo ekskluzivisht) i referohet marrëdhënies së teksteve, ndërsa i dyti, kryesisht, ka të bëjë me reformimin e kontekstit njerëzor, shpirtëror, social e politik.¹⁸ Edhe në librin *Texhdidu-din* të Shejhut Vahidu-du-din Khan, i cili pohon se ripërtëritja e fesë nuk ka për qëllim të shtohet diçka në fenë e Zotit, por me të synohet të pastrohet botëkuptimi i fesë hyjnore, nga siç shprehet ai “pluhuri i grumbulluar”, pra të dalluarit e mendimeve njerëzore që janë dhënë kohë pas kohe dhe të kthehet - përpjekje për t'u perceptuar - teksti (kuptimi) në origjinalitetin e vet.¹⁹ Dhe *texhdidin* ai e nis që me shkencën e fikhut, kelamit etj.²⁰ Ndërsa fjalën reformë (*islah*) ai do ta përdorë vetëm kur do fillonin pushtimet evropiane nga shek. XVI, kur Portugalia zbulon rrugën për në Indi. Më pas nga shek. XVII, XVIII ai përmend se si dalëngadalë evropianët po ndikonin mbi botën islame, me anë të shkencave natyrore. Me hapjen e kanalit të Suezit më 1869, u hapën rrugët për një ndikim akoma më të shpejtë të perëndimorëve.²¹ Kjo ishte një periudhë kur shoqëria dhe

18. Tarik Ramadani, po aty, f. 28.

19. Shejh Vahidu-d-din Khan, *Texhdidu-d-din*, Përktheu në gjuhën arabe Dhaferuddin Khan, Goodword Books, New Delhi, 2015, f. 5.

20. Shih *Texhdidu-d-din*, po aty, nga f. 8 e tutje.

21. *Texhdidu-d-din*, po aty, f. 66 e tutje.

njeriu po ndryshonte pashmangshëm, ndryshime që po preknin edhe vetë shoqërinë myslimane. Ndryshim, apo shthurje sipas Islamit, do të thotë largim nga origjina, thelbi i shpalljes²², dhe ky largim kohë pas kohe u kërkon myslimanëve të rizbulojnë thelbin, substancën etike, ashtu si edhe qëllimet e larta të porosisë së Islamit, në mënyrë që t'i zbatojnë besnikërisht e si duhet në kontekste socio-kulturore, që në thelb po ndryshojnë vazhdimisht. Problemi më themelor i periudhës reformiste ishte se, pavarësisht se Islami kishte fituar një shpirt dhe kreativitet të atillë sa t'u bënte ballë sfidave, çfarë i duhej marrë e çfarë i duhej lënë nga këto fenomene

22. Sejjid Husein Nasër, vep. e cit, po aty, Kreu 10.

historike, për hir të vetafirmimit dhe të përballimit të sfidave të sotme; çfarë mund të modifikojë Islami e ç'mund të lërë.²³ Meqë reforma ka këtë qëllim, jo të imitohet rezultati historik, por si mund të riprodhohet kërkesa etike dhe përpjekja njerëzore për të arritur modelin koherent shoqëror për kohën tonë, siç ata kishin bërë për kohën e tyre.²⁴ Shtrohej pyetja se a duhet marrë tërë çfarë dha kjo histori apo jo. Kjo nuk ishte aq e thjeshtë, sepse të gjitha arritjet intelektuale-shpirtërore ishin të reflektuara dhe provë e një besnikërie që kishin treguar gjeneratat e para. Dhe kjo nuk mund të hidhej tutje aq kollaj.

23. Fazlur Rrahman, Islami, Logos-A, Shkup, f. 515.

24. T. Ramadani, po aty, f. 38.

Përfundim dhe sugjerime

- Dy shekujt e fundit inteligjenca myslimane e pa se tashmë balancat kishin ndryshuar, rendi dhe sistemi i ri që po sillte Perëndimi po sillte kriza të shumta. Kështu u bënë thirrje dhe u përgatitën platforma reformiste.

- Universaliteti i Islamit dhe idealizimi i çdo rezultati, arritje që ishte shënuar nga gjeneratat e para, duket sikur nuk shihte nevojë për ndonjë reformë.

- Ndryshimet konceptuale kishin sjellë sfida në të definuarit dhe kërkesat për reformë, si dhe fushat ku kërkohej reformim.

- Edhe pse përkufizimet, apo qasjet në pranim, apo jo si koncept rreth reformës, ulemaja dhe vetë myslimanët janë të vetëdijshëm se koha sjell harresën, dhe kërkohet një vetëdije për besnikërinë karshi parimeve në të jetësuarit e tyre, si dhe rileximin e tyre.

- Reforma nuk do të thotë ndryshim në burimet e islamit, vlefshmëria e tyre është e pakontestueshme, por ajo nënkupton përtëritje të shpirtit islam, të ixhtihadit, mendimeve kritike dhe gjurmimin për përgjigjet adekuate në varësi të sfidave.²⁵

- Reforma kërkon të mos përsëritet forma historike, por të kapet shpirti dhe objektivat më të larta të fesë.

- Prej sfidave tona mbeten kapja pas mësimave të Islamit universalisht, të kuptuarit e drejtë të traditës dhe zhvillimeve historike.

- Kërkohet një studim më i thellë dhe kritik i stadeve të Perëndimit dhe shkaqet që kanë sjellë krizat e tanishme.

- Shekullarizmi mbi të gjitha ka sjellë prova intelektuale, me çka ka shkaktuar edhe dykuptimësinë e koncepteve kyçe që burojnë nga botëkuptimi islam.

- Duhet një dialog më i madh në mes ulemave tradicionalë (ulemau-nass) dhe atyre të kontekstit (ulemau vaki) për të njohur kompetencat dhe gjetur pikëmbështetjet në një reformim që i sjell paqe dhe zhvillim mbarë botës.

- Duhet diskutuar më shumë se ç'kuptohet me reformë përshtatëse e çka me atë transformuese.

- Dhe në fund, studimet, hulumtimet e shumta që janë bërë e pritet të bëhen dhe rezultatet që do nxjerrin këto qasje, duhen parë në atë se ç'reflektime të reja kanë sjellë, në çfarë përmasash janë ekzaminuar problematikat dhe çfarë hapash të tjerë pritet të bëhen. E jo të ndalemi në kritika individësh, grupesh, lëvizjesh e statusesh të tjera.

25. Rozhe Garodi, Gjallërimi Islamik, El-Kalem, Gjakovë, 1991, f. 62.

Mevlana Xhelaluddin Rumi Simbol i dashurisë (I)

MA. Dorian Demetja
Drejtor i Kulturës dhe Arsimit, KMSH

Abstrakt

Megjithëse kanë kaluar gati tetë shekuj nga koha e tij, mesazhet e Mevlanës nuk dinë të vjetrohen, duke ruajtur freskinë e gjallërinë akoma midis nesh. I destinuar që të bindë njerëzit se me dashuri mund të bëjnë mrekulli, Mevlana ka arritur që të studiohet ndër shekuj nga shumë universitete dhe studiues me emër në mbarë botën. Dashuria hyjnore, sipas tij, nënkupton dashurinë e dyanshme: Dashurinë e Zotit ndaj njeriut dhe të njeriut ndaj Tij. Një dashuri e tillë e dyanshme, ndërmjet Zotit dhe njeriut, ka një natyrë të përbashkët, ajo është dritë që ndriçon gjithkund dhe gjithmonë, ajo paraqet dritën e singertë të ekzistencës dhe të ftesës për ekzistencë në realitet. Sipas Mevlanës, rrugët që të çojnë te Krijuesi janë të hapura për të gjithë ata, që përpigën mjaftueshëm. E vetmja gjë që duhet bërë, është të flaken përtej thesaret e kësaj bote, për tu pasuruar me dashurinë e Zotit. Ashtu siç e theksonte gjithmonë ai: “Njeriu ka nevojë për dy gjëra: Dashuri dhe sy të përlotur”.

Në tekstet dhe poezitë e Mevlanës, gjejmë një realizim artistik që mishëron tërësinë e vetive shpirtërore të njeriut dhe veçori tipike të jetës shoqërore. Aty gjejmë edhe fjalë e shprehje të përdorura me kuptime të figurshme me një stil metaforik për të shprehur një ide, një ndjenjë

etj., e cila i jep ligjërimin gjallëri të veçantë. Ata që erdhën më pas, gjetën tek Mevlana një reformues epokal të mendësisë njerëzore, të botëkuptimit të njeriut, të raporteve të tij me hyjnoren, me tokësoren, me jetën dhe vdekjen, me pavdekësinë dhe amshimin. Në objektivin final të tij, Mevlana kërkonte nga vetja dhe

ndjekësit, afrimin me Zotin përmes njohjes së thellë. Njohja është prezente në forma të ndryshme: Njohje me inteligjencë, njohje me intuitë, njohje me entuziazëm, njohje me mëshirë dhe së fundi njohje me dashuri. Sigurisht të gjitha njohjet kanë rëndësinë e tyre. Për Mevlanën, për të arritur në njohjen e drejtpërdrejtë, duhen flakur kufijtë e arsyes. Funkcioni i mendjes është që ta dërgojë njeriun deri në kufirin e dashurisë. Mendja të njeh me themelin e çështjeve, nuk shkon përtej. Ajo na dorëzon te dashuria dhe është dashuria ajo që na bashkon me Zotin. Ashtu si te gjithë sufistët¹, por me një dimension më të gjerë, mjeti që përdori Mevlana në kërkimin e së vërtetës, ishte aftësia e njohjes me dashuri. Sipas A. J. Arberry, në veprat e Mevlanës mund të gjejmë ngushëllimet dhe kurat shpirtërore për sëmundjet e shekullit tonë. Kurse Irene Melikoff thotë: “Nëse popujt e botës të përkthenin dhe të lexonin në gjuhët e tyre veprat e Mevlanës, nuk do të ekzistonte në botë e keqja, lufta, armiqësia, urrëjtja, përbuzja.”

Jeta dhe vepra e Mevlanës, duhet të interpretohet në suaza të Kur’anit dhe Sunetit, sepse sufizmi² i tij, aty i ka rrënjët. Te veprat e Mevlanës dallojmë besim, urtësi, moral, art, filozofi, predikim, praktikë, porosi e këshillë. Këshillat e tij bazohen në mësimet që kanë fuqinë për të

frymëzuar dhe për të pasur një jetë më origjinale, të bukur, të dashur dhe kuptimplotë. Para se të njihet me Shemsi Tebrizin, Mevlana ishte një dijetar i madh dhe me zë. Por, pasi njohu Shemsin, brenda tij shpërtheu dashuria ndaj Zotit e njerëzores dhe poezinë e artin, ai e përdori në shërbim të fesë e frymëzimit.

Mevlana Xhelaluddin Rumi, një biografi e shkurtër

Më 30 shtator të vitit 1207, lindi Mevlana Xhelaluddin Rumi, në qytetin Belh, në veri të Afganistanit. Në ato kohë, ky qytet ishte ndër qendrat e rëndësishme të zonës së Horasanit. E ëma quhej zonja Mumine, kurse i ati Bahauddin Veled, i mbiquajtur ‘Sultanu’l-ulema’³, i përkiste një brezi familjar të zgjedhur e fisnik. Vëllai i madh quhej Alauddin Muhammed, kurse e motra, zonja Fatime.

Babai i tij Behauddin Veled, për shkak se gëzonte autoritet të madh në popull, sunduesi i Havarizmit, sulltan Muhamedi, e urdhëroi atë që të shpërngulet nga qyteti i Belh’it. Ai frikësohej se autoriteti i tij mund t’ia rrezikonte pushtetin. Në këtë kohë Mevlana ishte vetëm 12 vjeç. Disa thonë se në mendimin për ta shpërngulur të atin e Mevlanës është përfshirë jo vetëm sunduesi, por edhe dijetari i tij Fahrudin Raziu. Sidoqoftë, edhe vetë Mevlana

3. Mbreti i dijetarëve.

1. Mistik mysliman.

2. Misticizmi islam.

e kritikuar Raziun për përdorimin e tepruar të logjikës në shpjegimin e të vërtetave të fesë. Ai, duke kritikuar dialektikën thotë: “Sikur dialektika të mund t’a zbulojë vetë të vërtetën e frymës, Raziu do ta arrinte të gjithën, por këmbët e dialektikëve janë drurëzuar dhe këmbët prej druri janë më të luhatshmet”.

Babai i Mevlanës u largua nga Belhi së bashku me familjen dhe një grup nga farefisi. Zonja Fatime u martua dhe mbeti në Belh me të shoqin. Ata dolën në udhë me synimin për të shkuar në haxh. Në çdo vend që arrinin, pritëshin me interesim dhe respekt të madh. Ata si fillim shkuan në Nishabur dhe përveç tij vizituan edhe Kufën e Bagdadin. Në Nishabur takuan sufiun e madh Feriduddin Attarin. Attari iu drejtua Bahaeddin Velede: “Çmoje këtë fëmijë, se pa kaluar shumë, ka për të lëshuar zjarr në zemrat e ashikëve⁴ të botës!”. Më vonë familja e Mevlanës u vendos në Bagdad, ku do të jetonin për gjashtë muajt vijues. Pastaj me të shkuar në Mekë, kryejnë haxhin. Më pas kthehen në Damask, ku takohen edhe me një dijetar të madh nga Andaluzia, Muhjiddin ibn Arabiun. Po kështu, edhe Ibn Arabiu, kur e pa Mevlanën e ri që po ecte pas të atit, tha: “Lëvduar qoftë Zoti, oqeani po ecën pas liqenit”.

Pas Damaskut, familja udhëtoi për në qytetin Larend, në Kahramanin e sotëm, ku jetuan atje për shtatë

4. Dashuruesve.

vjet. Në vitin 1226, në moshën 19 vjeçare, Mevlana u martua me zonjën Xhevher. Nga kjo martesë lindën dy djem, Sulltan Velede dhe Alauddin Çelebiu. Pas vdekjes së gruas së parë, Mevlana u martua me gruan e dytë, Kira Hatun, martesë nga e cila lindën djali Emir Alim dhe vajza Melike.

Shumë shpejt Mevlanës i vdes nëna dhe vëllai i madh. Kjo i solli dëshpërim. Në këto kohë, vizitoi qytetin një delegacion nga sunduesi i selxhukëve Alauddin Kejkubadit. Aty dëgjuan ligjëratat mjaft tërheqëse. Pas raportimit të sunduesi i tyre për këtë rast, Sunduesi Alauddin e ftoi babanë e Mevlanës, Behaudinin, dhe tërë familjen e tij në Konja. Bahauddin Velede u shpërngul me familje në vitin 1229 nga Kahramani në Konja. Sunduesi dhe mjedisi i tij e pritën familjen me respekt të madh, i treguan vendin për të banuar dhe bënë gjithçka që ata të ndjeheshin sa më mirë. Ato kohë, Konja, kryeqytet i Selxhukëve të Anadollit, ishte një vend ku për shkak të interesimit dhe inkurajimit që tregonin qeveritarët, shtegtonin dhe strehoheshin shumë dijetarë, sufistë, poetë, zejtarë dhe artistë, si dhe njerëz që iknin nga sulmet mongole. Sunduesi e vendosi familjen e Behaudinit në pallatin e tij, ku qëndruan përgjithmonë. Aty ai kreu detyrën e myftiut dhe myderrizit dhe formoi një rreth të gjerë simpatizantësh. Mirëpo, Behaudini, “Mbreti i dijetarëve”,

në vitin 1230 vdes në Konja. Kur i vdiq babai, Mevlana ishte vetëm 23 vjeç. Mevlana, krahas gjuhës arabe dhe persiane, mësoi edhe gjuhën greke. Pasi Bahaeddin Veledi vdiq në Konja në moshën 80-vjeçare, deshën ta vënë Xhelaluddinin e ri në vend të tij. Përkundër kërkesave të simpatizuesve dhe miqve, Mevlana nuk e zuri postin e babait.

Në vend të postit, ai u dha pas disa mësimëve sufiste nga nxënësi i babait të tij shejh Burhanuddin Muhakkik Tirmidhiu. Ai e mori mbi vete edukimin moralo-shpirtëror të Xhelaluddinin, i cili deri në atë kohë kishte marrë mësim nga vet babai i tij dhe kishte arritur një nivel të përparuar në dituritë formale. Më vonë, sipas kërkesës së shehut, për ta plotësuar arsimimin, Xhelaluddini shkoi në Halep dhe Damask që ishin qendra arsimore me rëndësi të asaj kohe. Pas një jete të gjatë studentore, Xhelaluddini u kthye në Anadoll.

Shejh Burhanuddin Muhakkik Tirmidhiu ishte i mahnitur me dijen e Mevlanës dhe i sugjeroi që të kalojnë në njohjen e halit⁵ dhe në fuqinë e oratorisë. E gjithë kjo periudhë mësimi e aftësimi zgjati gati 10 vjet. Kur Mevlana mbushi 33 vjeç, zuri postin e babait të tij. Ndërkohë dijetari dhe sufisti i madh Shejh Burhaneddin Muhakkik vdes në Kajseri në vitin 1240.

Periudhën vijuese, Mevlana e kaloi si profesor në Medrese. Ai filloi

5. Gjendjes shpirtërore.

të japë mësim në Konja në dituritë fetare dhe të udhëheqë orientimin shpirtëror të popullit. Kishte arritur një gradë të lartë veçanërisht në dituritë e Fikhut dhe Hadithit. Ai kishte arritur në postin e Fetvasë, autoritetit të vendimit juridiko-fetar. Siç tregohet, kishte qindra nxënës. Fama i ishte përhapur gjithandej dhe studentët, pasuesit, i ishin shtuar. Mevlana, nga njëra anë angazhohej me mësim dhe edukim, nga ana tjetër preokupohej me bazat e sofizmit, të unifikuara me parimet fetare të Imam Gazzali.

Në një rast, kur po kthehej nga medreseja, u takua me një dervish endacak që quhej Shemsi Tebrizi. Si njohës i mirë i ilm'ul-batinit⁶ ai ndikoi te Mevlana, madje aq shumë, sa ai i braktisi miqtë dhe mësimet në medrese, për t'iu përkushtuar jetës asketike dhe qëndrimit me Shemsi Tebrizin. Kjo gjendje i preku djemtë e Mevlanës, nxënësit e tij, por edhe qytetarët, të cilët u ankuan te sunduesi kundër Shemsi Tebrizit që ai të largohet nga Konja. Në këtë gjendje, Shemsi u largua nga Konja dhe u vendos në Damask.

Në anën tjetër, Mevlana ra në dëshpërim të thellë nga largimi i mësuesit të tij shpirtëror, u izolua nga jeta dhe vazhdonte të mos shkonte në medrese. Për ta shmangur këtë gjendje, Sulltan Veledi shkoi në Damask dhe e ftoi Shemsi Tebrizin që të kthehet. Madje i dërgoi dhurata

6. Dijeve të brendshme.

nga nxënësit, si shenjë e kërkimit të faljes. Në maj të vitit 1247 Shemsi kthehet në Konja. Sërish më vonë, nën trysninë e miqve të Mevlanës, Shemsi do të largohet nga Konja duke mos lënë gjurmë dhe duke mos u gjetur më kurrë. Ka mendime se Shemsi është vrarë. Kjo ndodhi në vitin 1247. Në këtë mënyrë u zhduk nga sytë e botës Shemsi Tebrizi, por detyrën e frymëzimit ai e kreu siç duhej ndaj mikut të tij, i cili u bë shkak që Mevlana të zinte një vend dhe pozitë të lartë. Ndërsa Mevlana vetë, pas një sëmundjeje që vazhdoi disa kohë, ndërroi jetë më 17 dhjetor 1273. U varros pranë varrit të babait të tij në Konja të Turqisë.

Njohuri rreth veprave të Mevlanës

Mevlana Xhelaluddin Rumi është një dijetar dhe poet i madh, veprat e të cilit meritojnë të studiohen me seriozitet të plotë. Ai është një nga poetët më të mëdhenj të botës islame, i cili me poezitë e tij mistike dhe të shkruara me gjuhën universale të shpirtit, vazhdon edhe sot të lexohet anekënd në botë. Shumë dijetarë i kanë vlerësuar poezitë e Mevlanës si poezi të dashurisë hyjnore, të pasionit mistik dhe të dritës sekrete. Dhe, sigurisht, një nga arsytet pse pëlqehet kaq shumë, është aftësia e tij e shprehjes së qartë, të drejtpërdrejtë, e të biseduarit thellë brenda vetes rreth çështjeve të botës shpirtërore e të misticizmit. Poezia

e Mevlanës ka fuqinë të tejkalojë mendjen dhe të derdhet drejtpërdrejt në zemër. Ky ishte një dijetar i shquar dhe poet, i cili me poezitë e tij mistike ka ngrohur shpirtat e ashikëve për të vërtetën. Gjithashtu në poezitë dhe rrëfimet e Mevlanës, shprehet mirë ndjenja e mëshirës ndaj të varfërve, të dobëtëve ose atyre që janë në pozita të vështira. Brendia e poezive të Mevlanës dallohet qartë nga tone epike-lirike, të përshkruara nga filozofia e sufistëve që donin të pajtonin botën materiale me shpirtin.

Pas takimit me Shemsin, Mevlana u hodh në oqeanin e botës mistike dhe në mënyrë të natyrshme iu drejtua poezisë, si mjet i vetëm që mund t'u japë përgjigje emocioneve të një shpirti të pasionuar me ashk⁷. Ai me poezitë shprehu emocionet, entuziazmin, gëzimin dhe dëshpërimin, me to kërkoi ngushëllim e qetësi. Ai ligjëroi, predikoi, mbajti hutbe dhe këshilloi. Të gjitha këto, ai i shkroi në një mënyrë të veçantë, impresionuese. Veprat e tij vazhdojnë të impresionojnë jo vetëm myslimanët, por edhe lexuesin e jashtëm jomysliman. Rol të madh për të njohur më gjerë veprat e Mevlanës, luajti djali i tij Sulltan Veledi, i cili ishte edhe poet. Ai ka shkruar se Mevlanës i përkasin 7745 poezi të shkruara persisht. Ndërsa të parat përkthime që erdhën në shqip janë ato që solli të përshtatura poeti ynë i madh, Naim Frashëri si: “Fyelli”,

7. Këtu: Dashuri hyjnore.

“Zogu dhe djali” e përshtatur nga poezia e Mevlanës, si dhe “Këshillat e një zogu...”.

Divan-i Kebir (Divani i madh). Kjo vepër përmban më tepër gazelet dhe rubairat e Mevlanës. Është një vepër e madhe e përbërë prej afro 40000 vargjesh dhe prej 21 divanesh. Mevlana, si te “Divani” dhe “Mesnevija” ka përdorur si gjuhë persishten popullore. Megjithëse pak, aty gjenden poezi edhe në gjuhën arabe e greke. Në këtë vepër Mevlana ka përdor pseudonimin Shemsi, në shenjë respekti për të, prandaj edhe vepra gjendet me emrin “Divan-i Shemsi-i Tebrizi”. Pavarësisht së në lindje dhe në perëndim është e njohur më shumë “Mesnevija”, personalitetin e tij të vërtetë e paraqet vepra “Divani-i Kebir” apo “Divan-i Shemsi-i Tebrizi”, sepse në këtë vepër përshkruhet në hollësi transformimi i Mevlanës dhe, vetë ai tregon thellësitë shpirtërore të ndjera dhe të përjetuara gjatë këtij rrugëtimi. Kjo vepër ka ardhur me poezi të zgjedhura në gjuhën shqipe si botim i dytë në vitin 2011 nga Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”.

Mesnevi Manevi. Mesnevija është një kryevepër me afër 26000 vargjesh, ku përmbledhet pjesa më e madhe dhe më me interes e Mevlanës, në trajtimin e temave fetare, filozofike,

moralo-etike dhe shoqërore. Në këtë vepër zë vend pothuajse çdo lloj çështje që i intereson individit dhe shoqërisë, me interpretimet më të bukura, me krahasime e shembuj të pashoq, si dhe me argumentet më të efektshme e bindëse. Mesnevija nuk mund të lexohet në rrafsh drejtvizor. Kuptimi i shqiptuar i tyre është kuptimi më i sipërfaqshëm. Kuptimet më të thella, gjenden të mbuluara prej fjalës së jashtme dhe kërkon kulturë letrare e fetare, njohje të historisë së qytetërimeve dhe të besimeve, si dhe njohje të stileve klasike. Kjo është arsyeja që zakonisht thuhet se Mevlana lexohet në mënyra të ndryshme, në mjedise kulturore të ndryshme.

Kjo vepër është lexuar nga myslimanët dhe të huajt, është përkthyer në gjuhë të ndryshme, si në anglisht, gjermanisht, frëngjisht., kurse me poezi të zgjedhura ka ardhur në gjuhën shqipe në vitin 2007 nga Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi” dhe e plotë në vitin 2010 nga botuesi Logos-A, Shkup.

“Fih ma Fih” (Gjëja brenda gjësë). Kjo është një vepër e shkruar në prozë që përfshin bisedat dhe pyetje-përgjigjet nga Mevlana. Vepra reflekton ngjarje të ndryshme, mendime, jetën, bindjet e tij, por edhe të kohës. Vepra përbëhet nga 75 kapituj, ku gjashtë prej tyre janë në gjuhën arabe dhe të tjerat në gjuhën perse. Kjo vepër është përmbledhur

pas vdekjes së Mevlanës nga nxënësi dhe djali i tij, Sulltan Veledi, të cilët më parë i kishin mbajtur shënim bisedat e tij.

Mexhalisi seb'a (Shtatë kuvende). Kjo është një vepër që përmban predikime dhe ligjëratat të Mevlanës nëpër xhami dhe ka shtatë kapituj, të shkruara si shënime nga nxënësit e tij. Përveç komentimit të ajeteve dhe haditheve sipas tematikave, në këtë vepër iu është dhënë hapësirë poezive të Senait dhe Attarit, disa tregimeve nga Mesnevija, si dhe poezive nga Divan-i Kebir.

Mektubat (Letrat). Kjo është një vepër që përbëhet nga letrat që u ka shkruar Mevlana shumë personave për shkaqe të ndryshme. Një pjesë të tyre ua ka dërguar të afërmeve, fëmijëve dhe nxënësve. Ndërsa pjesën më të madhe të tyre ua ka dërguar drejtuesve dhe personaliteteve të rëndësishëm, për ti njoftuar në lidhje me kërkesat e nevojtarëve.

Koncepti i dashurisë sipas Mevlanës

Vetëm kjo frazë e Mevlanës në fakt flet shumë: “Çdo gjë që them duke përshkruar dashurinë, kur prapë vij përpara dashurisë, turpërohem për fjalët e thëna më parë”. Efektin dhe llojin e kësaj dashurie, djali i Mevlanës, Sulltan

Veledi, e shpjegon kështu në librin e tij “Veledname”: “Qysh prej kohës së profetit Adem e këtij, kanë ardhur në botë shumë ‘njerëz të plotësuar’⁸ dhe ashik të mbaruar, por mbi këta, ka edhe një botë shpirtërore tjetër, pozita e së cilës është më e lartë, sepse përmban ‘ashikun’ dhe ‘mashukun’⁹ bashkërisht. Përpara daljes së Shemsi Tebrizit, kjo lloj bote e kësaj lloj dashurie, nuk dihej publikisht dhe nuk predikohej haptazi. Prandaj, mund të thuhet me plot gojën se Shemsi Tebrizi ishte një nga përfaqësuesit e fshehur të kësaj bote të panjohur, i cili erdhi dhe ja zbuloi këtë sekret Mevlanës, për ta pajisur me të. Në këtë mënyrë, Shemsi u paraqit dhe doli jo si ‘mbreti i ashikëve’, por si ‘mbreti i mashukëve’ dhe e frymëzoi Mevlanën me këtë frymë të re.

Parimi sufist i Mevlanës dhe vija e tij, mund të shpjegohet në këtë mënyrë: Më parë dashuria hyjnore në sufizëm ishte e njohur me gjithë kuptimin e fjalës dhe e tretur në shpirtin e ‘dashuruesit’, i cili ia afronte këtë lloj dashurie Zotit të tij. Por Mevlana, me frymëzimin e Shemsi Tebrizit, nuk e la këtu. Dashurinë e Zotit e pajisi edhe me një kuptim të ri, ku tregonte se, jo vetëm ‘njeriu i plotësuar’ është ‘dashuruesi’ i Zotit, por edhe Zoti vet, kur i afrohet kjo dashuri nga njeriu, bëhet njëkohësisht edhe Ai

8. Insani-kamil.

9. Të dashuruarin.

‘dashurues’ i tij. Ashtu siç shprehet edhe Zoti në Kuran: “**Allahu i do ata dhe ata e duan Allahun**”¹⁰, kuptojmë që dashuria në fillim i përket Allahut dhe Ai më mëshirën e Tij të pafundme e kthen atë te njeriu. Deri në atë kohë, kjo lloj dashurie reciproke nuk ishte komentuar dhe shprehur në këtë mënyrë si Mevlana, i cili frymëzohet siç thamë nga udhëheqësi i tij shpirtëror Shemsi Tebrizi.

Kurrë nuk është vonë të pyesësh veten: “A jam gati ta ndryshoj jetën që po bëj? A jam gati të ndryshoj nga brenda?” Pavarësisht moshës që kemi, sado që kemi gabuar në jetë, është gjithnjë e mundur të rilindim. Nëse çdo ditë e re e jetës tënde është kopje e ditës së kaluar, është për të ardhur keq. Çdo frymëmarrje është një mundësi për të rilindur. Ka vetëm një mënyrë për të lindur në një jetë të re: Të vdesësh para vdekjes. Meqenëse e dinte shumë mirë prirjen e njeriut për tu zhytur në gjumin e shpërfilljes, Mevlana ka përdorur gjithnjë një stil tronditës. Çdo fjalë e tij është një shpatë ‘plot perla ribashkimi’. Një shpatë kjo që i ‘rilind’ njerëzit. Ai i fton të gjithë ‘të vdesin përpara vdekjes fizike’. Ja pra, në këtë thënie fshihet një nga perlat më rrezatuese dhe një nga temat më të thella të oqeanit të diturisë, sepse ai që e vret në zemrën e tij këtë botë, e cila nuk është gjë tjetër veçse një fushë loje, do të lindë në një jetë

10. Maide, 5/54..

krejtësisht të re. “Kjo botë është një burg, thyjei prangat dhe çliroje veten”, - thotë Mevlana. Njeriu do të rilind dhe do të fitojë gjallërinë e vërtetë, vetëm kur të ketë mposhtur egon, pra botën e tij të brendshme. E thënë ndryshe, njeriu që fiton betejën me botën e tij të brendshme, do të ketë një diell, që do të ndriçojë me risi botën e vjetër.

Që të mund t’i kuptosh fjalët shumë të thella të arifëve¹¹ si Mevlana, nën drejtimin e një të ‘plotësuarit’ në atë fushë, duhet ndjekur një rrugë e tillë, ku të përjetohen përvojat shpirtërore. Sepse misticizmi është një dije që i përket gjendjeve shpirtërore. Prandaj Mevlana është i vetëdijshëm se jo të gjithë njerëzit mund t’i kuptojnë këto sekrete të zemrës dhe, kjo varet nga shkalla e aftësisë perceptuese dhe e ngritjes shpirtërore. Për më tepër, të kuptuarit vështirohet akoma më shumë kur Mevlana në veprat e veta flet me simbolika dhe metafora. Për këtë, Mevlana ankohet shpesh dhe gjithnjë shpreh brengën se mund të keqkuptohet, apo se nuk do të kuptohet. Kjo duhet të jetë edhe arsyeja kur ai thotë: “Duhet të hesht. Të hesht. Dhe ta lë dashurinë të përshkruajë vetveten; nën një përshkrim të lumtur, të gëzuar që s’merr fund kurrë”. Le ta ilustrojmë këtë ide me disa vargje të shkëputura nga Mesnevia e Mevlanës:

11. Gnostikëve.

**Vetëm Zoti e di
se ç'është dashuria**

Lëngatë zemre është dashuria,
një bashkim zemrash, - thotë njerëzia.

Gjersa s'e dimë nga vjen, është intime,
origjin' e saj na thonë është Divine.

Sa herë mundohem ta shkruaj, ta shpjegoj,
nga turpi skuqem, nuk mundem ta tregoj.

Ndonjë i ditur rreh që ta shpjegojë,
po dashurin' s'gjen fjalë që ta tregojë.

Nëse nxiton më parë atë ta shkruash,
bën prapa kthehu edhe fillon të vuash.

Mendimi bije si një gomar në baltë,
të dyja i ka ajo, dhe helm, dhe mjaltë.

Si diell rrëfëhet, në botë nuk ka të dytë,
po ta vështrosh në sy, të dhembin sytë.

LITERATURA

- Abdulkaki Gölpınarlı, *Mevlana Celaleddin*, İstanbul 1959.
- Abdullah Hamiti-Urata Agagiyshi, *Interpretimi i këngës 'Neji' te Mevlana Xhelaluddin Rumi*.
- Ahmed Eflaki, *Ariflerin Menkıbeleri*, çev. Tahsin Yazıcı, İstanbul 1986.
- Annemarie Schimmel, *Ben Rüzgarım Sen Ateş/ Mevlana Celaleddin Rumi'nin Hayatı ve Eseri*, çev. Senail Özkan, İstanbul 2000.
- Bediüzzaman Füzuanfer, *Mevlana Celaleddin*, çev. Feridun Nafiz Uzluk, İstanbul 1986.
- Cihan Okuyucu, *Mevlana*, İzmir 2007.
- Elif Shafak, *Dyçet rregullat e dashurisë*, Përktheu Taulant Hatia, Tiranë 2011.
- Feridun b. Ahmed Sipehsalar, *Mevlana ve Etrafindakiler* (Risale), çev. Tahsin Yazıcı, İstanbul 1977.
- Irene Melikoff, *Batı Humanizmasının Karşısında Mevlana'nın Humanizması*, Mevlana: Yirmi Altı Bilim Adamının Mevlana Üzerine Araştırmaları (Haz. Feyzi Halıcı), Konya 1983.
- Mehmet Önder-İsmet Binark-Nejat Sefercioğlu, *Mevlana Bibliyografyası*, Ankara 1974.
- Menduh Bamja, *Mevlana, poet i dashurisë*, Referatë, 2013
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Fibi ma Fib*, Çev. Meliha Ülker Tarıkahya, 1954.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Mecalis-i Seba*, Türkçesi M. Hulusi, İstanbul 2001.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Poezi të zgjedhura nga Divan-i Shamsi Tabrizi*, përktheu Baba Qazim Bakallı, përshtati në shqipen e sotme nga Vehap Shita, Tiranë 2011.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Poezi të zgjedhura nga Masnavi Ma'navi*, Shqipëroi Dhori Qiriazı, Tiranë 2007.
- Mevlana Xhelaleddin Rumi, *Mesnevi*, Shqipëroi Mithat Hoxha, Shkup 2010.
- Nexhat Ibrahimı, *Mevlana Xhelaludin Rumi*, Referat, 2011.
- Nurettin Topçu, *islam ve insan/ mevlana ve tasavvuf*, İstanbul 1998.
- Reşat Öngören, *Mevlana Celaleddin Rumi*, DVIA, 2004.
- Said Türkoğlu, *Aşk Yolcusu/ Mevlana ile Aşk Yolculuk*, İstanbul 2008.
- Sultan Veled, *İbtidaname*, çev. Abdulkaki Gölpınarlı, Konya 2001.
- Şefik Can, *Mevlana/ Hayatı Şahsiyeti Fikirleri*, İstanbul, 1995.
- Şems-i Tebrizi, *Makalat* (Konuşmalar) çev. M. Nuri Gencosman, İstanbul 1974.
- Vahit Göktaş, *Mevlana-Şems Münasebetinde İnsan-ı Maşuk Felsefesi*, Tasavvuf İlmı ve Akademik Araştırma Dergisi, Ankara 2005.

Një analizë e veprave të Hoxhë Hasan Tahsinit

Burbuqe Meta
Kolegji Universitar Bedër

Abstrakt

Hoxhë Hasan Tahsini njihet si një nga personalitetet më të shquara të botës shqiptare. Ai ishte më i dituri dhe më i formuari ku ndihmoi në përhapjen e diturisë, në mbrojtjen e atdheut dhe çështjes kombëtare. Hoxha Tahsini është një personalitet që rikthehet nëpërmjet zbulimit. Në të vërtetë ai s'ka qenë asnjëherë i harruar, emri i tij përmendej thjesht si njeri i njohur nga bashkëkohësit e shekullit XIX. Ai është fitues i shumë titujve të ndryshëm. Hoxhë Hasan Tahsini ka dy jetë: jetën e tij të thjeshtë dhe gati asketike si njeri mes lindjes dhe vdekjes së tij fizike dhe jetën e librave dhe veprës së tij intelektuale, që nuk i përfill, nuk kufizohet nga kufijtë koborë. Jeta e parë është përkohshmëria njerëzore, jeta e dytë është pavarësia e tij. Hoxha Tahsini nuk është një dijetar i formës, por dijetar i përmbajtjes. Ai ishte dijetar i pjekur, i bindur se dija dhe shkencë janë, në substancë, universale. Ky universalitet i jep kuptim edhe termit të sotëm globalizëm. Askush si Hoxha Tahsini, midis shqiptarëve dhe bashkëkohësve të tij, nuk i ka njohur shkencat e zakte. Ai është vlerësuesi maksimal i shkencave e zakte si matematika, fizika dhe kimia. Janë shkencat e zakte dashuria dhe atributi i tij i përkorë, janë pikërisht këto shkencë ato që përbëjnë “kushtetutën mendore” të kretj veprimtarisë së tij.

Hoxhë Hasan Tahsini (1811-1881)

Hoxhë Hasan Tahsini, (Hasan Osman Rushiti) lindi në fshatin Ninat të Konispolit më 7 prill të vitit 1811 (ndonëse ka edhe versione të tjera për lindjen një ose dy vjet më vonë). Shkollën e mesme e mbaroi në medresenë e Shkodrës, ndërsa të lartën në universitetin e Fatihut në Turqi. Hasan Tahsini është ndër personalitetet më të rëndësishme shkencore e kulturore që ka nxjerrë bota shqiptare në shekullin XIX. Ai i bëri një shërbim të çmuar Atdheut, zgjimit dhe forcimit të ndërgjegjes kombëtare, mësimit të gjuhës shqipe, si dhe përhapjes së diturisë në masat e popullit. Sami Frashëri thotë: “Hasan Tahsini ishte nga njerëzit më të mëdhenj që shumë rrallë e me vështirësi i lindi shekujt dhe epokat”. U bë rektori i parë i universitetit të Stambollit. Hasan Tahsini, jo vetëm që nuk e harroi asnjëherë se ishte shqiptar, por, meqë ishte ndër shqiptarët më i formuari, më i dituri, më i ngrituri, gjithnjë printe në çështjen shqiptare kombëtare. Ishte ndër të parët që hartoi një alfabet të veçantë për gjuhën shqipe. Ishte ndër të parët nismëtarë për themelimin e Shoqërisë Kulturore Shqiptare të Stambollit. Dhe ishte nga të parët në themelimin e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881).

Hasan Tahsini, përveçse ishte atdhetar, ishte edhe dijetar, mendimtar, përkthyes, poet, shkrimtar e letrar. Ishte një iluminist enciklopedist...! Sipas burimeve turke, Hasan Tahsini ishte njeriu më i ditur i kohës në Stamboll, jo vetëm në shkencat natyrore, por edhe në ato letrare, filologjike, filozofike, teologjike. Hoxhë Hasan Tahsini ka shkruar, botuar më shumë se 20 libra shkencorë për astronomi, psikologji, pedagogji, etj. Studimet e tij, fillimisht i botoi në revistën shkencore: “Mexhmua-l-Ulum”, themelues i së cilës ishte ai vetë.

Duke vlerësuar veprimtarinë e tij krijuese dhe patriotike shteti shqiptar i ka dhënë titullin “Mësues i Popullit”(1961) dhe Urdhrat “Për veprimtari patriotike” të kl. II (1962), dhe “Naim Frashëri”, kl. I (1995). Së fundi u botua monografia “Profesor Hasan Tahsini”, në tri vëllime (Tiranë, 2009) e autorit Laurant Bicaj, që është botimi më i gjerë i bërë deri tani për Hasan Tahsinin.¹

1. Hoxha Tahsini, profili shqiptar i ndritur i shekujve

Ekzistojnë shumë personalitete të mëdha të historisë, që duket sikur i mbulon pluhuri i harresës. Pastaj vjen një ditë dhe, ashtu siç zbulohen monumentet e një qytetërimi

1. “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame”, Botimet KMSH, Botimi 3, Tiranë (2015), f. 74-76.

të humbur, zbulohen figurat e jashtëzakonshme të personaliteteve, që kohërat paradoksale i mbulojnë me tisin e rëndë të mjegullës, ose me rërat e shkretëtirave të pafundme. Një personalitet i tillë, që rikthehet nëpërmjet zbulimit, është Hoxha Tahsini. Ai punoi dhe shkroi në epokën kur iluminizmi dhe romantizmi evropian perëndimor krijuan horizonte të reja të perceptimit botëror edhe për emancipimin e popujve të suazës perandorake osmane dhe të Lindjes së Lartë. Duke parë krijimtarinë e tij, mund të vëresh pa mëdyshje se vektori kulturor dhe filozofik europaerëndimor, sidomos ai anglez, francez dhe gjerman, shkencat moderne ekzakte, etj., janë poli frymëzues i përsiatjeve, konkluzioneve në kahun e zhvillimit dhe të progresit botëror.² Nëpërmjet leximit të veprave të Hoxha Tahsinit mund të dallosh sesa modern dhe i thellë është ai, madje edhe sot, me analizat e tij paraprijëse.

Astronomia dhe Kozmogonia, të cilat Hoxha Tahsini i njihje mirë, i zmadhojnë përmasat e mendimit të tij. Askush si ai midis shqiptarëve dhe bashkëkohësve të tij nuk i ka njohur shkencat ekzakte. Ai është vlerësuesi maksimal i shkencave ekzakte si matematika, fizika dhe kimia. Janë shkencat ekzakte dashuria dhe atributi i tij i përkorë, janë pikërisht këto shkenca ato që përbëjnë “kushtetutën

mendore” të krejt veprimtarisë së tij.³ Interesante janë vëzhgimet dhe mendimet e tij për shkencat linguistike të antikitetit, të mesjetës dhe të kohërave moderne. Hoxha Tahsini flet për zanafillat e shkrimit dhe i kushton rëndësi të madhe hartimit të alfabetit dhe shkrimeve fonetike. Në këtë fushë ai reflekton një dituri marramendëse. Hoxha Tahsini jo më kot hartoi edhe një alfabet origjinal për gjuhën shqipe. Profili i shqiptarit Hoxha Tahsini, është profili jo i pjesshëm por i plotë i enciklopedistit. Parimi kulturologjik i enciklopedizmit konstruktiv u përqafua nga shqiptarët e shekullit XIX. Krahas Hoxha Tahsinit dhe Sami Frashërit duhen përmendur edhe Faik Konica e më pas edhe Fan Noli. Enciklopedizmi i füllëzuar nga Hoxha Tahsini është një nga meritat e tij më të spikatura dhe më të qenësishme.

Ajo që të habit është se Tahsini i jep rëndësi parësore dhe botës psikike, botës së mendjes, vullnetit dhe imagjinatës. Ky korrelacion është modern. Kështu Tahsini përruron një hulli të füllësës së modernitetit të shkencave dhe të iluminizmit, si dhe lidhjen midis induksionit dhe deduksionit.⁴ Të shumta janë edhe shkrimet e tij për shkencat juridike, politikologjinë, të drejtat dhe liritë njerëzore. Ai ka një vështrim të emancipuar për kuptimshmërinë juridike dhe ligjet e përparimit të shteteve dhe njerëzve.

2. Hoxha Tahsini, *Vepra*, Përgatiti për botim Manushaqe HALILI, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese: Onufri, Tiranë (2013), f. 13.

3. Po aty, f. 14.

4. Po aty, f. 20.

Për herë të parë për profilin e Hoxha Tahsinit ka shkruar, me stil epigramatik, Sami Frashëri, një binjak shpirtëror i tij. Samiu thotë se Tahsini i jepte rëndësi të madhe njohurisë së përgjithshme të njerëzimit sesa të individëve, pra e preferonte shkencën antropologjike kundrejt historisë. Për Samiun Tahsini qe “njeri i madh që rrallë e nxjerrin shekujt dhe kohërat”. Tahsini qe “dashnor i dijes dhe shkencës, i së drejtës dhe së vërtetës”.⁵ Samiu thekson: “Çallmën e mbante të shpartalluar, flokët të pa prerë për një kohë të gjatë dhe ky njeri në dhomën e tij mbante të varur në mur një thënie në frëngjisht, brenda një kornize: “Për çdo send një vend dhe çdo send në vendin e vet.” Jo se nuk i pëlqente rregulli, por ai ishte në sektin e qenieve më të ditura, në botën e mendimtarëve.

Përveç Samiut, disa personalitete të tjerë me origjinë shqiptare dhe ish nxënës të tij kanë thënë fjalë vlerësuese për Hoxha Tahsinin, siç vijojnë më poshtë: “*Hoxha Tahsini ishte në radhën e njerëzve të mëdhenj. Ai kishte një shpirt fisnik. Është për të vajtuar që veprat filozofike të shkruara prej tij u shpartalluan, meqenëse ranë në duar të pakujdesshme dhe të paditura.*” (Riza Teufiku, *filozof me origjinë shqiptare.*)

“*Hoxha Tahsini, në lëmin e fizikës, astronomisë, matematikës, kimisë e kozmografisë, qe aq i ditur e i regjur sa që kur fliste për çdo çështje që u përkiste këtyre lëmenjve, asnjëherë nuk kishte*

nevojë të hapte librin. Ishte shumë i aftë për të thënë në mënyrë të përsosur ato që dinte; çdo gjë që fliste e lidhte me praktikën.” (Dervish Hima)

2. Hoxhë Hasan Tahsini (kolana në tre vëllime)

2.1. Çfarë përmbajtje ka vepra e Hoxha Tahsinit?

Vëllimi i parë i veprës së Hoxha Tahsinit, me mbi 200 faqe, shoqërohet me vlerësimin e Sami Frashërit, si edhe me vlerësimin e Moikom Zeqos. Manushaqe Halili ka shkruar parathënien me titullin: “Hoxha Tahsini: Frymëzimi, krenaria dhe përkushtimi im.” Kapitujt kryesorë në vëllimin e parë janë: “Historia e qenies ose e krijimit”, “Sekretet e ujit dhe ajrit”, “Psikologjia” etj.

Vëllimi i dytë prej rreth 350 faqesh, përmban lëndë të përkthyer nga dy numra të revistës shkencore “Mexhmua-l-Ulum”, në të cilin kanë interes “Rregullorja për botimet e zakonshme” dhe bisedat për problemet me shumë interes të kohës së tij, ku shumica janë aktuale edhe sot. Në këtë vëllim të bie në sy tema “Përparimi i arsimit, historia, klasifikimi dhe frytet e shkencave.”

Vëllimi i tretë, me rreth 300 faqe, ka të botuar lëndën e disa numrave të revistës shkencore dhe vijon me “Historia e shkurtër e astronomisë.”

5. Po aty, f. 17.

2.2. Historia e qenies ose e krijimit

“Historia e Qenies ose e Krijimit” e shkruar nga ana e poetit, dijetarit dhe filozofit të madh Hoxha Tahsini, për një çështje shumë të lartë të Fuqisë Krijuese, ka të bëjë me dijen për gjendjet e shpirtit. Shkencat natyrore, sidomos kapitujt që lidhen me krijimin e Gjithësisë, janë shumë të rëndësishme për Hoxha Tahsini, aq sa shkencat e tjera i duken të panevojshme. Kjo e mëson njeriun me fillimin dhe fundin e tij. Për Hoxha Tahsinin koha është një fillim pa shtyllë dhe një lumë pa fund, që rrjedh hovshëm drejt ndryshimeve qiellore. Ajo prek veprimtarinë e pandërprerë dhe mund të thuhet pa frikë se është esenca e kuptimit të krijimit.

Duke marrë për bazë hadithin e Profetit Muhamed s.a.s: “Kërkojeni diturinë prej djepit deri në varr.”⁶, Hoxha Tahsini thotë se së pari duhet të zbulojmë djepin, e pastaj varrin. Kjo do të thotë se nën kontrollin e shkencave ekzistuese, duhet të hulumtojmë nga erdhëm dhe ku do të shkojmë. Sipas tij, brigjet e disa shkencave janë të ngjitura për skajet e lumit të kohës dhe janë autoritete për sqarimin e disa periudhave të kohës së amshueshme, të cilat njëkohësisht, janë të lidhura ngushtë me të ardhmen, për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur në shtratin e këtij lumi kohor.

Historia e Krijimit na tregon madhësinë e mijëra trupave qiellor, që, me urdhër të Zotit, lundrojnë në

gjithësi, e krahas asaj madhësie na tregon pafundësinë e gjithësisë. Në këtë pafundësi tregohet fuqia dhe madhështia e Zotit, mikrodimensioni i rruzullit tokësor, si dhe parëndësia e llojit njerëzor. Të gjitha këto i bën për të shërbyer si vatër e zbulimit të moralit. Hoxha Tahsini në shkrimet e tij përpiqet që të vendosë në relata pozitive fenë dhe shkencën. Madje, ai thotë se çdo shkencë e ka obligim që të shprehë një pjesë prej periudhave të caktuara të historisë së gjithësisë dhe të vëzhgojë një hallkë të zinxhirit të qenies.⁷

Vetë Hoxha Tahsini, nëpërmjet shkencave të ndryshme si, kimi, matematikë, biologji, fizikë, astronomi, filozofi, psikologji, etj., arrin të dalë në përfundimin se këto shkencë janë hallka të një zinxhiri, që e çojnë njeriun drejt Krijuesit të Gjithësisë. Hoxha Tahsini i jep një rëndësi shumë të madhe historisë së krijimit, duke u bazuar edhe në Ligjet e Krijuesit të Gjithësisë. Krijuesi i Vërtetë është mbi shkallët dhe botët e zhvilluara dhe është përtej sistemeve të tyre. Ai, Emanues (Zoti) i plotë është Burimi i të gjithë lumenjve galaktikë dhe ekzistenca e tij eternale nuk është e lindur e as e përbërë. Krijuesi i Lartë është larg prej plotësimit dhe ndryshimit. Është Sistematizuesi dhe Vepruesi i së mirës, së bukurës, së drejtës, së vërtetës, fillimit dhe kthimit të çdo gjëje, si dhe i matematikës, logjikës dhe i metafizikës.⁸

7. Po aty, f. 46.

8. Po aty, f. 76.

2.3. Sekretet e ujit dhe ajrit

Në bazë të njohjes së plotë dhe të veçantë të kopshteve të begatshme të shkencës dhe me punën e palodhshme e të hollësishme dhe përkrahjen e pashembullt të mendimtarëve, është provuar se uji dhe ajri, si burime të jetës së të gjitha gjallesave, janë dy perla shumë të çmuara të arkës përplot begati të Zotit të Lartmadhëruar. Bazuar në thënien: “Ajo që nuk mund të kuptohet tërësisht nuk lihet krejt”, me këtë vepër Hoxha Tahsini synon ngjalljen e mendimeve të dijetarëve në lidhje me paraqitjen e karakteristikave dhe sekreteve të panumërta të ujit dhe ajrit. Nëpërmjet vargjeve të mëposhtme Hoxha Tahsini bën një përshkrim sa fetar edhe shkencor të pikës së ujit ku thotë:

E ngjashme si pika e Ba'së
(shkronjës B) *në bismelen* (bismilah),
Pika e ujit është provë e lumit të
madh,
Zoti i ka sqaruar cilësitë e ujit,
Çdo gjë të gjallë e krijova prej ujit
(ue xhealna mine'l-mai kulle shej'in hajj)...⁹

Hoxha Tahsini, nëpërmjet shkrimeve të tij shkencore, synon të tregojë se vlera individuale e çdo trupi në natyrë dhe rëndësia e tij ndaj trupave të tjerë, përcaktohet në bazë të gjerësisë hapësinore, të cilën ai e përfshin në botën e pafundme. Për

rrjedhojë, përfshirja e katër anëve të tokës nga uji dhe ajri, pozicioni i oqeanëve në rruzullin tokësor tregon qartë peshën dhe rëndësinë e këtyre dy substancave të tejdukshme ndaj të tjerave. Thënë shkurt, Hoxha Tahsini i bën një analizë dhe studim të thellë shkencor ujit dhe ajrit, duke treguar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e tyre për njeriun dhe për gjallesat e tjera, por jo vetëm.

2.4. Psikologjia

Hoxha Tahsini është i pari studiues shqiptar që është marrë me hulumtime të mirëfillta edhe në rrafshin e psikologjisë. Njëra nga veprat e shumta shkencore të tij është edhe “Psikologjia”, botuar në Stamboll në gjuhën osmane, më 13 ,1894 vjet pas vdekjes së tij, nga dijetari turk me origjinë shqiptare Nadiri Fevzi. Psikologjia sipas Hoxha Tahsinit është një shkencë e rëndësishme që flet për shpirtin dhe fuqitë (proceset) e tij, si dhe mbi natyrën e rezultateve të këtyre fuqive (proceseve), është shkencë mbi psikikën e njeriut, e cila ka të bëjë me fuqinë arsyetuese, është shkencë që merret me aftësinë që ka njeriu për të folur e për të arsyetuar, aftësinë për të komunikuar, etj.

Krahas objektit të psikologjisë, Tahsini trajton edhe lidhjen e saj me shkencat e tjera, veçanërisht me logjikën dhe me filozofinë.

9. Po aty, f. 87.

Ai e konsideron psikologjinë si “bazë të logjikës” dhe si rezultat të përfutur nga hulumtimet në fushën e filozofisë, por thekson se psikologjia dhe filozofia nuk janë një. Duke e vlerësuar më shumë psikologjinë në krahasim me degët e tjera të filozofisë, me të drejtë shtron nevojën e studimit të saj. Ai mendon se pa i studiuar si duhet e në thellësi fuqitë (proceset) psikike, është e pamundur të formulohen konkluzione me vlerë teorike dhe praktike mbi psikologjinë e njeriut.¹⁰

Njeriun, Tahsini e koncepton si qenie të arsyeshme me intelekt dhe aftësi të shumta për të njohur realitetin. Kurse ndryshimin e njeriut nga kafshët e shikon sidomos në aftësinë e tij, domethënë të njeriut, për të menduar e për të folur. Por pas shumë mendimesh të drejta e thellësisht shkencore shprehet: “Lavdëruar qoftë Zoti, që është krijuesi më i mirë.” Në këtë vepër Hoxha Tahsini jep mendime mjaft të avancuara e shkencore, sidomos për kohën, vendin dhe kushtet, në të cilat punonte e jetonte.

2.5. Revista shkencore (Mexhmua-l-Ulum)

Hoxha Tahsini, disa vite pas largimit nga detyra e Rektorit të parë të Universitetit të Stambollit, kishte botuar një revistë shkencore të quajtur “Mexhmua-l-Ulum”,

që në shqip do të thotë: “Revista shkencore” ose “Përmbledhja e shkencave”. Prandaj edhe dy vëllimet e tij janë një përmbledhje e shkrimeve të revistës shkencore “Mexhmua-l-Ulum”, në periudha të ndryshme kohore. Temat e përzgjedhura nga Hoxha Tahsini janë të larmishme, ku në qendër të tyre qëndron shkenca, siç mund ta kuptojmë edhe nga vetë emri i revistës, por nuk mungojnë as ndërthurja e temave fetare.

Siç e përmendëm edhe më lart, Hoxha Tahsini ishte njohës shumë i mirë i shkencave ekzakto, njohës i filozofisë, i universit hapësirë dhe kohë, i universit njeri dhe botë, që kudo vë dorë me synimin për t’i bërë me dije njerëzit, rrezaton një magji tërheqëse: e ka ëndërr të madhe arsimimin dhe qytetërimin e njeriut. Vizioni i tij për të nesërmen e globit njerëzor mbetet i hapur, përsosmëri e paarritshme. Por ajo që të mrekullon është pasioni, eleganca dhe mjeshtëria përmes të cilave ai sjell dhe provon të mbjellë farën e dijes, të shkencës më të përparuar të kohës.

Në një nga numrat e revistës shkencore, Hoxha Tahsini sjell një fjalim historik të një ministri francez të kohës për arsimin (Zhol Feri), i cili polemizon me klerikët, që ngrihen kundër reformave të ndërmarra në këtë fushë, arsimin, që Hoxha Tahsini e shihte si dritaren e vetme drejt përparimit dhe qytetërimit. Dhe natyrisht, fjala e ministrit vjen si një vringëllimë dhe shkëlqim shpate, që

10. Po aty, f. 161

pret nyje dogmash terri: “...vetëm liria, liria e mendimit, mendja e lirë është e shenjtë, s’ka shenjtëri mbi të.”¹¹, e përfundon fjalën ministri. Duke paraqitur këtë fjalim ai kërkon ta zgjojë, siç thotë edhe vetë, nga përgjumja e lodhur më shumë se dy

mijë vjet dijen njerëzore. Kërkon t’i hapë rrugë, ta vetëdijësojë mendjen e njeriut, të depërtojë përtej dhe të zgjerojë hapësirën e dijes, duke kërkuar njëkohësisht edhe shkaqet e këtij lëngimi që nuk merr fund në jetën e njeriut, e me sa duket rrezikon të jetë i përjetshëm.

11. Po aty, f. 151.

PËRFUNDIM

Hoxhë Hasan Tahsini ishte një njeri me cilësi dhe virtyte të larta, që janë përcjellë deri tek ne në ditët e sotme. Duke i dhënë rëndësi të madhe studimit dhe shpjegimit të temave të ndryshme shkencore, Hoxha Tahsini synon që nëpërmjet shkrimeve të tij të frymëzoheshin edhe mendimtarë e dijetarë të tjerë, të zgjoheshin nga gjumi i thellë ku kishin rënë. Hoxha Tahsini me anë të krijimtarisë së tij na përcjell një mesazh shumë domethënës, na tregon se shkenca dhe feja janë në relata pozitive dhe se çdo shkencë është një hallkë e zinxhirit të pafund që na çon te Krijuesi i Gjithësisë.

Dija, gjithashtu ka një rol të rëndësishëm te çdo individ, pasi vetëm dija e bën njeriun me kuptimin e plotë të fjalës njeri. Ai na mëson se njeriu nëpërmjet arsimimit arrin majat, ndryshe nga i padituri që është shumë i ulët. Hoxhë Tahsini, duke e vlerësuar shkencën si shumë të dobishme, na shtyn neve të hulumtojmë rreth temave shkencore, të cilat na mësojnë se nga kemi ardhur e ku do të shkojmë. Padyshim Hoxhë Hasan Tahsini është një shembull mjaft i mirë për tu ndjekur nga të gjithë njerëzit, pa dallim moshe, sepse populli shqiptar ka shumë nevojë për njerëz të tillë me vlera dhe virtyte, siç ishte hoxha i nderuar.

BIBLIOGRAFIA

1. “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame”, Botimet KMSH, Botimi 3, Tiranë (2015).
2. Hoxha Tahsini, *Vepra*, Përgatiti për botim Manushaqe HALILI, Vëllimi 1, Shtëpia Botuese: Onufri, Tiranë (2013).
3. Hoxha Tahsini, *Vepra*, Përgatiti për botim Manushaqe HALILI, Vëllimi 2, Shtëpia Botuese: Onufri, Tiranë (2013).
4. Hoxha Tahsini, *Vepra*, Përgatiti për botim Manushaqe HALILI, Vëllimi 3, Shtëpia Botuese: Onufri, Tiranë (2013).

Analiza e artikujve të Salih Vuçiternit në revistën “Zani i Naltë”

Zamira Islami
Kolegji Universitar Bedër

Abstrakt

Shqipëria ka një të kaluar shumë të ndritur dhe shembullore për sa i përket personaliteteve vendas, intelektualë e boxhallarë. Shumë prej tyre, në shumë aspekte, janë sot burim frymëzimi. Ata ishin njerëz, të cilët u formuan në shkollat e vendit dhe jashtë tyre, e më pas, çdo aftësi dhe energji të tyre, e derdhën mbi shoqërinë shqiptare, ku u bënë shkak për shumë zhvillime pozitive në këtë vend.

Salih Vuçiterni, ishte një nga këto personalitete të ngritura të shoqërisë sonë. Qoftë me formimin e tij, qoftë me vizionin dhe horizontin që posedonte, ai luajti një rol shumë të rëndësishëm në institucionin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Fjalët kyçe: Fe, reformë, institucion, Islam

Rreth Salih Vuçiternit

Salih Vuçiterni u lind në Vushtrri të Kosovës, më 8 prill 1881. Mbaroi shkollën Normale dhe Universitetin e Fesë Islame në Stamboll.

Më 6 shkurt 1910 deri më 30 dhjetor 1912 qe drejtor i Normales

së Dibrës. Nga 14 qershori deri më 3 shtator 1914 ka qenë drejtori i arsimit i prefekturës Drin. Nga 24 qershori gjer më 2 tetor 1919 shërbeu si inspektor arsimit në Shkodër dhe nga fundi i 1919 gjer më 1920 qe nënprefekt i Matit. Më 1920 nënprefekt i Tiranës, 1920-

1922 prefekt i prefekturës së Drinit (Dibrës). Në vitet 1921-1925, 1928-1930, 1937-1939 dhe 1943 u zgjodh si deputet i Parlamentit shqiptar, përfaqësues i prefekturës së Dibrës.

Në shkurt 1927, pas disa çrregullimeve në vakëfin shqiptar, ku ai ishte drejtues, dhe dështimit të reformës në medrese, Vuçiterni bëri thirrje për një reformë në institucionet bamirëse, thirrje e cila çoi në polemika.

Shërbeu si ministër i Punëve Botore në qeverinë Kota. Gjatë mandatit ai u hetua për korrupsion.

Ai ishte një nga dy njerëzit e besueshëm të Ahmet Zogut për riaktivizimin e Komitetit të Kosovës së bashku me Ismet Kryeziun nga Gjakova.

Vuçiterni u zgjodh si drejtues i një komisioni qeveritar përgjegjës për Reformat Agrare në Shqipëri, një komision që praktikisht nuk arriti asgjë të rëndësishme pos ndihmave për familjet kosovare që kishin braktisur Kosovën për të zgjidhur anën agrare në zonat qendrore të Shqipërisë. Në vitin 1939 ai u zgjodh nga Italianët si Drejtor i *SITA-s* italiane (kompanisë përgjegjëse për energji elektrike e logjistike), duke e zëvendësuar Qemal Vrionin. Në vitet 1921-1939 dhe 1942-1945 Vuçiterni ka qenë drejtor i përgjithshëm i Vakëfeve.

U arrestua nga komunistët shqiptarë, në fund të vitit 1944 dhe u dënua si kriminel lufte. Më

19 maj 1949, u dënua së bashku me Musa Gjylbegun me burgim të përjetshëm.¹

HYRJE

Shqipëria ka qenë e bekuar të kishte në gjirin e saj njerëz të cilët punonin e sakrifikonin për atdheun e shoqërinë. Ka pasur hoxhallarë, të cilët nuk e këmbyen me asgjë sakrificën, mundin, durimin që kishin për fenë e Zotit. Ka pasur njerëz, të cilët me idetë dhe dituritë e tyre, ishin dhe janë akoma burime frymëzimi për të rinj dhe intelektualë. Shqipëria, gjithashtu, ka pasur fatin e saj të mirë, të kishte njerëz, të cilët me intuitën që u kishte dhënë Zoti, me përkushtimin serioz dhe me dituritë e thella, t'i ofronin shoqërisë vizion dhe t'i hapnin horizonte të reja. Ka pasur gjithashtu fatin të ketë hoxhallarë, të cilët e paralajmëronin shoqërinë rreth fenomeneve të rënda që mund t'i kaplonte ata dhe u ofronin alternativa për të shpëtuar nga ato lloj situatash.

Në këtë punim, do të analizojmë vizionin që kishte Salih Vuçiterni, për një mbarëvajtje të shkëlqyer të institucionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si ai i paraprinte disfatave dhe cilat alternativa rimëkëmbjeje parashtronte. Salih Vuçiterni, ishte një ndër ata intelektualë, të cilët,

1. https://sq.wikipedia.org/wiki/Salih_Vu%C3%A7it%C3%ABrni

së bashku me shumë hoxhallarë të tjerë, paralajmëruan ardhjen e një sistemi të egër dhe të pamëshirshëm kundrejt njeriut, i cili do të shfaroste të gjitha vlerat njerëzore e fetare. Për këtë arsye, ai ngulte këmbë dhe kritikonte ashpër qëndrimin e përgjumur që mbanin drejtuesit e institucioneve fetare, si dhe besimtarët myslimanë në tërësi. Ai ofroi një sistem të mirëfilltë, më të organizuar dhe më të përditësuar me kohën dhe u bënte thirrje të gjithë hoxhallarëve, intelektualëve, krerëve të institucioneve dhe besimtarëve në përgjithësi, që të zgjoheshin nga gjumi dhe rehatia, e të rimëkëmbnin veten dhe shoqërinë, si nga ana ekonomike ashtu edhe gjallëria fetare.

Një ndër intelektualët myslimanë dhe një ndër drejtuesit e vakëfeve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, është Salih Vuçiterni. Në këtë studim, janë prezantuar artikujt e Salih Vuçiternit. Qëllimi i këtij studimi është nxjerrja në pah e personalitetit të tij dhe përfitimi nga idetë dhe vizioni i një intelektualit të tillë.

Në vëllimin e parë të revistës “Zani i Naltë”, Salih Vuçiterni flet në emër të Komisionit të Lartë të Sheriatit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku pasi tregon rreth strukturës së ngritur të Komunitetit Mysliman dhe rëndësisë së saj, ai ngre shqetësimin për domosdoshmërinë e sigurimit dhe përmirësimit të

gjendjes shoqërore të Komunitetit Mysliman dhe si zgjidhje shtron hapjen e Medresesë së Naltë të Tiranës. Ai thotë se Medreseja e Naltë, Komuniteti Mysliman, do ta kryejnë misionin e tyre, duke arsimuar brezat, duke i financuar ata me bursa dhe duke sjellë profesorë të përgatitur. Mirëpo, Salih Vuçiterni nuk e kufizon me kaq, por thotë se sigurimi dhe përmirësimi i mbarëvajtjes së Komunitetit Mysliman, është në dobi jo vetëm të këtij komuniteti, por në dobi të të gjithë shtetit. Kështu që, për përmirësimin e tij, duhet të bashkohen të gjitha forcat shoqërore e shtetërore.²

Deklaratë mbi nevojën e reformave

Në vëllimin e dytë të revistës “Zani i Naltë”, gjenden shumë artikuj të intelektualit, Salih Vuçiterni. Në faqen 195 të saj, zë vend artikulli ku bëhet fjalë për nevojën e reformave.

Vuçiterni thekson faktin se për një të ardhme të ndritur të Islamit në Shqipëri, ndihet nevoja e reformave në xhami dhe në medrese. Ai thotë se duhen ndërtuar aq xhami sa Komuniteti Mysliman ka nevojë, e jo më shumë, për arsye se nuk do të frekuentohen dhe se investimet e përdorura aty, mund të përdoren

2. Kolana “Zani i Naltë”, vëll. 1, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2015:657-659.

më mirë në medresetë e Komunitetit Mysliman. Ai bën një përshkallëzim mjaft të bukur në këtë artikull, duke e nisur çështjen që nga parimet dhe ligjet e Zotit në Tokë. Vuçiterni thotë se asnjë mbretëri, deri më sot, nuk i mbizotëroi dot të rejave të kohës, për sa kohë që ajo mbretëri nuk iu përshtat asaj. Nëse edhe ne si myslimanë, duam të jemi liderët e shoqërisë, duhet që patjetër të punojmë fort sot, duke u formuar teologjikisht dhe shkencërisht, në mënyrë që të premtojmë të ardhme të ndritur për pasardhësit tanë nesër.

Në artikullin e tij, vihet re qartë brenga dhe dëshira e tij e madhe për ta parë edhe një herë shoqërinë islame në Shqipëri, të lulëzojë ashtu siç i ka hije.

“Shkakaku kryesor që më shtyni të rroki pendën në dorë, asht dishiri i madh që kam t’a shoh edhe elementin mysliman të Shqipërisë ashtu si më don zemra e më kënaqet shpirti; prandaj më vjen si me i a pasë uha t’i drejtoj fjalën, me qëllim që të zgjohemi prej gjumit të randë në të cilin kemi ra e t’i hapim mirë syt që të mund të shofim udobisht se ç’asht tuej na u kërcnue.”³

Vuçiterni vë theksin se, ne si myslimanë, Allahu na ka nderuar, duke na bërë pjesë të bashkësisë së Profetit të Tij të Fundit dhe na ka sjellë një shariat me principe të shëndosha, të përshtatshme për të gjitha kohërat. Duke qenë kështu, nuk i ka hije një besimtari që të rrijë vendnumëro, të flejë gjumë, e të mos përpiqet për të arritur lumturinë në të dyja botët. Vuçiterni, pas kësaj thotë se, sa më

3. Vëll. 2, fq. 196-197.

e madhe është begatia e Allahut mbi ne, aq e madhe është edhe pesha e përgjegjësisë. Pesha e përgjegjësisë është aq e madhe, sa që nuk ka kohë të merremi me kritika, me thashetheme, me dashakeqësi, me plane individuale, etj., por duhet që sa më parë t’i përvishemi punës për të kryer edhe detyrën e ngarkuar nga Allahu edhe për t’u lënë brezave një situatë të lumtur.

Në pjesën e fundit të artikullit, Vuçiterni zbret deri në detajet e organizimit të Komunitetit Mysliman. Thotë se është i nevojshëm organizimi i vakëfeve në mënyrë që Komuniteti Mysliman të jetë i zoti të financojë veten e tij. Së dyti, është nevoja për të mbajtur nën kontroll ndërtimin e xhamive. Ato duhet të ndërtohen në varësi të numrit të popullsisë besimtare myslimane e jo dokudo, e që më pas të qëndrojnë të mbyllura. Është e nevojshme, gjithashtu, ngritja e instituteve, të cilat do të përgatisin mësues të kualifikuar për të dhënë mësim nëpër medrese. Së fundmi, u duhet dhënë rëndësi akoma më e madhe medreseve, të cilat duhet të jenë edhe për vajza edhe për djem edhe për jetimë edhe për fukarenj edhe për të pasur. Së fundmi, duhen organizuar edhe sisteme konviktesh, të cilat do të jenë me kushtet më të fundit dhe të jenë të hapura për të strehuar nxënës, të cilët dëshirojnë të mësojnë akoma më shumë dhe nxënës të cilët nuk kanë mundësi banimi.

Nji përgjegje z. Hafis Xhaferit⁴

Në këtë artikull, Salih Vuçiterni i kthen përgjigje një intelektual të viseve të Korçës, i cili kishte lexuar artikullin e tij të lartpërmendur dhe e pyet se, ku mendon z. Vuçiterni se është më e përshtatshme hapja e medreseve dhe se a nuk është e nevojshme hapja qoftë edhe e disa klasave në Jug të Shqipërisë? Ai e fillon këtë artikull duke e falënderuar z. s'Uej për pyetjet dhe duke e lavdëruar popullin e viseve të Korçës për përpjekjet që ata kanë bërë prej vitesh duke qenë liderë në fushën e arsimit, qytetërimit, edukimit, kulturës, etj. Duke iu përgjigjur pyetjes, Vuçiterni, si fillim sjell disa statistika të numrit të nxënësve që ndodheshin nëpër medresetë e vendit. Aty vihet re se numri në total ishte rreth 324 nxënës, në 12 medrese. Me këtë, Vuçiterni është i mendimit se do të ishte më e udhës që këta nxënës të mblidheshin në një medrese të ciklit fillor dhe të mesëm, e më pas të kalonin te Medreseja e Naltë. Kështu, do të dyfishohej numri i nxënësve, por edhe do të rritej cilësia e tyre. Në të kundërt, nëse do të kishte kaq shumë medrese në të gjithë vendin, automatikisht do të kishte edhe një numër të madh mësuesish. Kjo bën që të mos mbulohen dot shpenzimet për rrogat e mësuesve, por edhe nëse mbulohen, nuk do të ishte e

4. Po aty, fq. 274.

arsyeshme një shpenzim kaq i madh për 6 apo 12 apo 30 nxënës, duke qenë se ata mund të mblidhen në 1 medrese dhe ato para të shpenzohen për kushtet e tyre. Për sa i përket vendit, Vuçiterni është i mendimit se medresetë duhen hapur aty ku ka më shumë interesim nga shoqëritë myslimane.

Përsëri rreth deklaratës s'ime⁵

Në këtë artikull, z. Vuçiterni replikon me grupin e Ilmijes së Shkodrës, të cilët në një artikull tjetër, pretendojnë se i janë përgjigjur reformave, për të cilat ngre zërin Vuçiterni, por, në fakt, nuk i janë përgjigjur asgjëje të tillë. Vetëm se kanë theksuar se reformat nuk janë në përputhje me Sheriatin e Naltë. Këtu, Vuçiterni u kërkon sqarim të kësaj çështjeje, nëpërmjet argumenteve duke i marrë një e nga një fjalitë e tij, ose në të kundërt, Ilmija e monopolizuar e Shkodrës, të heqë atë shkrim, duke folur për temën që ajo dëshiron. Vuçiterni, ua shpalos në këtë artikull edhe shkrimin e tyre. Ai u thotë se nuk janë të qartë në shkrimin e tyre, sepse në fillim kanë folur për diçka, e në fund për diçka tjetër. Ai u kërkon që të praktikojnë mirë rregullat e polemikës, në mënyrë që edhe problemi të qartësohet më mirë.

5. Po aty, fq. 332.

Prap rreth deklaratës s'ime⁶

Edhe në këtë artikull, z. Vuçiterni, përballet me grupin e Ilmijes së Shkodrës, të cilët, në artikujt e tyre, përsëri nuk parashtruan asnjë argument për të vërtetuar se reformat që kërkonte Vuçiterni, ishin jashtë Sheriatit të Naltë. Jo vetëm që nuk parashtruan argumente, por kërkonin prej Vuçiternit që ai të shpjegonte qëllimin se përse ai i kërkonte këto reforma. Vuçiterni, u përgjigjet edhe një herë, duke u sjellë ndërmend rregullat e polemikës, të cilët nuk po i zbatonin dhe duke u drejtuar pyetjen se “përse zotnia e tyre ndiheshin aq të shqetësuar rreth atyre reformave, apo mos ndoshta kjo u prishte rehatinë?!” Vuçiterni, nuk u jep asnjë shpjegim por u qëndron fort fjalëve që ka thënë, dhe u bën thirrje “Ilmijes së Shkodrës” që të jenë seriozë dhe të zbatojnë rregullat e polemikës siç u ka hije. Vuçiterni u thotë se atë artikull ai e mbron me gjithë fuqinë e tij dhe nuk ka nevojë për askënd që ta mbrojë pasi ai artikull është i bazuar mbi të drejtën dhe të vërtetën.

Nji përgjigje fletores “Demokratia” e cila botohet në Gjirokastrë⁷

Në këtë artikull, Salih Vuçiterni i përgjigjet pyetjes që ngren z. Samarina rreth moslejimit të prishjes

6. Po aty, fq. 393.

7. Po aty, fq. 434.

as një centimetër të një xhamie për ndërtimin e një xhamie tjetër dhe dyshimit që z. Samarina ngre rreth të ardhurave të xhamisë së Pazarit të Gjirokastrës dhe rreth xhamive të tjera në Shqipëri.

Duke qenë se Salih Vuçiterni, ishte pjesë e Këshillit të Lartë dhe Drejtor i Përgjithshëm i Vakëfeve, ai u përgjigjet mjaft mirë pyetjeve të z. Samarina. Në fillim e sqaron rreth ndërtimit të xhamive duke i thënë se Këshilli i Lartë vepron sipas statutit të miratuar me vota dhe jo sipas kokës së vet. Sigurisht ky statut, është i nxjerrë në bazë të rregullave të Sheriatit. Së dyti, e sqaron se xhamia e Pazarit të Gjirokastrës nuk ka aq të ardhura, sa ai pretendon, dhe e informon se së shpejti, Drejtoria e Vakëfeve do të botojë bilancin e gjashtëmujorit, ashtu siç ka bërë gjithmonë, dhe z. Samarina mund t'i ndjekë shumë herë më mirë të ardhurat dhe shpenzimet aty.

Myslimani i sotshëm si do të jetojë nesër?⁸

Historia është pasqyra e jetës së gjithë kombeve të botës. Ajo është gjykuesja e shoqërisë njerëzore. Ajo na kallxon lindjen e gremisjen e popujvet dhe shkaqet e përparimit ose shdukjes së tyre. Tue qenë të sigurtë pra, se nesër, populli Mysliman qi jeton sot në Shqipëri, do të jetë përgjegjës para kësajë gjykuesje së ndershme, dubet të mejtobemi e t'a pyesim vehten se jetën

8. Po aty, fq. 467.

*t'onë si ka me e përsbkrue historia? Asht shumë e lehtë me iu përgjegj kësaj pyetjeje me fjalë, por tepër e randë me vepra!*⁹

Në këtë artikull, Salih Vuçiterni shtron edhe një herë nevojën e madhe për reformë në shoqërinë myslimane, sidomos në mentalitetin e saj, duke e lexuar mirë kohën dhe duke u parapërgatitur për të rejat e kohës. Ai thotë se armiku më i madh i suksesit dhe ai që i ka gjuhëzuar perandoritë e mbretëritë e mëdha, është dehja në rehati dhe mentaliteti (uexhedna abaena¹⁰). Për sa kohë që edhe myslimanët në Shqipëri, nuk shpëtojnë nga ky mentalitet, nuk mund të përparojnë dhe, me keqardhje, duhet thënë se do t'i përgatisin fundin vetes së tyre dhe vetëm do të mbeten një kujtim në histori. Myslmanit, nuk i shkon të jetojë një jetë boheme. Por duhet që, për hatër të vlerave të larta që mbart ai libër i shenjtë që ndjek, të jetë aktiv, i zjarrtë, i zellshëm dhe kërkues për të arritur lumturinë në dy botët. Ai thotë se sot, është koha për të qarë për gabimet tona dhe koha për

9. Po aty, fq. 467.

10. "Uexhedna abaena" – Me këtë shprehje të gjuhës arabe vihet theksin në ajetin kuranor "Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe ne po ndjekim gjurmët e tyre.", Esh-Shu'ara' 26:74 dhe në ajetin kuranor "Jo, por i kemi gjetur të parët tanë që vepronin kështu", Ez-Zuhruf 43:22, nëpërmjet të cilëve nënkuptohet apatia që ka pllakosur shoqërinë myslimane shqiptare dhe gjendja e tyre të përgjumur. (shënim i redaksisë).

t'u rigjallëruar në të gjitha fushat e jetës dhe për të bërë më të mirën si myslimanë. Këtë artikull, siç e citon edhe vetë ai, e ka shkruajtur në bazë të kërkesave të lexuesve të revistës "Zani i Naltë", pasi ata kërkuan me insistim botimin e numrit ku gjendej artikulli i domosdoshmërisë së reformave, sipas Salih Vuçiternit. Kështu që, në pamundësi të ribotimit të atij numri, Salih Vuçiterni zgjedh ta risjellë edhe një herë në letër, në një mënyrë më të detajuar, duke e pasuar edhe në numrat e tjerë në vazhdim, atë që kishte shkruar në numrin e shkuar.

Deklarate e II.¹¹

Edhe në këtë artikull, Vuçiterni sjell në letër realitetin e shoqërisë myslimane në Shqipëri, e cila është kanosur në një gjumë të thellë dhe ka humbur kontaktet me botën e përparuar. Dje, ishin myslimanët ata që sollën standarte, kurse sot, kur thua mysliman, të vijnë në menje të gjitha virtytet negative që ka njeriu. Na bie detyrë e madhe të gjithëve, që ta zhdukim këtë njollë të zezë, dhe të fillojmë të edukohemi me dëshirën për të punuar, për t'u përpjekur dhe të marrim shembull popujt e përparuar pasi kjo është edhe një porosi profetike.

¹¹Vëll.2, f.501.

Deklerata e II.¹²

Në këtë artikull, Salih Vuçiterni, jep një zgjidhje për problematikat e mëdha, që e kanë kapluar shoqërinë myslimanë në Shqipëri. Ai thotë se në radhë të parë, njeriu duhet t'i bëjë reformim vetes së tij dhe të mësohet me të rejat. Shqiptari, në të shumtën e rasteve, e ka të vështirë të braktisë një mentalitet, një sistem jetese dhe shpeshherë as nuk e dëshiron diçka të tillë, e të kalojë në një sistem tjetër. Edhe kur ai e shikon se jeta që ka ndërtuar, zakonet që praktikon, mentaliteti që ka, janë në kundërshtim me Sheriatin, as në këtë pikë nuk merr guximin të ndryshojë. Në fakt, duhet të jetë e kundërta. Sidomos myslimani, duhet të jetë vazhdimisht në kërkim të më së mirës, në kërkim të së resë. Kjo duhet të bëhet për të shpëtuar nga mjerimi, për të penguar shkatërrimin. Popujt e qytetëruar, edhe pse me vështirësi, kanë kryer reforma të ndryshme në jetën e tyre, derisa arritën të vendosnin standarde të reja. Në fund të këtij artikulli, Vuçiterni thotë se e vetmja rrugë për të arritur një ndryshim pozitiv, në plan individual dhe shoqëror, është arsimi. Ai është i vetmi mjet që ndriçon mendjen. U jep fuqi dhe energji të reja brezave dhe shoqërive. Arsimi duhet të nxitet dhe të aplikohet në medrese, faltore, konferenca dhe në revistën fetare “Zani i Naltë”.

12Vëll.2, f.528.

Ç'është Kur'ani?¹³

Në këtë artikull, Salih Vuçiterni i kërkohet një shkrim rreth temës “Ç'është Kur'ani?” Këtu ai bën një përshkrim të përgjithshëm, sipas pikëpamjeve të tij, se ç'është Kur'ani. Shpeshherë vë theksin se të përkufizosh Kur'anin me disa rreshta është diçka e paarritshme, sepse Kur'ani nuk mund të kufizohet dot. Megjithatë, ai i përmend një e nga një vlerat e Kur'anit, largpamësinë e tij, vizionin e tij, orientimin që u bën njerëzve dhe popujve, duke na risjellë para syve bëmat e popujve të mëparshëm; nxitjen e Kur'anit rreth kërkimit të diturisë nga mikro te makro; të qenët e Kur'anit një libër adhurimi dhe shpëtimi në të dyja botët, etj. Në fund të këtij artikulli, Salih Vuçiterni, për t'u mbyllur gojën kritikëve, se këto fjalë ai nuk i thotë ngaqë është vetë mysliman, por sepse Kur'ani me të vërtetë ashtu është, sjell për këta lexues, një citat nga një intelektual francez, z. Sidijo, i cili edhe ai, megjithëse nuk është mysliman, shpreh fjalët më të rralla për Kur'anin Famëlartë.

PËRFUNDIME

1- Aftësia e intelektualit Salih Vuçiterni për të shprehur aq bukur problematikat dhe për të shpalosur alternativat e zgjidhjes.

13Vëll.4, f.509.

2- E reja është gjithmonë në lëvizje dhe e pranishme dhe në kohët e sotme, me ritme akoma më të shpejta. Energjitë e hoxhallarëve të sotëm, duhet të fokusohen në përbushjen e nevojave të shoqërisë sipas kohës ku jetojmë.

KONKLUZIONE

1- Nevoja për përditësime ka qenë e hershme, që me krijimin e njeriut, dhe do të jetë deri në fundin e botës. Vetë zhvillimi i intelektit njerëzor, dëshmon për këtë.

2- Kritikat janë për të përmirësuar akoma më mirë një

situatë, një shoqëri apo për t'i paraprirë një fenomen negativ. Zgjuarsi, është të dëgjosh deri në fund kritikën, dhe të rishikosh veten dhe punën që bën, në mënyrë që të hedhësh hapa më të fortë dhe më të suksesshëm, sidomos kur bëhet fjalë për t'i shërbyer fesë së Zotit.

3- Për sa kohë që, në masë, do të ekzistojnë karakteret e pasionuara pas rehatisë, dëshirës për famë, pushtet e duartrokitje, edhe sukseset do të jenë të pakapshme dhe shoqëria do të vazhdojë të humbasë në vorbullat dashakeqe. Sido që të jetë, pesha e përgjegjësive, do të mbetet e do të trashëgohet.

BIBLIOGRAFIA

1- Kolana “Zani i Naltë”, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2015.

2- https://sq.wikipedia.org/wiki/Salih_Vu%C3%A7it%C3%ABrni

Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909)

Syrja bej Vlora

Abstrakt

Libri i Syrja bej Vlorës “Historia e personaliteteve shqiptare të Vilajetit të Janinës (1859-1909)” është një punim enciklopedik me vlera të padiskutueshme për historiografinë shqiptare. Kjo për faktin se: e para, përbën përpjekjen e parë në këtë drejtim, në një kohë kur institucionet tona shkencore nuk ishin themeluar ende, e dyta, informacioni që ofrohet për disa personalitete historike përbën një risi.

Në një shënim të faqes një të dorëshkrimit shqip të këtyre biografive, përkthyesi Jonuz Tafilaj shëruan se ato janë përgatitur si aneks i veprës së Syrja bej Vlorës të përkthyer më parë nga Ali Asllani.¹ Megjithatë, për nga volumi i tyre, këto biografi përbëjnë një libër më vete. Prandaj, duke pasur parasysh se ato nuk janë integruar më parë në asnjë version të librit tashmë të botuar të Syrja bej Vlorës, e sjellim për botim për herë të parë në revistën shkencore “Zani i Naltë”.

Ky dorëshkrim është shkruar në gjuhën osmane dhe, së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe, gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit-Tiranë.² Ai ka 78 faqe në osmanisht dhe 120 faqe në gjuhën shqipe, të cilat janë përkthyer nga orientalisti Jonuz Tafilaj. Në inventarin e hartuar nga përgjegjësi i sektorit të dorëshkrimeve osmane në arkivin historik, orientalisti Haki Sharofi, shëruhet data e marrjes në dorëzim të këtij përkthimi (26 qershor 1963).³ Ndërsa për kohën se kur është shkruar nga Syrja bej Vlora, ende nuk kemi asnjë të dhënë.

Megjithëse ky përkthim në dorëshkrim është në dialektin verior dhe përmbante një sasi të konsiderueshme gabimesh, ne jemi përpjekur që të ndërhyjmë vetëm aty ku ishte domosdoshmërisht e nevojshme. Kjo, sepse dialektet, së bashku me përkthimet e realizuara në një periudhë të caktuar, janë një pasuri e jashtëzakonshme dhe mbajnë vlerën e kohës.

Në libër jepen të dhëna mbi personalitetet më të shquar të Shqipërisë së Jugut, e cila, nga pikëpamja administrative, në këtë periudhë, përfshibej në Vilajetin e Janinës. Aty flitet shkurtimisht, e ndonjëherë edhe më gjatë, për formimin, rolin dhe kontributin e emrave të njohur të botës shqiptare. Madje, nuk mungojnë edhe detaje, të cilat, duke pasur parasysh se janë shkruar si pjesë integrale e një libri me kujtime, nuk gjenden në asnjë libër tjetër. Kjo e pasuron dhe e bën më të bukur për lexuesin, por edhe më të vlefshëm si burim historiografik për studiuesit.

Pavarësisht nivelit të përkthimit dhe gabimeve, botimi i këtij libri pjesë-pjesë të “Zani i Naltë” mendojmë se është i nevojshëm. Kjo si homazh për autorin e harruar dhe anatemuar padrejtësisht, për përkthyesin e nderuar, orientalistin Jonuz Tafilaj dhe, në fund, për historiografinë dhe memorialistikën shqiptare.

Dr. Hasan Bello

II

31. Timur (Demir) Pasha, Alizoti, prej Gjirokastrë, grada Bejlerbej i Rumelisë. Timur Pasha pati një farë kulture simbas kohës e në përpjesëtim me shokët e vet. Kuptonte pak shumë arabisht, persisht dhe shkruante mjaft korrekt. Qe prefekt në Berat, në Prevezë e ndër shumë vende të tjera. Por gjatë kësaj karriere që bani nuk u tregue as fort i shkathët as fort i plogët. Gjithmonë zgjodhi

1. Këtu bëhet fjalë për librin *Shqipëria pasosmane 1912-1920*, i cili tashmë është botuar në versionin origjinal i transkriptuar nga osmanishtja në Stamboll në vitin 2009. Në gjuhën shqipe ky libër është botuar në dy versione, me titullin *Kujtime-Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, (përgatiti për botim dhe redaktimi i përkthimit Akad. asoc. Marenglen Verli dhe Dr. Ledia Dushku) Tiranë: ICEBERG, 2013 dhe *Shqipëria pasosmane 1912-1920*, (përktheu nga turqishtja Rubin Hoxha) Shkup: Logos-A, 2015.

2. *AQSH*, F: S. Vlora, D. 8.

3. *Po aty*.

mesin, dhe pat qëllim vetëm si e si me mbajtë për të gjatë kohën e nëpunsit që kishte. Qe i sjellshëm dhe xhentil në fjalë. Pau shumë në jetë e ndodhi ndër shumë punë. Në bisedë qe i drejtë, në marrëdhënie fort vedikatif dhe intrikant, i çveshun prej vetishë të besës. Po t’u ngjit një herë nuk të lëshonte fort kollaj, dhe nuk humbte rastet kur kishte nevojë me t’u lëvyrë. Sillej mirësi ndaj mikut ashtu dhe ndaj anmikut. Qe pjestar i sektit Bektashi. Disa ditë para se vdes ka pa n’ander “hazreti Alinë”, i cili i paska thanë: “çka rrin ma, çou, eja”. Ç’prej kësaj dite Timur Pasha i ashtë kushtue vullnetit të Zotit, dhe pa shti një kafshatë bukë në gojë ka pritë çastin e vdekjes, gati-gati si një vetëvrasës, tue thirrë “O Ali!”. Dhe djali i tij i madh Asim beu, kur qe në Gjirokastrë hypi në kulm të shpisë, e cila ishte shumë e naltë dhe tue thanë “jardëm Ali, medet “(o Ali ndihmë) u hodh poshtë dhe u ba cop-copë. Timur Pasha pat vdek në Stamboll.

32. Syrja bej, Mehmed Vlora, grada Bala. Kujtimi i emënimt t'atij që shkruen këto rreshta kështu e fillon këtë përshkrim. Syrja Vlora midis këtyre personaliteteve zen një vend vetëm për gradën që gëzoi ndërsa jetëshkrimin e tij e gjeni ndër faqet e mbrame të kësaj monografie. Prandaj, u la djemvet të mij me mbushë letrën e bardhë të jetës s'eme, dhe këtyne e nipavet u jap këto këshilla e t'afërmëve e miqvet iu la këto kujtime:

1) Në mos doni me jetue nën zgjedhë të miqvet t'uj, të farefisit bile dhe të vëllaznve t'uej të njaj nane e të njaj babe ruenu mos u zbuloni këtyne mëshesinë e zemrës s'uaj dhe qëllimet e tuaja të veçanta.

2) Të jeni të sigurtë se besë e njerëzi s'ka në këtë botë, këto janë relative dhe të lidhuna n'interesa!! Prej një zemërimi ma të vogël ose prej një refuzimi të një kërkesës s'uaj ma të thjeshtë kjo besë e njerzi thyhet.

3) Nëqoftëse shpresoni me pasë shpërblimin e të mirave që i keni ba kujt të shtyem vetëm e vetëm prej instiktit t'uej fisnik, gaboheni fort; mbeteni përballë një deziluzioni! Nuk them gja tepër në qoftë se pohoj që unë në jetën t'eme u kam pa të keqen atyne që u kam ba mirë. Me të vetmen garantinë t'eme përpara një Sulltani tiran si ç'ishte Abdylhamidi, hyri në seli të naltë njëri ndër vëllaznit e mij; tjetrit vëlla, i hudhun në një skaj të harruem posi një kufomë e kalbun, i shpëtova jetën nëpër aperature të bam prej mjekësh që gjeta unë. Kap

prej këtyne dy vllazënvet e kalo nga i dobëti e deri tek ma i fuqishmi, kujdo që i bana mirë, nuk pashë prej tyne veçse keq!! Këta sa i siguruan vedit një shërbim të naltë, më sollën shpinën; dhe kush i ra ndër kambë Sulltanit me m'internue në Bagdadë, kush u përpoq me hjekë dorë fare pasuninë që kishëm fitue me mundin t'em, në të cilën pasuni pjestova dhe ata tue ba kështu sakrificë, kush doli kundra meje si dëshmitar gënjeshtar ose si shpifës, kush tue përdor gjithfarë falsifikiesh më hangri paret në një kohë që zotnonte miliona, kush akuzoj me spiunazh në favor të hujvet tue shti në punë lloj lloj intrigash me qëllim që me më shue votrën e kush kërkoi mënyrën si e si me u tërheq prej meje që të mos kërktoj shumë prej tyne ndonjë nderë!!

4) Në doni me qenë të qetë, e të sigurtë nga jeta, mundoni me fitue besimin e qeverisë, ma i vogli dyshim i saj ndaj juve ka me ju gatue ma të madhin rrezik t'uejin.

5) Në doni që punët e sjelljet e juaja të mos u ndërlikohen dhe të shpëtoni prej mërzitjes që ju shkaktojnë nëpunsat, të vegjël e të mëdhej, ruenu të mos jeni në detyrim (të mos i hyni borxh) qeverisë.

6) Mos i hyni dorëzanës kërkujt, bash as vëllait t'uej! Ai të cilit i jeni ba dorëzanës, sado i sinqertë që të jetë nuk ka me ça kryet me pague borxhin, dhe vonë a herët ka me gjetë një shkas më keq me jue!! Unë, kujdo që i jam ba darëzanës i kam pa damin. Dhe

kur kam dhanë hua, veç që nuk kam marrë paret e mija, por kam humbë edhe miqsinë e atyne që i kujtojshim për miq.

7) Mos merrni hua prej miqsh, as mos u jepni këtyne hua. Të jeni të sigurtë se të dyja rasat kanë me u ba shkak të prishet miqësia.

8) Me miqtë të jeni të sinqertë, ndër hesape të jeni të drejtë. Në kurrëja e n'as një punë mos u shtyeni në tepri.

9) Sa të jetë e mundur ngushticën tuej të mos ja zbuloni tjetrit. Miqt e t'afërt t'uej kur të marrin vesht se ju ndodheni ngusht, ose kanë me u largue prej jush ose kanë me ju sulmue si armiq, tue dijtë se ju jeni të çarmatosun!

“Syrja Vlora”

33. Xhelal Pasha, Merush, prej Narde, grada Mirmiran. Djali i tij, Xhevat beu pat marrë mbiemnin “Merush”. Pretendonte se kishte një titull noblesë, të mbetun e të trashiguem prej Gazi-Turhan-Bejlerëvet (princa të dinastisë otomane, sh.i.përk.). Xhelat Pasha ka një krushqi me Abedin Pashë Dinon, dhe nuk mori kurrë nëpunësi në jetën e tij, dhe as që pati ambicie me qenë nëpunës. Jetoj me pasuni të vet, dhe u fërgue, si thuhet në vojnin e vet. Qe i mbetë nga kultura dhe jo i shoqnushëm. Njeri i mirë, simpatik, por mizantrop. E bija e tij Safet Hanëmi asht e shoqja e Rasih beut, asht dhandri i Vejsel pashë Dino's.

34. Xhelaleddin Pasha, Mustafa, Vlora, prej Vlore, grada Bejlerbej. Është djali i Ferid Pashë Vlorës, vëllaut t'em të madh dhe i Refet Hanëmit, së bijës së Adem beut, pari e Libohovës. Lindi në Stamboll më 1886, dhe mbasi mbaroi mësimet fillore në Stamboll shkoi në Paris e në Lozanë për plotsimin e tyne, dhe qe për një kohë sekretar i dytë i Ambasadës osmane në Paris. Në vitin 1912 u ba dhanër i Abas Hilmi Pashës Khedivit të Misirit, dhe me një herë iu dha grada Misir Kapu-Qet'hudasi bashkë me bejlerbej i Rumelisë. Ditën që do t'u bante celebrimi i martesës, ra Edreneja (ndër duer të Bullgarëvet, sh.i.p) dhe dasma u ba e thjeshtë pa kurrfarë pompoziteti e ceremonie. Kur më thirri Xhemal Pasha, Komandant i Stambollit për me më nxjerr jasht Stambollit, numuroj si shkak dënimi edhe këtë rast martesë (ba në një ditë fatale për otomanët, kur binte Edreneja ndër duer të armiqvet, sh.i.p) pa mendue se Xhelaleddin Pasha s'mund e ndrronte ose pezullonte ditën e martesës me një bi khedivi, dhe provoj me këtë akt se Ittihatçijt janë në gjendje me marrë nëpër kambë çdo të drejtë për hir të mënivet të tyne personale!! Disa ditë më parë se futet në luftë të përgjithshme Perandoria Osmane, Khedivi Abas Hilmi Pasha i bani një vizitë Kryeministrit Said Halim Pashës, i përcjellun prej Qet'hudajt (dhandrit të tij Xhelal Pashës, sh.i.p.)

Kur me karrocë po hyjshin në Portë të Naltë, një njeri i mallkuemun, i shtyen tinzarsh prej Ittihatçijvet kriminelë, ndër sy të policvet e të kompanisë ushtarake që qëndronte aty afër, shtin me revolver prej një skaji të Portës kundra Khedivit, plagosi atë në një brinjë, në kambë të dhandrit Xhelal Pashën, që i duel përpara për t'a mbrojtun, tue e lanë këtë çal. Atentatori, siç u ç'pallë ma vonë, qe një nacionalist arab, dhe u vra aty për aty prej policve, për të mos u zbulue organizimi gjaksor i atentatit. Në vitin 1923, e shoqja e Xheladin Pashës, princesha Atije Hanëmi, u arratis nga foleja konjugale, u hodh në rrugë t'epshëvet e t'aventuravet, tue abandonue dy fëmijtë. Për këtë shkak, Xheladin Pasha e ndan gruan e vet, la dhe funksionin që kishte si Qet'huda i Misirit. Kjo martesë, mjerisht, që nga fillimi deri në mbarim, qe ogur-zezë për familjen. Xheladin Pasha ishte mjaft i praktikuem ndër gjuhët frëngjisht, anglisht e turqisht. Zotronte virtyte të mira. Por tash s'merret më me ndonjë funksion zyrtar, tani kujdesin e ka të përqendrum në edukatën e dy fëmivët të vet. Ka një natyrë të butë e zemër të mirë. Rruga e jetesës së tij është krejt e ndershme, ashtu siç asht dhe vetë i ndershëm në jetën sociale.

35. Hasan Pasha, prej Preveze, grada Bejlerbej i Rumelisë. Qe njeri me influencë n'at rreth që patën formue Dinollarët. U ndodh ndër

shumë vende si Nënprefekt, brodh poshtë e nalt; qe një pashë i tipit të vjetër që i kishte kanda me ekzagjerue ndër bisedë e kallzime. Kur qe prefekt në Prevezë lajmëroi befas Sarajin Mbretnor se kishte mbjellë ma se njëzet mijë rrajë portokallesh në dy anët e rrugës në mes të Prevezës e Lorosit. Sulltani ia shpërbleu këtë shërbim. Më vonë, kur portokallet mendohej se kanë arrijtë në gjendje me dhanë kokrra, Ministria e Botores dërgoi një nëpunës për me mbledhë produktin, i cili konstatoi se jo ma portokallë me dy anët të rrugës, po në një shesh aty-larg s'kishte kurrfarë druni veç ferravet. Natyrisht këtë gjendje nëpunësi ia kishte raportue autoritetit të vet epëror. Ky marifet i Hasan Pashës, për t'a paraqitë të paqënumen të qenun ishte ba proverbial në gjuhët të popullit, dhe ai vetëm për këtë gja kishte lanë një kujtim të paharrueshëm.

36. Hysejn Pasha Dino, prej Preveze, grada Bejlerbej i Rumelisë. Hysejn Pasha Dino'ja asht i afërm (akreba) i Ahmed aga Dino's, që njihet si themelues i familjes së "Dinovet"; ashte djali i Ibrahim aga Dinos dhe vëlla prej nane i Vejsel Pashës dhe i Abedin Pashës. Hysejn Pasha ç'faqet para syvet t'anë si një përmendore e ndërtume me materjalin e tepruem t'epokës së feudalizmit. Mban një pozë, e cilasuigeneris asht e vetja prej natyre, dhe duket se don të qëndrojë në shkallën e naltë të të parëvet te tij.

Kishte zakon me folë fjalë të mëdha, por këtyne ia kishte pa dënim, aq sa kishte sjellë prej vehte mëninë e urrejtjen e një njeriu si Gani Toptani. Ky i pat hangër bile dhe shumë pare. Megjith këtë, Hysejn Pasha s'hoq dorë nga vesi i tij, dhe gjithmonë mbet po ai që ishte: Fjalë të mëdha, lavde e gaz. Dhe ndër kohën e tij ma të ngusht ai përmendë gjithnjë milionat; por n'anë tjetër s'don t'ia dijë kush në realitet sasinë e cilësinë e pasunisë së tij. Nuk i shporret lehtë një pune që ka kapë në dorë një herë, dhe nuk mërzhitet për t'ia dalë në krye qëllimit. Ka qëndrim të fortë dhe asht i zoti me shti ujët në mulli të vet. S'ka ndonjë kulturë të madhe, por ka një inteligjencë të lindun e eksperiencë. Kështu, një herë më thonë se humbi pozitën e naltë morale që kishte në sy të tjeret dhe as një her nuk i ra shpinda për dhe. Grekët e morën nëpër këmbë, iu kërcënuen, e lanë ndër vuejtje e ndër mjerime. Hysejn Pasha as s'u tund, as s'u tremb. Nuk u nda as nga puna as nga Atdheu!. Për me shpëtue prej grekëvev vu përpara tyne si mburojë shtetsinë e tij turke dhe titullin e pashajt që mbante. Gjithë pasurinë e regjistroi si shtetas turk dhe shpresoj se grekët do t'a pranojshin këtë pretendim të tij. Mendonte se në i realizohej kjo dëshirë do të bahej zot i dyzet milion dhrahmivet. Kujtonte se ka gjetë talizmanin e visarvet të tij dhe kështu bante gjumë t'amëll! Hysejn Pasha nuk i jep krah pares ma fort se gjeneroz asht i shtërnguet. I miku

i thotë mik armikut armik. Nuk iu përulet kujt, dhe gjithë ambicja e tij asht me u tregue një plak i ri dhe me ba një jetë të patravajë. Asht një plak i lumtun dhe i fuqishëm, pse, si thotë vetë, i kanda me fjetë gjithmonë çift (vet'i dytë).

37. Hysejn Pasha, Vrioni, grada Mirmiran. Është djali i madh i Omer Pashë Vrionit dhe babaj i Mehmed Ali Pashës, i Aziz Pashës dhe i Skënder Beut. I parë kur asht nevoja me ruejtë dinjitetin e vet dhe m'e tregue vehten se kush asht, nuk idhimen paret. Në moshë të vogël tue qenë, me 3 Xhemaziulahar 1237 h (3 shkurt 1822) mori gradën Mirmirane dhe u ba Pashë. Shumë kohë ndej në Berat si prefekt, shtypi tmerrësisht rebelët që çuan krye me rastin e çpalljes së Tanzimatit, dhe u përpoq me rivendikue, në mënyrën ma t'egër, gjakun e të vëllait të tij të vogël Jusuf beut që u vra bashkë me disa shokë. Një Kaninas që shtini në dorë, i cili njëhej një ndër të pandehunit e këtij krimi, e mori në lagjen e vet ushtarake që kishte ngrehë n'Ujë të Ftoftë, dhe mbasi mori vesht gjithsesi ngjarjen nga goja e tij, e dogji atë në zjarm. Flitet në popull se ky kaninasi mbasi humbi çdo shpresë shpëtimi, mori prej silahlleku (fushëkores) një copë mëlçi dhe tue iu drejtue Hysejn Pashës, i thotë: “Qe kështu e kam ngrën mëlçinë e Jusufit” dhe e kafshon mëlçinë me dhambë, tue mendue se me këtë vepër i shite trimni Pashës.

38. Hifzi Pasha, Janinot, gjeneral brigade. I dalun prej Akademisë Ushtarake u ndodh për një kohë si komandant i artilerisë që ruante fortesën e Çatëllxhas, me gradën gjeneral brigade. Në kohën e Sulltan Hamidit pozita e tij qe e ndritun, kurse në ditët e Ittihatçijve qe e veshkun. Tue mos ra d'akord me partinë shizmatike t'Ittihatçijvet, mënjanoj kahë partia e Antantës dhe Ittihatçijt e ndoqën e s'e lanë të qetë. Në luftën e Ballkanit megjithse u dallue për ndershmëni dhe zotësi ushtarake, si provuen gjith kolegët e tij që pati në komandë, Ittihatçijt prap nuk e falën, dhe por sa qëndroj në fuqi ata e mërzhitën me qortimet e tyne. Mbas pushtimit të Janinës dhe mbas mizorivet të padurueshme nën të cilat vuante populli, ai u shtrëngue me emigrue, dhe nga ky shkak ra në një ngushticë ekonomike. Burri i butë dhe i sjellshëm, kapërcej ndër grada të nalta i ri tue qenë, vetëm për hirë të zotësisë së tij. Vetëm se pleqnin e kaloj ndër vuajtje.

39. Kristaq Zografos, prej katundit Erindi, grada Rutbei-Bala. Tue qenë një esnaf i pa shpirtë, u fut ndër ndremarrje të dhjetash, u ba i famshëm dhe u pasunue me huanat qu u jepte të mdhanjvet (njerzvet me influencë); fitoj simpatinë e Sulltan Muradit kur ky ishte edhe princ trashëgimtar dhe si hypi në fron ra n'ujdi me dhandrin e Sulltanit, Nuri Pashën, nga i cili mori katër përçind

mij lira kundrejt xhevahresh e sendesh të kushtueshme që i shiti aty për Sulltanin tue mbyllë kështu me këtë shumë borxhet që kishte; dhe mandej u hodh në Paris, tue marrë me vedi pengjet që i kishin lanë borxhlijt. Prej këtyne grabitjevet të vlefshme fitoj një milion e gjysëm lira dhe kështu mandej u ba zoti i milionavet. Nuk u kthye ma në Stamboll. Zgjodhi si vend banim herë Parisin, herë Athinën. Në shpi e në familje të Zogrofosit flitej shqip; por ai vetë u çvesh prej ndjenjave kombëtare fare. Me një pjesë të pasunisë së tij ngriti një ndërtesë madhështore n'Athinë, së cilës i dha emënin e vet, derdhi shuma të mëdha të hollash për vepra bamirsie në Greqi, dhe djali i tij Zografosi bashkë me të dhandrin Karepanos i hapën një plagë vendit t'onë. Zografosi i biri punoj për qëllimet greke si prefekt i Gjirokastrës e si delegat i Epirit të Jugut dhe u përpoq fort me shkëputë prej Shqipnie prefekturat e Gjirokastrës dhe të Korçës. Mbrapa ky me Karapanosin u banë të vetmit shkaktarë të akordit të famshëm të Korfuzit. Karapanos (baba) erdhi në Vlonë dhe qëndroj disa ditë në shpi të Xhafer beut të Selim Pashës, ku kishte ra si mik i Ismail Qemal beu. Në këtë kohë mori nga Pojani tre statuja mermeri që ishin kryevepra artistike të vjetra dhe i nisi për në Greqi nëpër Vjosë me një barkë. Karapanosi qe përkrahë në këtë ndremarrje prej Ismail Kemal beut

e prefektit të Vlonës Ahmed Hilmi Efendi Bendor. Këto tri statuja çmohen sot si vepra të rralla greke dhe mburret Greqia me to. Tue kujtue emnat e Zografosvet, at e bir, këtu kam qëllim me kujtue një rast të hidhun dhe me përmendë me mallkim dy renegatë që mohuen atdheun e vet dhe që i “ranë shqelm të miravet që patën prej mbretnis otomane; se për tjetër s’meritojshin këto të kujtohen. Por këto s’gjetën as në Greqi shpërblimin e tradhëtisë së tyne, aq sa Grekët përbuzën veprën e tyne dhe ua mohuen simpatinë!!

40. Halil Pasha, Ibrahim, Alizoti, prej Gjirokastrë, nga Vezirët otomanë. Djali i Demir pashë Alizotit dhe dhandri i vezir Ahmed Rasim Pashës, i cili qe biri i një Jeniçeri dhe martohet me një vajzë greke n’Athinë në kohën e kryengritjes së Moresë. Vdes para se me lanë Athinën ushtria otomane. Ahmed Asim Pasha e mëson ndër shkolla greke të birin dhe e edukon në fenë ortodokse. Kur ky mbririti në moshën tetëmbëdhjet vjeç, pyet se cili qe i ati i tij. E ama i thotë se një turk dhe i jep një letër turqisht që i kishte pas marë atij para se vdes. Djali merr letrën e shkon në Stamboll, ku takon n’ungjin e vet qe çibukxhi n’Uzunçarshi. Ungji e prët mirë; dhe djali, tek i cili ndjenjat fetare ishin ma të forta se ato kombëtare, bahet mysliman. Plotëson mësimet në Stamboll, hynë

në shërbim të shtetit dhe mbërrin ma në fund me u ba ministër. Halil beu, në Gjirokastrë, në Janinë e kudo që qe me punë i atij, kreu mësimet fillore e të mesme dhe në Stamboll hyni në Kryeministri, në zyrën e përkthimevet. Ndër përkthime në turqisht nga frëngjishtja u tregue i zoti, dhe u emënuë kryekonsull në Haxhebek në kohën kur u ç’pallë lufta ruso-otomane. Mbas luftës u emënuë prefekt në Jenishehir e si ra ky qytet ndër grekë në Serfixhe, e ma mbrapa në gradë bejlerbej i Rumelisë u dërgue në Vilajetin e Vanitsi vali. Mbrapa u trasmetue në Sivas, prej këtu në Bejrut e mandej në Bursa, ku mori dhe titullin e Vezirit. Në një kohë, në saj të miqvet që kishte fitue në Jëlldëz (pallati ku banonte Sulltan Hamdi, sh.i.p.) iu propozua posti i Kryeministrit dhe me dekret mbretnuer u thirrë në Stamboll nga Bursa. Ju dha urdhën t’i paraqitëte Sulltanit një projekt mbi mënyrën e administrimit të mbretënisë, me kusht që të mos dilte nga pallati. Halil Pasha nuk e pritte një provim të tillë, dhe s’kishte një pregatitje kulturore as prespektiva për me qitë në krye këtë punë, për të cilën qe urdhënuë. Megjith këtë ai redaktoj këtë projekt, por i kufizoj mendimet e veta vetëm ndër masa që duhej të merreshin me sigurie qetësinë e Sulltanit dhe për këtë propozonte tamam me taktin e një xhandari, nevojën me mbajtë Stambollin nën një kontroll të vazhdueshëm, tue

zmadhue kështu rrjetin e spiunazhit dhe tue zbatue dënimet ma të randa kundra atyne që mbajshin pak a shum një qëndrim të dyshimtë. Sulltani kishte çfaqë vetëm kënaqsinë e tij ndaj këto mendime sirkonspekte të Halil Pashës dhe e kishte urdhënue me kthye me një herë në vend të vet, tue i dhanë sihariqin se në rasë nevoje mund t'a sillte në Stamboll si Ministër të Xhandarmërisë. Halil Pasha në vend që të prite të zbresë prej selisë së kryeministrit në këtë post, preferoj ma mirë të kthej në Bursa. Un pata rastin një ditë me e pyet se për ç'nevoj ia kishte shtrure Sulltanit ato mendime, e ai mu gjegj, tue pohue se “për t'u rujtë të mos përdorte as ma të thjeshtën fjalë që jepte aluzione të një trajte regjimi konstitucional”. Halil Pasha pati një natyrë të butë, por ndër funksione të nalta që pati nuk u tregue i zoti dhe u ba vegël e disa materialistëve që e rrethojshin. Disa thonë se qe i fortë në frëngjisht; por kush s'ka pa ndonjë prohim të pendës së tij. Turqishten e flitte si një xhandarë analfabet, në një idiomë shumë të dobët. Kjo provon se nuk ia kishte fort haberin letërsisë otomane. Ishte fatalist dhe i lidhun fanatikisht me bektashizmin. Në çashtje paresh i dinte mirë punët e veta, të varfnit dhe dervishët i ndihmonte shumë. Prej të vjehrrit trashgoi një pasuni të madhe. Veç kësaj pat dhe vet një pasuni prej pesëdhjet-gjashtdhjetë mijë lirash, që e la mbas vdekjet. Kur qe në

Bejrut u hapi rrugën e emigrimit për n'Amerikë me mija sirjanëve, megjithse emigrimi ishte i ndaluem, dhe la me hye në Siri me qindra-mija armë të ndalueme. Ka shumë asish që e ngarkojnë me këto faje, të cilat vënë në dyshim karakterin e tij të drejtë. Por për deri sa erdhi si vali në Sivas u njoft për ndershmëninë e tij; vetëm këtu akuzohet si në masakara kundra armenvet. Qe mjaft ambicioz për pozita të nalta! Thuhet se kur dëgjoj që u ba vezir Ferid Pasha qau dhe u smue prej nakarit (smirës). Kur qe në Sefixhe u zu me Vexhhi Efendi Libohovën, dhe ky e paditi. Çashtja e këtyne të dyvet preokupojë me vjetë zyrën e Këshillës së Shtetit. Por mbrapa u hynë ndërmjet dhe u pajtuen Pasha me Vexhhi Efendinë. Ç'prej atëherë Halil Pasha filloi të simpatizojë shqiptarët dhe të mbrojë ata me të cilët kishte bashkpunim. Mbas luftës së përgjithshme u dërgue në Paris si delegat pranë Konferencës së Paqit nga Kolonia e Shqiptarëve të Turqisë. Por këtu ma tepër se me mbrojtë interesat kombëtare të shqiptarëve, ngau mbas interesave të veta personale dhe u muer me grindjet e Ittihatçijve. Në Paris qe kundërshtar i delegacionit që u dërgue nga Durrësi. Një dervish e paralajmëroi se do të vdiste në vendlindjen e vet. Dhe me të vërtete, mbas dyzet vjet nostalgjie që pasoi për vendin e vet, në vitin 1923 kthehet në Gjirokastër, ku vdiq e ku u varros, në teqen e Ali Babait.

41. Halil Pasha, Ibrahim, Kolonja, prej Kolonje, gjeneral brigade. Qe djali i tretë dhe ma i vogli i plakut qindvjeçar të Sulejman Haki Pashë Kolonjës. Nana e tij qe e bija e Abdyl bej Selimit, prej Delvine. Mbas mbaroj mësimit në Liceun mbretnor dhe n' Akademinë Ushtarake plotsoj mësimit për katër vjet me rradhë në Gjermani. Dhëndër i ish-Kryeministrit Ferid Pashës, për hirë të përkrahjes që pati prej tij, në një kohë të shkurtër e në moshë të re mbërriti me pasë gradën e gjeneralit të divizionit. Por mbas adaptimit të ligjit mbi “likuidimin e gradave” u zbrit nga pashallëku, dhe mbasi punoj do kohë si kolonel në seksionin e Shtat Madhnisë së Përgjithshme, u gradue prap si gjeneral brigade. Kur hypi Sulltan Muhamedi V, dhe Halil Pasha qe n' atë tufë që u dergue me i lajmue Sovranët e Balltikut për këtë eveniment. Në luftën e kahershme të Balltikut qe kryetar Shtat-madhenie në një armatë tëperëndimit.

Xhavit Pasha, ky armik i famshëm i shqiptarëve, i cili iku nga droja e serbëve dhe grekëve ishte midis tepricave të atyne ushtrinavet që u strukën në Berat nga disfata që pësuan. Ky gjeneral gjakpirës që nuk qe ngopë me gjak të derdhun shqiptarësh të pa faj, me një lodër tradhtarë desht me i ra Vlonës. Dhe disa mendje-lehtë që kishte afër vedit deshën të bashkohen në veprën kriminale të kësaj bishe. Por në saj të masave t'urta të Ismail Qemal beut

u pengua kjo tentativë e mallkueme e Xhavit Pashës. Në këtë projekt të dështum pati rolin e vet efikas dhe Halil Pasha, i cili bindi gjithë komandantët e ushtrisë, tue fillue prej komandantit të madh Ali Riza Pashës për me marrë një qëndrim kundra projektit të Xhelal Pashës dhe me kërkue indirekt një strehim në qeverinë e Vlorës, tue sigurue në këtë mënyrë gjendjen normale të vendit. Prandaj aq sa meriton të çmohet traktati politik që tregoj në këtë rast Ismail Qemal beu aq duhet t'i jemi mirënjoftës dhe Halil Pashës për rolin efikas që luajti në dështimin e këtij projekti mizor të Xhavit Pashës. Në luftën e përgjithshme Halil Pasha qe në Bernë si atashe-ushtarak pranë Ambasadës otomane, dhe, dashtë e padashtë, partizani i Enver Pashës. Halil Pasha asht i zgjut dhe i zoti e njeri me dinjitet. Përveç turqishtes dhe shqipes, njeh dhe frëngjishten e gjermanishten. Rron në Stamboll në pension, larg nga bota. Ban një jetë të rregullt dhe asht egoist. Kuvendtar e i mbatun.

42. Hajredin beu, Leskoviku, grada Rutbei-Bala. Djali i vetëm i Nedim beut. Qe interpret (dragoman) në Kryeministri, e mbas shpalljes së konstitucionit shef-protokolli në Ministri të Jashtme. U tregue i kulturës me mbledhjen e botimin e disa vepravet historike. Zotnon gjuhë të hueja dhe u njoft si një shkrimtar. Rron në Stambollë në

një skaj t'Ajostefanosit, i larguem nga travajet e punës. Nuk morri as një herë pjesë në përgatitje e në lëvizje kombëtare, por mbeti gjithmonë një nëpunës otoman. Megjith këtë u njoft për njeri i ndershëm e i zoti, i pajisun me virtyte të mira.

43. Hajredin Pasha, Arsllan Pashalliu, Janinot, grada, Mirmirane. Është nga dera e Arsllan Pashës që sunduen në Janinë djalë mbas djali për katër shekuj me rradhë me tituj vezirësh e me funksione valijsh, nip i Asim beut koh baba e prap nip i Ali Pashë Tepelenës kah nana. Njeri vërtetë fisnik, me vetitë ma të mira që mundet me pasë një njeri. Për shumë kohë qe në Janinë Nufus Nazir (Drejtor i Gjendjes Civile), dhe Drejtor i Pasunivet Shtetnore dhe Prefekt i Gjirokastrës. Punoj në Stamboll dhe aty vdiq në 1327 h (1909). Qe i nderuem e i dashun prej të vetëve, shumë bimirës e i shkueshëm megjithëse i pa kulturë.

44. Hajri Efendi, Defterdari, Janinot, grada Bala. Qe defterdar ndër shumë vilajete. Ma shumë se me mësue me hesape (llogarina), mësoj metodën se si me sigurue interes e veta personale. Njeriu i kohës, i zoti me zbulue sekretet e të tjerëve, bimirës në dukje. Kur qe defterdar në Hixhaz hyni në Traikat (u ba bektash). Nuk u muerr me punë kombëtare. Djali i tij Rauf beu, qe martue me Fatime Sulltanën, të bijën e Sulltan

Muradit V, e cila pat ngel e ve nga Vasif Pasha; por e ndau ma mbrapa, dhe kështu i shpëtoi grushtit që u dha Gazi Mustafa Qemali, themeluesi i Republikës Turke, gjith pjestarëve të shpisë mbretnore osmane dhe atyne që kishin krushqi me këtë shpi. Nga ky shkak qe përdorë nga qeveria e Republikës si funksionar i Ministrisë së Jashtme.

45. Daviçon Efendi, Davi, Janinot, grada Ula-Evveli. Qe ndër ma të hatrueshmit, ndër çifutët e Janinës, i zoti i punës dhe administrator i mirë. Në të parin Parlament otoman qe deputet, dhe u njoft për aftësinë e tij. Shum kohë qe kryetar i Gjykatores së Tregtisë së Janinës dhe qe i nderuem nga valijt.

46. Dervish Pasha, nga Preveza, grada Bejlerbej i Rumelisë. Kur ke fatin e bardhë me qenë i përkrahun prej një t'afërmi si i ndjeri Abedin Pasha, ç'vlerë kanë virtytet, dekoratat e gradat, Dervish Pasha ishte edhe krushk edhe nip i Abedin Pashës dhe në saj të kësaj afërmënie dy-krahëshe kishte mbërrijtë me pasë gradën Bejlerbej qysh në moshë të re. Se ç'farë kulture e zotësie kishte Dervish Pasha as nuk pyet kush, si dhe un as nuk shoh nevojën me cekë këtë çështje! Ai që shkruan këto rreshta për shtat vjet ka qenë kryetar i komisionit të Doganavet, ku Dervish Pasha ishte anëtar. Por një herë me thanë ky s'erdhi në Komision dhe as

nuk u muer me punët në lidhje me funksionin e tij. Një herë, si befas, erdhi në Komision, dhe të tjerët që ishin prezent pyetën se cili ishte ky anëtar!! U muer vesht grada e personi i tij. Ma mbrapa Pasha vjen tek kryetari, dhe mbasi shpjegon shkrimet e meritat e tij, tregon se rroga prej katërmij e pesqind grosh që merrte nuk i dilte, prandaj kërkonte t'i shtohet rroga e mbetun nga vdekja e njanit nga shokët. Mbas përgjigjes që mori, e cila natyrisht qe negative, Pasha iku e nuk u duk ma në zyrë! Nga sjelljet e çuditshme të Dervish Pashës, dikush e merrte për të çmendun dhe dikush e merrte për materialist, njeri që “çka të këputesh prej byrekut të Hasanit, qar (fitim) e ke”, dhe të gjithë mbyllshin sytë para gabimeve e hesapeve të tij, tue dijtë përkrahjen morale e materiale që ai kishte prej dajës së vjehrrit të vet Abedin Pashës. Me gjithë këtë, të tana këto thashetheme u ban një andër, një legjendë, pse koha e rrethanat shkrinë pasuninë e të ardhunat dhe pesëmbëdhjetë lirat e verdha të mbetuna trashgim familjes, së Dinojvet. Grekët ia zaptuan gjithë pronat kesaj familje dhe e hodhën këtë në mjerimin ma të madh. Por Dervish Pasha vdiq në Stamboll pa e pa me sy këtë mjerim.

47. Zeqerja bej Dino, prej Filati, grada U Senefi-Sani. Vëllai i Abdylvehap Pasha Dinos. Nëpunësija e parë dhe e fundit e

tij qe ajo që pati në komision të Doganavet si anëtar. Pat relacione me shqiptarin Tahir Pashë Krajën, Krye-armtar (titull nderi) i Sulltanit dhe kishte kulturë, por ishte me veti të mira. Për çështje kombëtare ishte indiferent, jo inteligjent dhe nuk i kandej me hye në bisedime.

48. Rasih bej Dino, nga Preveza, grada Bala. Djali i Abedin Pashës e një shtyllë e familjes së Dinojvet. I njoftun për kulturën e tij, për zgjuarsinë natyrale e për vetitë e mira. Mori pjesë me shpenzime të veta në Konferencë të Londrës i shtyen nga patriotizmi dhe u përpoq sa i erdhi për dore për të mbrojtun interesat t'ona kombëtare. Pesëmbëdhjet vjet qe antar i Komisionit të Doganavet; i emërum Kryetar i Këshillit të Kontrollit para Konstitucionit, u pushua nga puna me t'ardhmen në fuqi t'Ittihatçivet megjithse i papushueshëm. U orvat me mbrojtë të drejtat e veta, u njoft për zotësi, njipte gjuhë të huaja, njeri simpatik e zemër mirë. Meriton mirënjohjen e kombit për shërbimet që solli për të mbrojtë interesat e veta e të bashkëqytetarvet të tij çamë që ngelën nën mizoritë e grekut. Mbasi në Prevezë pasunia e tij kaloi ndër duer grabitqare të grekut, zgjodhi si vend banimi Adanan për të administrue tokat e shumta që i pat lanë aty trashgim baba i tij. La një kujtim të mirë të paharrueshëm.

49. Rustem Pasha, Jakupagalliu, prej Leskoviku, grada Mirmirane. Në za për pasuninë e madhe që kishte, ndihmonte për sa i vinte për dore shqiptarët që shkojshin e vijshin në Stamboll. Punën e etekun (kindin) që kapte një herë s’e lëshonte ma, dhe s’e kishte për kurrë me mërzit të tjerët!! Mun për këtë karakter të tij që qujtë në Stamboll midis të personave të çquem me mbiemrin përbuzës “rriqën”. Megjithse injorant, interesat e veta i dinte fort mirë dhe kishte zotësi në të grumbulluem të pasunivet. Prudent e i matun, por i dhanun së tepri mbas vizitavet. Sesa larg i kishte punët e provoj me suksesin që pati në të shtime në dorë një pasuni ndër rrethe të Sirqexhiut në Stamboll. Por të bijt Vehip e Qani Pasha ia qitën ujit kësaj pasunie që ishte një visar me vlerë të madhe. Megjith këtë për të qenë i paanshëm duhet t’ia kujtojmë një veti të tij të mirë: Ndhimën materiale që i bani Shemseddin Sami beut që përpiquej me hapë një shtypshkronjë. Ashtë për t’u çuditë se të parat porosi që iu dha djemve të vet në shtratin e vdekjes qenë këto: “Jam i sigurt se do t’a shitni pasuninë. Por t’a keni porosi prej meje që trojet e Sirqexhis shitni ma në fund. Mas u ngutni, krejt pasunia është e juaja.” Me gjithë këtë të bijt këto troje i shitën ma të parat dhe pësuen dame të mëdha.

50. Reshid Pasha, Myfti, zade, Janinot, vezir. Prej një familje janinote e njoftun me emnën Myfti-zade. Bir i kësaj familje, Reshid Pasha, u rrit në Stamboll, shërbeu me misione n’Evropë, kohët e fundit që delegat në Komisionin që nënshkroi traktatin e paqes me Italinë dhe ma në fund Ministër i Jashtëm mbas armisticit. Jo kryenaltë, i shkueshëm me të huej gjithmonë ankues nga gjendja e vet, i mbytnun ndër borxhe, dyshues ndaj këdo. Bujar në dukje, por egoist në realitet dhe hipokrit, nuk la një kuptim që të provojë se pati zotsi e takt dhe as ia pa kush të mirën! Kur që Ministër i Jashtëm, tue marrë për pretekst se nuk u aprovua nga Porta e Naltë independenca e Shqipnisë, ua ngatroj punën shqiptarëvet, dhe megjithse iu kujtue që qeveria kishte pranë vendimet e Konferencës së Londrës ndër të cilët vendime ishte dhe ai i independencës së Shqipnisë, ai s’u vu veshin këtyne fjalëvet të drejta, kinse për të provue patriotizmin e tij të tepruem.

51. Rashid Pasha, Kolonja, gjeneral divizioni; nuk kam takue në ndonjë shënim të biografisë së këtij zotnie. Vetëm di se që shok i pa ndam i Selami Pashë Kolonjës dhe njeri i mirë.

52. Selami Pasha, Ahmed, Kolonja, prej Kolonje gjeneral divizioni. Nga parësi e Kolonjës dhe ndër komandantë në za t'ushtisë otomane. Mbasi kreu dhe plotësoi mësimet në gjimnazin e Manastirit dhe n'Akademi Ushtarake, doli prej këtu si oficer i Shtat-madhënisë, dhe la kudo emën të mirë në saj të trimërisë dhe t'inteligjencës natyrale që kishte. Bani shërbime të vlefshme në të te shuemen të kryengritjes e të masakrës që shkaktuen banorët e mallkuem t'Otlluk-Koj'it e t'Avret-Aillam-Koj'it në vitin 1877 dhe në luftrat me Rusinë, tue iu çmue shërbimi me gradat e famën që fitoj. Pati simpatinë dhe besimin e gjith ushtarëve dhe të komandarëvet t'ushtisë dhe kushdo shpresonte prej tij shërbime të mëdhaja. Por pallati mbretnuer nuk e simpatizonte dhe prandaj vetë Sulltani nuk e kishte në sy të mirë personin e tij. Në sa qe n'Edrena midis krenëvet ushtarakë t'Armatës së Dytë, u mbajt nën vërejtje dhe spiunët nuk e lanë të qetë. I fortë fizikisht dhe shpirtërisht, i urtë, prudent, trim e largpamës; punëvet ua mendonte fundin dhe i studionte mirë.

53. Sami bej Shemseddin, Duma, Frashëri, grada Ula-Evveli. Megjith trupin e dobët e shqetsimet e jetesës, Sami beu qe një kolos me zellë e energji që tregoj në të prodhuem të një shumice veprash. Kamusul'aalamin, këtë vepër prej

gjashtë vëllimesh e mijë faqesh, vepër e një mendje e erudite që do t'i kushtonte një kohë prej dy vjetvet tue punue bile me një ndamje punësh, ky dijetar i nderuem i mbaroj dhe i botoj mbrenda një vjetë e gjysëm, tue pregatitë ndër tri katër ditë një fashikull. Ndër vepra të tija të botueme janë dikcionarët e mëdhej turqisht-frëngjisht e frëngjisht-turqisht, një dikcionar arabisht i pa mbaruem e tjera. Në vitin 1288 h (1872) shkoi në Stamboll dhe menjëherë hyni në zyrë të shtypit. Pati nëpunësina në xhezairi-Bahri-Sefit (ishujt e Egjesë që ishin nën sundimin otoman, përbënin, të gjith një vilajet, i cili kishte këtë emën. sh.i.për.) e në Tarabullusgarb (Tripoli) dhe ma në fund vdiq në vitin 1881, qe Kryesekretar në Komisionin e Kontrollit Ushtarak të formuem në Saraj mbretnuer. Megjith këtë preokupacion që i jepte kjo punë nuk i preu relacionet që kishte me fletoren e përditshme "Sabah"; s'e kaloj një ditë me thanë kohën kot dhe mbrrijti me botue, veç një të përkohshmes, edhe nja tridhetë vepra të çmueshme. Vepra e tij teatrale "Besa" ku vehen në dukje ndjenjat t'ona kombëtare, një vepër e zgjedhun, asht e njoftun prej gjithëkujt ndër të dyja gjuhët që u botue, në turqisht e në përkthimin shqip. Për me lehtësue dhimbjet prej të cilavet vuante bante injekcion morfini dy herë në ditë me dorë të vet. Dhe në këtë gjendje tue qenë,

punonte për ditë rregullisht. Sami beu flinte pak, por ndëgjuesin e magjepste me kulturën e tij. Larg thanethashavet, gjithë dashunia e tij ishte te kultura. Në jetën e tij një herë me thanë s'i prishi zemrën kujt dhe s'tha një fjalë të keqe për kënd. Martesën e tij me të vejën e të vëllait të vet të madh Abdyl beut, të cilin e kishte në kambë të babës e shiquen bota me një sy turpi, sepse ishte në kundërshtim me zakonet t'ona kombëtare dhe e dënuen veprën e tij si imorale. Abdyl beu me këtë zojë pati djalin Mid`hatin e vajzën Emine Hanëmin. Kjo është një çashtje ndërgjeje dhe që e dënon relativisht, mirë a keq, publiku. Por un se vë në balancë këtë ngjarje për ta dënuë si turp, mbasi nuk shof nevojë me pakue aspak nderimin e veçantë që kam për Sami bejnë. Në sy t'anë ai mbetet gjithnjë simboli e mishërimi i një ndershmërie dhe personi i tij që i mveshun prej të tanë virtyteve. Në fjalë e në pendë që i matun dhe me sjelljet e tija tërhiqte nderimin e dashurinë e gjithkujtë. Megjith famën e dinjitetin që kishte dhe i zoti me hypë në ma të naltën zyrë, sepse që i lirë me kërkue çka të dëshironte prej Sulltanit, nuk adhuroi pozita dhe nuk iu përul kërkujt. Vdiq në Stamboll, tue lanë mbas vedi një emën të pavdekshëm në veprat e tij, që s'kanë me marrë mort kurrë. Lindi në Frashër në 1850. Në Janinë mësoi shkencat orientale dhe në shkollën greke Zosimea xuni frëngjishten, greqishten e italishten.

54. Selim Pasha, Tepedelenli-Zade (i biri i tepelenasit), Sirri Vezir. Kur Çerkez Reshit Pasha i cili për njëzet e pesë vjet rresht ra si një rrufe qiellore dhe mbi Shqipni shpartalloi shpitë e vjetra dhe nxorri dekretin e vrasjes së Mustafa Pashë Shkodranit me qellim për t'i zaptue pasunitë, që prefekt në Kutahja, këtu qenë internue Veli Pasha bashkë me djalin e vet të madh Mehmed Pasha, dhe këta ishin kinse të sigurtë për jetën e tyne, tue besue në pseudo-drejtesinë e Çerkes Reshid Pashës. Por ky i vrau të dy, xheladi i pa shpirtë ia fali jetën vetëm Selim Pashës, mbasi ky ishte ende i ri. Selim Sirri Pasha mbas pesë vjetëvet mori pjesë në shpartallimin e Jeniçerëvet, dhe atëherë tue marrë titullin "Haxhegjani divini humajune" u emënue në roje të portës afër Dikili-Tashit. Mbrapa dalë-kadalë u nji ndër pozita të nalta, dhe prej Nënprefekturës s'Ajvallëkut, në muajin Ramazan të vitit 1820 u ba vezir bashkë me të vëllain e vet të vogël Ismail Rahim Pashën, dhe ai vetë, Selim Pasha u emënue rojtar i Beligradit. Sulltan Abdylmexhidi desht të tregonte një simpati kundra pjestarvet të kësaj familjeje që u masakruë prej Sulltan Mahmudit, dhe për t'a dëshmuar këtë simpati i ktheu një pjesë të vogël të pasunivet të konfiskueme dhe i lidhi rrogë. Por Selim Pasha s'e harroi kurrë epopenë e tragjedisë së familjes së vet dhe mjerimi që shok i tij i pandamë. Prej zemrës së tij s'u shlye asnjë herë ndjenja e urrejtjes së trashigueme

ndaj shtetit otoman. Thonte se nuk asht për t'u besue otomanëvet. Nënprefekt në Qesendre. Aso kohe një çetë hajdutësh kishte grabitë e çue në mal një grup anglezësh që bajshin një shëtitje në vilajetin e Selanikut. Sirri beu kishte ndjekë e kapë këto hajdutë, dhe si shpërblim të këtij shërbimi ishte emënuë nënprefekt i qendrës së Selanikut. Kishte fitue besimin e simpatinë e valiut Hasan Fehmi Pashës. Veç kësaj simpatie ai u njoft dhe me krenët e Ittihatçijvet, tue sigurue simpatinë e besimin dhe të këtyne. Kur qe Prefekt në Serez iu provue dhe ma tepër zotësia, prandaj me gradim u dërgue prefekt në Ballëkesir. Me rastin, e zgjedhjevet të deputetvet, vuni kandidaturën në prefekturën e Ballëkesirit, pa dhanë dorëheqjen si e donte rregulli; dhe doli deputet, por krenët e Sheref-Sokakut (emni i rrugës ku kishte qendrën partia e Khan-Turqvet “Ittihad-ve-Terakki” (“Bashkim e Përparim”, sh.i.përk) nuk ia pranuen këtë mandatë të popullit. Kështu u kthye në Selanik, jo ma si funksionar shteti, por në punë të vet private. Sirri beu asht një administrator i zoti, i ndershëm e patriot, kryenaltë, këmbëngulës në mendimet e tija, aktiv në punë dhe i fortë n'arsyetim sa me bindë adversarin. Grekët ia grabitën pasuninë si këtij ashtu dhe të vjehrrit Qani pashës, prandaj përpiqet në Selanik për të mujtë m'e shpëtue. Sot vuen ekonomikisht megjithse dikur i pasun.

55. Selim Pashë Vlora, Sirri, prej Vlore, grada Mirmirane. Idhnak në punë, vullnet-fortë e trim. Prefekt në Gjirokastrë e në Berat, dhe një kohë të gjatë në Vlonë. Këtu rivendosi qetësinë e prishun, zemroi disa nga parsia. Analfabet por i zgjut. Selim Pasha asht ungi i em dhe djali i madh i Beqir bej Vlorës. U martue dy herë: Të parën me të bijën e... (?) e me të cilën pati një djalë me emën Xhafer Sadik beun dhe të dytën, mbasi dan gruan e parë, u martue me të bijën e Ahmed Pashës të birit të Pasho Ismail Pashës nga parësi e Janinës. Me këtë martesë të dytë pati prap një djalë, të qujtun Hamid bej, por ky vdiq në moshë të njomë. Xhafer beu vdiq në vitin 1308 h (1890), tue lanë djemt Xhemil bejnë e Sirri bejnë dhe vajzën Ismet Hanëmin. Sirri beu u vra tradhtisht prej një dore të poshtër në vitin 1921. Xhemil beu u martue me të bijën e Mehmed Ali Pashë Delvinës, me të cilën pati një vajzë. Selim Sirri Pasha dhe të birit Xhafer beu e Hamid beu kanë qenë të varrosun pranë Xhamisë së Tabakhanes në Vlonë; por varret që qenë aty u shembën me urdhën të Bajram Fevziut, të cilin rastet e hudhun si prefekt në Vlonë, i rritun si parazit në shpi të Sulejman Pashë Kolonjës. Unë i mblodha eshtrat e tyne dhe i vuna pranë Xhamisë që pat ngrehë vëllai i em Neshet Pasha në kujtim të birit Server (Surur) beut. Siri beu qe martue me Sadije Hanëmin, bijën e Ismail Pashë Vërlacit, parsi e Elbasanit dhe motër e Shefqet bej Vërlacit, dhe

pat lanë tri goca jetime. Selim Pasha pat një karakter fisniku, dhe krenohej me qenë shqiptar. Kundra osmanllivet kishte gjithmonë urrejtje. Veçse ishte i pa shoqñushëm dhe egoist në kulm; kryeneç e idhnak. Në 1291 h (1874) vdiq në Korfuz dhe kufoma e tij qe sjellë në Vlonë me një vapor të pajtuem ndergut.

56. Sulejman Pasha, Haki, Kolonja, gjeneral i parë Divizioni. Si doli oficer prej Akademisë Ushtarake u emënuë këtu si mësues me gradë gjeneral brigade mori pjesë në luftën ruso-turke të vitit 1877-të; mbas mbylljes së Traktatit të Berlinit u emënuë prefekt në Tashllëxha, ku kreu shërbime të mira. Në kohën e Sulltan Hamidit u gradue gjeneral i parë i Divizionit dhe në kohë të Konstitucionit u zgjodh antar i Senatit. Sot asht ma se njëqind vjeç. I ndershëm dhe i çquem për ndjenjat e tij kombëtare. Po të marrim parasysh profesionin që pati n'Akademin Ushtarake si mësues duhet t'a gjykojmë për një njeri me kulturë të mjaftueshme. Në të rijt e vet qe dhe trim. Asht i ati i gjeneralvet Ali Riza Pashës e i Halil Pashës dhe dhandri i Abdyl bej Selimit prej Delvine. Djelmëvet iu dha kulturë, bani ndaj tyne detyrën e vet si at dhe në sajë t'ekonomisë bani edhe pasuni. Asht një plak i shëndoshë dhe me fytyrë të qeshun. Mbas çpalljes s'indipendencës së Shqipnisë erdhi në Vlonë, tue ia la kështu borxhin që i kishte Atdheut.

57. Shahin bej Dino, grada Ula-Sani. Lindi në Sinop, kur i ati i tij qe aty prefekt. U rrit në Stamboll, doli me diplom fort të mirë prej Fakultetit të Drejtësisë dhe u emënuë në Seksionin e Këshilltarëvet të Ministrisë. Ndër zgjedhjet e dytë doli deputet i Prevezës dhe mbrojti me zotësi e dinjitet të drejtat t'ona kombëtare. Asht i zgjuet e patriot, nuk i përulet kujt dhe fjalën e drejtë se kursen.

58. Sadik Pasha, janinot, grada Mirmirane. Është prej një familjeje të ndershme të Janinës. Nuk trashëgoi ndonjë pasuni të madhe, u rrokullis ndër shpenzime e ndër borxhe. Por me iniciativën e tij than një kënetë në Loas, nga e cila me tokat e gjana që qiti në dritë edhe vetë u ba i pasun edhe vendin e shpëtoi prej ndyrësinash e smundjesh. Në kohën e sundimit otoman nuk u muerr me kurrigia veçse me punët e veta. Qe i urtë e në Janinë i ecte fjala. Nëpunësit e naltë të vilajetit kishin për të gjithmonë simpati, sepse kishte sjellje të mira. Qe bamirës e zemër-mirë. Si janinot me zemër e për natyrë e ndinte vehten për shqiptarë, dhe kërkonte gjithmonë raste me u ndihmue shqiptarët. Mbas zaptimit të Janinës dy ndër fëmijtë e tij morën shtetësinë shqiptare e vetëm njëri qe regjistruë shtetas turk. Por n'asnjë mënyrë nuk mund e skapulluen këtë pasuninë prej trojevet grabitqare të grekëvet, dhe tue qenë dikur të pasun, ranë

në skamje e në mizerje. Sadik Pasha vdiq në Janinë në vitin 1915 dhe varri i të ngratit ashtu si familja e tij u shuen në Janinë.

59. Salih Pasha, Salahi, Vrijoni, beratas, grada Mirmirane. Salih Pasha asht ma i vogli djalë i Kahreman Pashës. Relativisht me natyrën e dy vëllaznvet të tij, Omer e Galip Pashës, Salih Pasha pat një natyrë t'egër, por një inteligjencë të zjarrtë. Shpesh bahej rob i kryeneçësisë dhe i zemërimit të tij, por me gjith këtë ishte i drejtë. Nuk qe madhshtuer. Por s'donte dhe me u tregue gjithmonë modest. Herë me heshtjen e tij donte me kallzue zemërimin e vet, herë me bindë adversarin me fjalë ironike! Shum i hidhun me kombësi, sa qe farefisi i vet e thirrte "Salih Shqipja" e ky ishte i kënaqun prej këtij titulli që i jepej. Qe ndër ma zelltarët e familjes së vet që u përpoq me u mësyje shqipen atyne. Në shpirt të tij reflektone drita e shqiptarizmes e zemra e tij ishte përplot mbushë me ndenja kombëtare. Preokupacioni i tij shkencor që i kufizuen, me gjithë këtë studimet e tij mbi historinë e Shqipnisë ishin të thella. I kishte kanda me folë gjithmonë mbi Shqipni dhe me kuvendue në gjuhë shqipe. Ndera ma e madhe në sy të Salih Pashës ishte me qenë Shqiptar. Dëshira kombëtare, me pa të begaten e të lumtun kombin. Këndonte e shkruante turqisht. Por si natyrën

e tij ashtu dhe pendën e kishte t'ashpër, nuk ishte fanatik, megjith këtë kishte nderime për principet fetare dhe shkonte mirë me dijetarë e të devotshimtit e fesë. U martue me Rukije Hanëmin, bijën e Jusuf bej Biçakut prej Elbasani, dhe mbas vdekjes së saj me Afife Hanëmin, bija tjetër e tij. Me të parën grue u lindën djemt e mëdhej Kahreman e Hysameddin beu dhe Nafije Hanëmi e shoqja e Mehmed bej Këlcyrës dhe me të dytën Nexhmeddin beu, Hadije Hanëmi, gruja e djalit t'em Eqrem beut; Rukije Hanëmi, gruja e tjetrit djalë Safa beut dhe Adedije Hanëmi. Vdekja e gravet të reja njena mbas tjetrës tue lanë shtatë jetima e mjeruen së tepri; kështu nën peshën e randë të këtij mjerimi vdiq, mund të thuhet në një moshë të re më 21 Fruer 1911. Zoti derdhteë mbi të mëshirat e veta të pambarim.

60. Suphi bej, Arslan Pashaliu, grada Ula-Evveli. Ësht djali i madh i Hajredin Pashës të Sylejman beut, nga familja e Arslan Pashaliut prej Janine. Asht ndër të parët që dolën prej shkollës së Mylqyes, dhe pati diplom me nota të mira. U emënu në Ministri të Botores, mbrapa n'atë të Tregtisë, në kohën e Konstitucionit prefekt në Kudus (Jeruzalem) e mandej vali e kryetar Bashkie në Stamboll. Në cilësinë e tij si Kryetar Bashkie mblodhi qejt e Stambollit, mbetun nga stërgjyshat e tyne trashigim që

nga kohët e Bizantit i grumbulloj në një ishull-shkret dhe këtu i mbyti. Mandej shembi dhe një varr midis të rrugës Shehzade-Bashi, që pengonte kalimin. Kur u pushue prej postit që kishte në Stamboll dhe u dërgue si vali në Xhezairi-bahri-Sefid me qendër në Rodos, këtu ra rob ndër duer t'italjanëvet. Njerzit supersticioz këtë fat të keq që pësoi Suphi beu ia veshën këtyne dy veprave të tija, të mbyttjes së qejvet dhe të shembjes së varrit. Por Suphi beu shpëtoi Stambollin prej një fatkeqsie që as vetë pushtuesit të Stambollit që s'kishte dhimbje për jetën e njerzvet si ra ndër mend ta bante, me mbyttje, e qejvet të cilët me shekuj kishin helmatos ajrin e Kryeqytetit me ndysin e tyne dhe kishin shqetsue banorët me të lehuna e me ungërimal! Populli, përgjithësisht, ekzistencën e këtyne shtazëve të ndyet, të qejvet, e gjykonte si një shej lumtunie e begatie, dhe besonte se kushdo që do t'i prekte këta, do të ngrante shuplakën e Perëndisë!! Sa për varrin që zhduku, që i Osman babait, në za dhe i njoftun si person i venerueshëm prej të madhi e të vogëli. Mirë po dihej prej historie se ky njeri që thirrej Osman baba që një brigand në shërbimin t'Oxhakut të Jeniçerëve, i vramë mbas sa e sa krimeve e punësh të poshtra çnjerzore, dhe shokët e kishin kallë në dhe mu aty ku ishte vram. Sulltan Mahmudi që zhbini baballarët e Bektashijvet dhe shembi e shpartalloj Oxhakun e

Jeniçerëve, varrin e Osman babajt s'e preku. Jeniçerin brigand, Osman babaj sikur s'la të qetë botën në të gjallë të vet ashtu dhe mbas vdekjeje, një baba për të gjallët. Vjetë me radhë nuk guxoi me vu kush dorë në këtë varr që numurohej i shejtë. Gjithkush bante fjalë për mrekullitë e shejtit dhe kërkonte mbrojtjen e tij. Suphi beu i dha fund këtyne bestytnijvet, liroi rrugën dhe lehtësoi kalimin e publikut. Si kjo vepër ashtu dhe pastrimi i Stambollit prej qejvet, qenë një shërbim dhe një sukses i Suphi beut. Flitet dhe për një kavi të tretë që e hudhi në disgrace e në mjerim Suphi bejnë. Si Kryetar Bashkie Suphi beu që i detyruem me marrë pjesë në ceremoni mbretnore të së premtës. Një të premtë, Sulltan Mehmedi V i fërkoj mjekrën me simpati dhe e përkëdheli. Mbas tri ditësh Suphi beu u pushue, u qit nga Stambolli dhe u çue vali në Xhezairi-Bahri-Sefid. Shumë kohë mbeti në disgrac, s'mujt me drejtue kurrizin nga mjerimet dhe ma në fund ra dhe rob ndër duer t'italjanëvet n'ishullin e Rodosit!! Sulltan Mehmedi V ishte i njoftun në popull për sy të "keq" që kishte. Kudo që vente ai kambë e këdo që të shikonte, aty e n'atë kishte për të shkrepë mënjia e Zotit! "Vëllai i em Ferid Pasha kur që Sadriazam (Kryeministër), erdhi një natë vonë në shpi, deri n'atë kohë kishte qenë n'audiencë te Sulltani. Kur e pyetën shkakun e vonesës, ma kallzoi këtë histori tejet interesante: Atë natë

Sulltan Abdylhamidi në bisedim e sipër e ka pyet Ferid Pashën se a e ka takue ndonjë herë kund princin Reshad Efendinë!! Ferid Pasha ashtë ngrejtë në kambë dhe i ka gjegjë se nuk e ka takue as një herë kund dhe m'e takue do të kthente rrugë, pa marrë parasysh termalet ose tërposhtet e saj. Sulltan Hamidi mbasi ka hudhë mbi te një shikim kurioz, i ka thanë: fjalë me vend! Sigurisht njeriu pëson një rrezik po të ndeshet në sy të tij. Dhe ka shtue: një ditë më thotë Aishe Sulltan se porsa shikoj me sy një kalë princi Reshadi, një kalë që ajo e donte fort i ngordhi menjëherë kali ndër duar kur po i jepte tagji. Sulltan Abdylhamidi në fund ia ka pritë me të shame: Kur do të hypi në fron em-vëlla, do të dojshim me pa kobin që do t'i binte mbi kokë kombit dhe shkatërimi i Pushtetit Otoman!! Pse kamba agur-zezë e tij jam i sigurtë do t'a bijë këtë shkatërim. Me këto fjalë ka mbarue bisedën Sulltan Abdylhamidi! Dhe me të vërtete ogur-lig qe Sulltan Mehmed Reshadi V-të. Kudo vuni ai kambën, aty ra mjerimi, këdo që preku syni i tij apo këdo që afroj ai e preku prej vedit, atë e preku menjëherë murtaja. Dhe këto ngjarje përligjën besimin e popullit të formuem e të përhapun për të. Mbasi ai hypi në fron u përbys Perandoria, me fjalë ma të hapta sundimi i tij shënoi epilogun e saj. Suphi beu qe një ndër personalitete që la emën të mirë me zotësin, me

dinjtetin me drejtësinë e me të gjitha virtytet e mira që zotnoi. U ç'que kudo në punë për meritat e tija. Ma në fund qe vali në Konic. Këtu ngjan një kacafytje midis popullit dhe të turqve nacionalistë kemalistë. Suphi bej nuk u përzie as me njanën as me tjetrën anë. E pushuen nga puna e nxorrën jashtë, dhe e vunë në pension për mos me i dhanë ma punë kurr. Pasuninë që pati në Janinë ia zaptuen grekët, dhe u përpoq mjaft për t'a shpëtue.

61. Zija Pasha, Myfti-Zade, janinot, Vezir. Është vëllai i madh i Myfti-Zade-Reshit-Pashës. Shëtiti Europën me misione të mëdha e të vegjël dhe u ndodh në ngjarjen fatale që i kushtoi jetën dhjetmijë vetëve në fushën e Udinkës me rastin e kunorzimit të Car Nikollës së dytë. Në kohën e Sulltan Hamidit qe me vite Ministër i Kadastrës, e mbas Konstitucionit u emëna Ambasador në Ëashington. Si në kohë të regjimit absolut të Sulltan Hamidit dhe n'atë të Konstitucionit qe i nderuar për zotësinë e largpamjen e tij, dhe i zoti me mbajtë pozitat me dinjtet. Njihej ndër poetë, njihte gjuhë të huaja dhe i shikueshëm në shoqëri. Ndër kohëna të fundit qe senator; por mbasi erdh Gazi Mustafa Kemal Pasha u harrue në një skaj në midis personaliteteve që patën funksione në Perandorinë e vjetër Otomane.

62. Turhan Pasha, Hysni nga Përmeti, vezir. Ësht djali i Jahja beut, nga Përmeti. U fejue në moshë të njomë me të bijën e Tako beut, i afërmi (akraba) e mik i t'et. Mbas vdekjes së Jahja beut, e mori Turhan bejnë nën mbrojtje. Tako beu dhe vëllau i këtij Halim beu u martue me nanën e Turhan beut. Halim beu qe nënpunës në Doganë të Janinës, ku e mbante me vehte dhe Turhan bejnë, të cilin e mësoj ndër shkolla myslimane dhe greke, tue e dërgue dhe n'Athinë për plotësim të mësimet, e mandej në Stamboll. Këtu, Turhan beu hyni në Terxhume Kalemi (në zyrë të Përkthimeve), tue qenë në moshën njëzet e dy vjeç (1866). Turhan Pasha me shpejti përparoj dhe në vitin 1871 u emënie sekretar n'Ambasadë të Berlinit; në vitin 1877 këshilltar n'Ambasadë të Petërsburgut. Në vitin 1878 ishte ambasador në Romë. Kur befaz erdhi në Stamboll me leje, dhe kur po përgatitej më u kthye në Romë, u emënie prefekt n'Antalja e mbrapa n'Urfa. Ky ndryshim nëpunësie qe për Turhan bejnë një disgracë dhe e hudhi në mjerime. Mbi rrethanat e kësaj ngjarje vetë Turhan beu i ka dhanë këto shpjegime Rum-Bej-Oglu-Fahredin-Beut kur ky ishte Këshilltar i Ambasadës: ishëm ambasador në Romë, ku kishëm dhe një stimë të naltë shoqërore. Një ditë mora një telegram, me të cilën ftoheshim me shkue në Stamboll pa lajmnie kërkend, as qeverinë pranë së cilës ishëm i akredituem. U nisa menjëherë. Rashë në shpi t'Arifi Pashës, të cilin e kishim

përbujtë në banesë t'Ambasadës kur pat ardhë te Papa me mision të posaçm. Me të nesërmen shkova në Saraj, ku m'u komunikue t'u takojsha me Ministrin e Brendshëm. Në takim me këtë, ky më lajmoj se me dekret mbretnuer ishëm emënie prefekt n'Antalja dhe duhej të shkojsha pa vonesë në cak të punës. Unë kur ishëm në Romë qesh pjekë me Ismail Pashën, Khedivin e Misirit. Kushrit e mi nxjerrshin në Romë një gazetë, e cila merrej me punë të Shqipnisë. Por mbi përpjekje me Khedivin e pata lajmue Stambollin. Dhe botimet e fletores në fjalë e pata ndalue. Shkurt s'mora vesht kurrqja mbi shkakun e këtij disgrace. Pra prej Stambollit u nisa për n'Izmir, pse këtu duhej me ndrue vapor për të shkue n'Antalja. Një ditë para se me u nisë Arif Pasha, në një mënyrë fare konfidenciale, më thotë se kishte dëgjue që Mid`hat Pasha do t'arrestohej dhe do të merrej në gjyq. Në Izmir kishëm dy miq: Komandantin e Izmirit, Hilmi Pashë Gjiridin dhe Kryetarin e Gjykatës së Tregtisë Halim Begun e Sami Pashës. Kur sosa n'Izmir, vapori për n'Antalja ishte nisë. M'u desht me pritë një vapor tjetër. Mid`hat Pashës, (vali i Izmirit, sh.i.p.) u ruejta, nuk i bana vizitë. Por n'anë tjetër nuk m'u duk e arsyeshme të mos e lajmroj, tërthorazi, Mid`hat Pashën për komplotin që po i përgatitej, takova në sekretarin e tij privat Këlëxhjan Vasif Efendinë të cilit ia zbulova fjalët që ndëgjiova prej Arif Pashës dhe iu luta t'ia thonte Mid`hat Pashës. Disa ditë më vonë,

Hilmi Pasha, Komandanti i Izmirit më tha se do të qe mirë t'i bajshëm një herë vizitë Mid`hat Pashës, se ai, Mid`hat Pasha i jepte randësi këtyne punëvet dhe se këtë vizitë nuk do ia harronte në qoftë se do të vinte në fuqi edhe një herë. Vaporit për Antalja vonoj jashtzakonisht. Vajta në konak qeveritar, me pretekst me kërkue disa rroga paradhënie të prefektit. Tue u ngjitë shkallësh, përpara kishëm një njeri. Si mora vesht ma vonë, ky ishte qenë adjudanti i Hysni beut i dërguem me mision me arrestue Mid`hat Pashën. Na pranoi të dyvet për një herë. Unë iu luta për rrogat. Tue qesh më tha: “Tash ma filluem me iu dhanë ndihma edhe ambasadorëvet”, dhe shtoi: “Ndër nëpunësina shtetnore këso punësh ngjajnë shpesh dhe s`duhet me u dëshpërue. Shpejt do të shpërbleheshëm sigurisht me detyrën e ndonjë ambasadori. Këto çka kishin ngja, vinte nga një keqkuptim. “Në këto çaste shërbëtori lajmënoj se gjella ishte gati. Mid`hat Pasha si mue ashtu dhe at majorin na ftoi me ngranë. Të dy na e falenderuem dhe u larguem. Një ditë më thirri për darkë Hilmi beu, kryetari i Gjykatës së Tregtisë, në një kioshk ku banonte afër Izmirit. Kur po kthejshëm në shpi në gjysëm të natës rrugës pashë turma njerzish dhe aty-këtu patrulla. Me të nesërmen, pa u ngrejt ende prej gjumi, dikush trokiti me forcë në derë. E çela derën. Ishte një kolonel rezervë me emën Riza bej (ai që u ba me mbrapa ministër i Luftës). Më tha zë thirrëshëm me shkue ne vaporin Izzeddin dhe duhej

të shkojshim bashkë. U veshu, dhe sëbashku shkue në vapor. Në sallon të vaporit po rrishin Mid`hat Pasha, Ministri i Drejtësisë Xhevdet Pasha, kryeprokurori Latif beu e disa të tjerë. Mid`hat Pashës i ranë syzet në tokë por sa më pa mua. Un ishëm ba verdhë si dylli. Mid`hat Pashën e ndëgjova kur po thonte: Kishëm qëllimin me thanë se prej fjalvet të disa miqvet e të Turhan Beut kuptova që do t`arrestoheshëm mbi këtë Xhevdet Pasha mori guximin edhe i tha Mid`hat Pashës: Gënjeshtar. Mue mandej me çuan në Kazermë, ku me mbajtën dyzet ditë. Fatbardhësisht, miku i em fort i ngushtë, Halim Pasha u suell bujarisht ndaj meje. Më në fund vjen prej Sarajit një telegram, i cili më lente të lirë me shkue në cak të nëpunës, n`Antalja, ku dhe shkova. Deri këtu fjalët e Këllëxhjan Tasif Efendiut, sekretarit privat të Mid`hat Pashës.

Koencidenca e çuditshme asht këtu se Turhan Pasha u martue mbas disa vjetësh me të bijën e Hilmi Pashës, e cila aso kohe ishte dhjetë-dymbëdhjet vjeç! .. Mbas shtat tetë vjetvet Turhan Pasha u emënuë ambasador në Madrit me intervenim të kurd (nga Kurdistan) Said Pasha. Aty prap thithi erën e një qytetnimi, dhe mbasi u largue prej andej erdhi në Stamboll, ku u njoft me njerëz të Sarajit e prej ku u dërgue vali në Gjirid (Kretë) me titull vezir. Prej Gjiridit u kthye në Stamboll si Ministër i Jashtëm. Në këtë kohë ngjau në Stamboll masakra kundër armenëvet. Turhan Pasha bashkë me

Kyçyk Said Pashën pushohen. Por me ndihmën morale e materjale të Sarajit i kthehet ndera prap tue u emënuë antar i Këshillit të Naltë Shtetit, në Seksionin e Administratës, e mbrapa Ministër i Evkafit (Vakufëve). Në këtë dikaster qëndroi deri në çpallje të Konstitucionit. Në këtë kohë dy herë shkoi në Hagë si delegat i parë otoman dhe disa herësh u dërgue me misione të jashtzakonshme në Londër, në Livadje, Berlin, Letinë e Athinë. Kur erdhi në Korfuz Wilhemi II, Perandori i Gjermanisë, n'emën të qeverisë otomane i doli para në pritje Turhan Pasha. Kështu qe njoftë personalisht me Perandorët e Gjermanisë dhe të Rusisë, me Mbretin e Anglisë, Greqisë, e të Malit Zi. Sulltan Hamidi, Turhan Pashën e pati si ndërmjetës me këto perandorë e mbretin dhe me anë të tij u muer veshit me ta. Mbas çpalljes së Konstitucionit iu ngarkue Kryesia e Këshillit të Naltë të Shtetit me rastin e formimit të kabinetit të parë mandej u dërgua si Ambasador në St-Petersburg. Si u largua prej Petersburgu, në fillim të vitit 1914 u thir prej Princ Wiedit me marrë kryesinë e kabinetit shqiptar. Turhan Pasha e pranoi këtë detyrë të naltë, dhe më 14 mars 1914 doli në Durrës. Emënimin e Turhan Pashës si kryeministër në qeverinë e Durrësit ia kishte sugjerue Princ Wiedit Konti Berchtold, Ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, i cili kishte qenë Ambasador në Petersburg. Italiaa e dinte këtë gjë. Turhan Pasha për të çdukë dyshimin e ministrit italian Baron Aliotit dhe për të fitue miqësinë

e tij, i bani mjaft lajka, aq sa kjo sjellje e Turhan Pashës shkaktoi keqbesimin e të shumëvet ndaj tij!! Për me thanë të vërteten, sa qe në Durrës në krye të qeverive nuk i konsideroj as Italjanët as Austriakët dhe bile as Princin. Sundimi politik në Durrës filloi në midis ambicjevet të sundimtarëvet, e pra mbaroi keq. Kështu, Turhan Pasha, i shoqënuem me Princin la Durrësin. Dhe në formimin e qeverisë së dytë të përkohëshme në Durrës, Turhan Pasha u emënuë Kryeministër, dhe një kohë shef i delegacionit shqiptar që shkoj në Paris. Për sa mujtj këtu mbrojti të drejtat t'ona kombëtare. Kur hoqi dorë nga çdo gjë erdhi në Romë dhe i bani një vizitë Musolinit, Kryeministër i Italisë, për t'ia urue kambën e re. I përmendi me një rast Musolinit, se pa lindun ende ky, Musolini, ai, Turhan Pasha kishte qenë Ambasador në Romë. Kto kujtime e detyruen Musolinit m'e nderue jashtzakonisht Turhan Pashën.

Turhan Pasha ishte njeri me vesvese (që dyshonte për çdo gjë) dhe nuk ishte i vendosun ndër punë as në politikë. Megjithëse fort përkëdhelës, kujt s'i bante as keq as mirë me të dashun. Mbas ramjes së qeverisë së Durrsit shkoi në Zvicër. Në luftën e përgjithshme vuajti shumë ekonomikisht dhe rroj me të shitun të dhuratavet që i kishin falë mbretin. Qe përbuzë prej disa bashkatdhetarëvet të tij të pashpirtë. Ndër kohë të fundit mujtj me jetue me rrogën që i lidhi qeveria shqiptare. Jetoj me nderë dhe rujtj dinjitetin e vet.

Es-Sarhsi, Shemsul-eimmeh (Dielli i dijetarëve)* (vd. 483 h./1090)

Dr. Osman Taştan

Abstrakt

Shemsul-eimmeh Es-Sarhsi lindi rreth vitit 400 h./1010 në një familje tregtarësh, me gjasë në Sarahs, qytet në mes Meshbedit dhe Mervit (në Turkmënistinin e sotëm, afër kufirit me Iranin).

Shkrimet e Sarahsiut janë: El-Mebsut, El-Usul, Sherh es-Sijerul-kebir, En-Nukat: Sherh Zijadatiz-ẓijadat, Sherh Muhtesar et-Tabaui, dhe Esbratus-sa'a. Shumica e këtyre janë komentime sistematike mbi shkrime të mëbershme hanefite.

Sipas biografëve të tij, Sarahsiu i diktoi nxënësve të tij prej memories veprat Mebsut, Usul, dhe një pjesë të madhe të Sherh es-Sijerul-kebir, gjersa ai ishte i burgosur dhe pa qasje në referenca. Schacht e vë në dyshim këtë pikë, duke pohuar që (se) është e pakapshme që Sarahsiu të ketë mundur t'i diktojë veprat e tij gjatë katërmbëdhjetë viteve të burgosjes së tij prej memories. Për këtë arsye, Schacht sugjeron që (se) Sarahsiu duhet të ketë marrë asistencë të konsiderueshme nga nxënësit e tij, përfshirë qasje në burime. Kjo është e mundshme, pasi që ne dimë që nxënësit e tij kanë bashkëpunuar me të në kompozimin e veprave të tij.

Sarahsiu punoi në disa trajtesa njëkohësisht. Ai prodhoi disa pjesë të Mebsut para dhe disa pas punës së tij në Sherh es-Sijerul-kebir. Fakti që ai shpesh i referohet kapitujve të Mebsut në Usul-in e tij sugjeron që ai shkroi Usul-in pasi përfundoi Mebsut-in. Gjendja e tanishme e dijës tonë na e pamundëson që të vërtetojmë një kronologji ekezakete të veprave të tij.

S*hemsul-eimmeh* Es-Sarahsi¹ lindi rreth vitit 400 h./1010² në një familje tregtarësh³, me gjasë në Sarahs,⁴ qytet në mes Meshhedit dhe Mervit (në Turkmenistanin e sotëm, afër kufirit me Iranin).⁵ Sarahsiu studioi në

1* Kjo ese është bazuar mbi kapitullin e parë (Jeta dhe Vepra e Sarahsiut) të punimit tim të doktoraturës (The Jurisprudence of Sarakhsi with particular reference to war and peace: a comparative study in Islamic law), mbikëqyrur nga Aziz El-Azmeh dhe Ian R. Netton, University of Exeter, 1993. I jam mirënjohës Akademisë Turke të Shkencave/ Türkiye Bilimler Akademisi, për financimin e studimeve të mia në Departamentin e Studimeve të Lindjes së Afërt në Cornell University si vizitor në gjysmën e parë të vitit 2004, kur e shkrova këtë ese.

. Emri i tij i plotë është Muhammed bin Ahmed ibn Ebi Sehl, Ebu Bekr Shemsul-eimme Es-Sarahsi.

2. M. Hamidullah, “Serahsinin Devletler Umumi Hukukundaki Hissesi,” 15-25, tek 16.

3. M. Hamidullah, “Serahsinin Devletler Umumi Hukukundaki Hissesi,” 16; Idem, “Avant-Propos Du Traducteur,” vëll. 1, f. XXXII. Marrëdhënia ekzakte në mes *Es-Sijarul-kebir* të Shejbaniut dhe komentimit të Sarahsiut, e cila është problematike, do të analizohet më poshtë.

4. Encyclopedia of Islam, 1st Edition (Tutje: EI1), s.v. “al-Sarakhsi, Shams al-a’imma Abū Bakr Muhammad b. Ahmad b. Abī Sahl” (Heffening).

5. Shih EI1, s.v. “Sarakhsi” (Heffening); M. Hamidullah, “Serahsinin Devletler,” 16; Salahad-Din al-Munexhid, “El-Mukaddimeh (Hyrje),” në *Sherb Es-Sijerul-Kebir* të Sarahsiut, 1:5-29, tek 15-18; Ebul-Uefa El-Afgani, [“El-Mukaddimeh”], në *Usul* të Sarahsiut (Hyderabad, 1372H), 1:3-8 tek 4-8.

Buhara te *Shemsul-eimmeh* Abdul-aziz El-Haluani (vd. 448 h./1056), prej të cilit trashëgoi nofkën *Shemsul-eimmeh*. Ai, po ashtu, studioi te Shejhul-islam Ali bin El-Husejn bin Muhammed El-Sugdi.⁷ Pasi kompletoi studimet e tij, Sarahsiu shkoi në Uzshend, afër Farghanes në Transoksani, e cila kontrollohej nga Karahanidët.⁸ Nxënësit e Sarahsiut janë: Ebu Bekr Muhammed bin Ibrahim El-Hasiri,⁹ Ebu Hafs Umer bin Habib, gjyshin nga ana e nënës e Merginanit, autorit të veprës së famshme *El-Hidajeh: Sherb*

6. El-Kureshi, *El-Xheuabirul-mudijjeti fi tabakatil-banefijje* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:78; ibn Kutlubugha, *Taxbul-teraxhim fi tabakatil-banefijje*, 35, 52; J. Schacht, “Notes on Sarakhsi’s Life and Uorks,” 1-6, tek 1; M. Hamidullah, “Serahsi’nin Devletler,” 16; EI1, s.v. “Al-Sarakhsi”; Salahad-Din al-Munexhid, “El-Mukaddimeh,” 15-8; Ebu el-Uafa el-Afgani [“El-Mukaddimeh”], 4-8; Idem, “Mukaddimet el-Kitab” në *En-Nukat: Sherb zijadat el-zijadat të Sarahsiut*, 1-12, tek 10-12. Mbi studimin e Sarahsiut nën Haluanin, shih po ashtu Abdul-Haj El-Lekneuij, *El-Fena’idul-bahijjeti fi taraxhimil-banefijje* (Bejrut, n.d.), 158; Tashkuprizadeh, *Tabakat el-fukaha*, 76; idem, *Meusu’at mustalahat miftah es-sa’adeh ue misbah el-sijadeh fi mendu’at el-ulum*, 235, 645.

7. Ibn Kutlubugha, *Taxb et-teraxhim*, 43; J. Schacht, “Notes,” 1.

8. Salahad-Din al-Munexhid, “El-Mukaddimeh,” 15-18; EI1, s.v. “Al-Sarakhsi”.

9. El-Kureshi, *El-Xheuahir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:81; J. Schacht, “Notes,” 1; Salahad-Din al-Munexhid, “El-Mukaddimeh,” 15-18; Ebu el-Uafa el-Afgani, “Mukaddimet el-Kitab,” 10-12; idem, [“El-Mukaddimeh”], 4-8.

Bidajat el-Mubtedi;¹⁰ Ebu Amr Uthman bin Ali bin Muhammed El-Bejkendi;¹¹ *Burhanul-cimme* Abdul-aziz Umer bin Mazeh; Mahmud ibn Abdul-aziz El-Uzxhendi;¹² dhe Ruknud-din Mes'ud bin El-Hasan.¹³ Ndonëse burimet përmendin emrat e nxënësve të Sarahsiut ato nuk tregojnë për detajet e marrëdhënieve të tyre me të.

Pak paqartësi është shkaktuar rreth identitetit të Sarahsiut nga Ya'akov Meron, i cili shkruan:¹⁴

“Tre autorët e mëvonshëm klasikë hanefi Sarahsiu, Samerkandi dhe Kasani, nuk jetuan në Bagdad, por në vendin fqinj, në Siri.

Nuk është e çuditshme prandaj që të mësojmë që Sarahsiu ka dhënë mësim në Haleuije në Alepo, dhe më vonë, gjatë fundit të jetës së tij e gjeti veten në vendin e tij Fergana, një provincë në Transoksani, në Azinë qendrore, ku ai për një kohë qëndroi në burg.

10. El-Kureshi, *El-Xhenabir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:81; J. Schacht, “Notes,” 1; Ebu el-Uefa, “Mukaddimet el-Kitab,” 10-12; idem, [“El-Mukaddimeh”], 4-8.

11. El-Kureshi, *El-Xhenabir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:81; El-Leknevi, *El-Fena'id* (Bejrut, n.d.), 158; J. Schacht, “Notes,” 1; Ebu el-Uefa, “Mukaddimet el-Kitab,” 10-12; idem, [“El-Mukaddimeh”], 4-8; EI1, s.v. “Al-Sarakhsi”.

12. El-Leknevi, *El-Fena'id* (Bejrut, n.d.), 158; J. Schacht, “Notes,” 1; Ebu el-Uefa, “Mukaddimet el-Kitab,” 10-12.

13. El-Leknevi, *El-Fena'id* (Bejrut, n.d.), 158; Ebu el-Uefa, “Mukaddimet el-Kitab,” 10-12.

14. Ya'akov Meron, “The Development of Legal Thought in Hanafi Texts,” *Studia Islamica* XXX (1969), 73-118.

Dy breza më vonë, Kasani deri në vdekjen e tij (4) mbajti pozitën e njëjtë të profesorit në Haleuije (5) në qytetin e njëjtë në Alepo, ku Sarahsiu kishte dhënë mësim më parë. Përveç lidhjes gjeografike në mes të autorit të madh klasik të dytë dhe të katërt, ka një lidhje familjare në mes të tretit - pra Samerkandit, dhe të katërtit, dhëndrit të tij Kasanit.”¹⁵

Sipas Meron, periudha klasike hanefite fillon me El-Kuduriun (vd. 428 h./1037). Ai identifikon Sarahsiun (vd. 483 h./1090) si të dytin, Samerkandin (vd. 539 h./1144) si të tretin, dhe Kasanin (vd. 587 h./1191) si juristin e katërt të periudhës klasike hanefite. Në një përpjekje për të vërtetuar lidhje të forta në mes juristëve, ai trajton Alepon si lidhje gjeografike në mes Sarahsiut dhe Kasanit.¹⁶ Mirëpo, interpretimi i Meronit është në informata jokorrekte. Ai përzien dy Sarahsijtë: Shemsul-eimma, i cili jetoi në shekullin 5 h./11 dhe Radied-din Es-Sarahsi, i cili jetoi në shekullin 6 h./12. Ky i fundit ka dhënë mësim në medresenë Haleuije në Alepo.¹⁷ Gabimi i Meronit nuk kufizohet në përzierjen e dy Sarahsitëve të ndryshëm që jetuan në dy vende dhe kohë të ndryshme. Ai i shton gabimit duke i atribuuar fakte në lidhje me Sarahsiun e fundit atij të mëhershmit.

15. Numrat (4) dhe (5) në pasazhin e cituar sipër i referohen fusnotave në artikullin e Meronit, të cilat janë si në vijim: “(4) Ibn Kutlubugha, *Taxbut-teraxhimi fi tabakatil-hanefijje*, 84-5. (5) C. Brockelmann, GAL, I, 375.” Për citatin dhe referencat, shih Meron, “Development,” 86-87.

16. Meron, “Development,” 78, 86-87.

17. Shih El-Kureshi, *El-Xhenabir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:357; Shih po ashtu Dominique Sourdel, “Les professeurs de Madrasa a Alep aux XII^e-XIII^e Siècles d’Après Ibn Šaddād,” 85-115, tek 93.

Kini parasysh pikat në vijim:

1. Kur Nurud-dini mori në kontroll Alepon në vitin 541 h./1147, qyteti ishte i dominuar nga shkolla shafi'ite. Nurud-dini themeloi Haleuijjen në vitin 543 h./1149 për të mbështetur shkollën hanefite kundër dominimit shafi'i.¹⁸ Shemsul-eimme Es-Sarahsi, i cili ndërroi jetë në vitin 483 h./1090, nuk kishte të bënte asgjë me Haleuijjen, e cila është themeluar 60 vite pas vdekjes së tij.

2. Edhe Ibn Kutlubuga edhe Brockelman përmendin që Kasani (vd. 587H/1191) erdhi pas Radied-din Es-Sarahsiut (vd. 544 h./1150) si profesor i fikhut hanefi në Alepo gjatë regjimit të Nurud-dinit. Por ata nuk përmendin asgjë që do të lidhte Shemsul-eimme Es-Sarahsi (vd. 483 h./1090) me medresenë Haleuijje.¹⁹

3. Asnjë prej biografëve të Sarahsiut nuk përmendin që ai ndonjëherë e vizitoi Alepon ose Sirinë.

Pasi Sarahsiu u vendos në Uzxhand, *Khami*, Shemsul-Mulk e arrestoi atë, dhe ishte në burg për katërmëdhjetë vite, prej 466 h./1074 deri rreth vitit 480 h./1088.²⁰ Biografët përmendin një numër arsyesh për burgosjen e Sarahsiut.

18. Nikita Elisséeff, *Nur ad-Din un grand prince musulman de Syrie au temps des roisades (611-569H./1118-1174)*, 2:429-30, 3:756-7.

19. Shih Ibn Kutlubuga, *Taxhut-teraxhim*, 84-85; C. Brockelman, *Geschichte der arabischen Litteratur 2* (Tutje: GAL), 1:463, 465.

20. M. Hamidullah, "Serahsinin Devletler," 16; J. Schacht, "Notes," 3; EI1, s.v. "Al-Sarakhsi"; Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; Ebu el-Uafa, "Mukaddimet el-Kitab," 10-12.

1) Disa thonë që ai është burgosur për shkak të kritikës së tij të hapur të Hanit (*bi-sebeb kelime nesaba biha* ose *bi-sebeb kelime kane fiha minen-nasihin*),²¹ i cili lejoi oficerët e tij të martojnë *Ummul-Ueled*-et e tij para se periudha e tyre e pritjes (*iddet*) të skadojë²² (ndonëse disa burime thonë që Sarahsiu nuk kritikoi ligjin e Hanit mbi këtë deri pasi është liruar nga burgu).²³

2) Disa thonë që Karahanidët vunë taksa të rënda mbi nënshtetasit e tyre dhe Sarahsiu i inkurajoi ata që të refuzojnë të paguajnë këto taksa.²⁴ Mirëpo, ky pohim nuk ka mbështetje.

3) Të tjera burime tregojnë për një mospajtim teologjik në mes Sarahsiut dhe udhëheqësit në lidhje me "herezinë" dhe "ortodoksinë" në mes ulemave

21. El-Kureshi, *El-Xbenahir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:78-9; Ibn Kutlubuga, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; El-Leknevi, *El-Fena'id* (Beirut, n.d.), 158; Tashkaprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 75; idem, *Meusu'at mustalabat miftah el-sa'adeh*, 235; Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; Ebu el-Uefa, "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; idem, "El-Mukaddimeh," 4-8. Shih po ashtu Salih Tuğ, "Eserlerinde Raslanan İfadelerine Göre İmam Serahsi'nin Hapis Hayatı," 43-60, tek 43-5.

22. Ibn Kutlubuga, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; Tashkaprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 76; Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; EI1, s.v. "Sarakhsi"; J. Schacht, "Notes," 3;

23. Ebu el-Uafa, "El-Mukaddimeh," 4-8; Schacht, "Notes," 3;

24. M. Hamidullah, "Serahsi'nin Devletler," 16; shih po ashtu Salih Tuğ, "Eserlerinde Raslanan," 43-5.

dhe qeverisë.²⁵ Kjo pikë është po ashtu pa mbështetje. Mirëpo, Schacht shënon se Sarahsiu i referohet armiqve të tij si *zindik* (heretikë) dhe *es-sejji et-tedbir* (persona të keq-menaxhimit), telasheve të tij si *Ejjam el-Mibna* (ditët e sprovës), për ata që ndihmuan daljen e tij nga burgu si *Ehlu-Hakke ue'l-Jekin* (njerëzit e të vërtetës dhe bindjes), dhe vetës së tij si *El-Mutekel-lim bi'l-hakkeil-munir* (folësi i së vërtetës përmendës).²⁶ Kjo gjuhë, sipas Shachtit, sugjeron që Sarahsiu është burgosur për arsye teologjike. Mirëpo, ky qëndrim nuk ka mbështetje nga burimet.²⁷

25. J. Schacht, "Notes," 3-4; shih po ashtu Salih Tuğ, "Eserlerinde Raslanan," 43-5.

26. J. Schacht, "Notes," 3-4.

27. Citimi bibliografik i Schachtit në lidhje me burgimin e Sarahsiut është i pasaktë. Ai e bazon interpretimin e tij mbi një citim të një teksti arabisht të cilin ai e identifikon si shënime përmbyllëse të Sarahsiut në *Sherb es-Sijer el-Kebir*. Mirëpo, Schacht, nuk identifikon vëllimin, faqen ose botimin e *Sherb-it* në citimin e tij. Pasazhi që Schacht citon nuk gjendet në botimin 1971-1972 të Kajros së këtij *Sherbi* të përdorur në studimin para jush. Mirëpo, disa fjalë të ngjashme me pasazhin e cituar nga Schacht gjenden në *Keshf edb-dbunun* të Haxhi Halifes dhe identifikohen si shënime përmbyllëse të Sarahsiut rreth veprës së tij *Sherb es-Sijer el-Kebir*. Shih Haxhi Halifa, *Keshf edb-dbunun* (Tehran, 1947), 2:1014. Përveç kësaj, një tjetër fjalë cituar nga Schacht prej *Mebsut-it* (Kajro, 1324H), 10:50, të Sarahsiut në lidhje me çështjen nën diskutim nuk gjendet në vendin e treguar. Fjala gjendet në *Mebsut* (Kajro, 1324H) 7:59. Tjerat referenca nga Schacht për *Mebsut* (Kajro, 1324H, 10:144 dhe 12:108) në lidhje me çështjet në fjalë gjenden në vendet e treguara (Shih J. Schacht, "Notes," 3-4).

Ndonëse biografët e Sarahsiut përdorin termin *Xhubb*²⁸ ose burg i nëndheshëm për të përshkruar vendin ku ai ishte i burgosur, vetë Sarahsiu nuk thotë asgjë në veprat e tij rreth ndonjë burgu nëntokësor.²⁹ Ai ankohet për izolim nga familja e tij, i biri dhe librat,³⁰ por ai nuk përshkruan në detaje vendin në të cilin është mbajtur, përveç konfirmimit që ishte në burgim dhe përjetonte vështirësi.

Nuk ka informacion rreth vendndodhjes se ku është mbajtur Sarahsiu në mes vitit 466 h./1074 dhe 479 h./1087. Mirëpo, në parathënien e tij të *Usul*, shkruar në vitin 479 h./1087, ai përmend se është mbajtur në kështjellë në Uzaxhand.³¹ Në vitin 480 h./1088, në moshën afër 80 vjeçare, ai është liruar pas katërmbëdhjetë viteve burgimi.³² Ai pastaj vazhdoi ose për Merginan ose për Fargana. Me arrijten e tij, Imam Sejfid-din (ose El-Emir Hasan)³³ i ofroi atij mikpritje, duke i mundësuar që të përfundojë shkrimin e *Sherb es-Sijerul-kebir* (e cila ishte shkruar pjesërisht por është lënë

28. Ibn Kutlubugha, *Taxb et-Teraxhim*, 52-3; El-Lekneuij, *El-Fena'id* (Bejrut, n.d.), 158; Tashkuprizadeh, *Mensu'at mustalabat miftah el-sa'adeh*, 235; Ebu el-Uafa, "El-Mukaddimeh," 4-8;

29. J. Schacht, "Notes," 4;

30. Sarahsi, *Mebsut* (Kajro, 1324H), 12:108; Salih Tuğ, "Eserlerinde Raslanan," 54-5.

31. Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:9.

32. Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; J. Schacht, "Notes," 5; EI1, s.v. "Sarakhsi"; Salih Tuğ, "Eserlerinde Raslanan," 46.

33. Për Farganda dhe Emir Hasan, shih Tashkaprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 75-6.

e papërfunduar gjatë burgimit të tij).³⁴ Pas tri viteve liri në Merginan (ose Fergana), Sarahsiu ndërroi jetë në vitin 483 h/1090.³⁵

Veprat

Shkrimet e Sarahsiut janë: *El-Mebsut*,³⁶ *El-Usul*,³⁷ *Sherb es-Sijeril-kebir*,³⁸

34. Ibn Kutlubugha, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; J. Schacht, "Notes," 5-6; EI1, s.v. "Sarakhsi"; Salih Tuğ, "Eserlerinde Raslanan," 49.

35. Ebu el-Uafa, "El-Mukaddimeh," 4-8; M. Hamidullah, "Serahsi'nin Devletler," 16; J. Schacht, "Notes," 1; disa biografë përmendin që ai vdiq rreth 490H/1097 (shih el-Kureshi, *El-Xheuabir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:82; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18;

36. El-Kureshi, *El-Xheuabir* (Kajro, 1398-99/1978-79), 3:82; Ibn Kutlubugha, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; Haxhi Khalifa, *Keshf el-Zunun* (Tehran, 1947), 2:1580; Tashkaprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 75-6; idem, *Mensu'at mustalabat miftah el-sa'adeh*, 235; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; EI1, s.v. "Sarakhsi". Titulli i shtypur i botimit të *Mebsut* që përdorim për këtë studim (Kajro, ١٣٢٤H) është *Kitab el-Mebsut li Shems el-Din el-Sarakhsi*; mirëpo, llagapin "Shems el-Din" nuk e përdor asnjëri nga biografët e Sarahsiut përveç Tashkuprizades, i cili i referohet Sarahsiut edhe si Shems el-Din edhe si Shems el-A'amma. Shih Tashkaprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 75.

37. Ibn Kutlubugha, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; Tashkuprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 75-6; idem, *Mensu'at mustalabat miftah el-sa'adeh*, 235; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; J. Schacht, "Notes," 1; EI1, s.v. "Sarakhsi";

38. Ibn Kutlubugha, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; Haxhi Khalifa, *Keshf el-Zunun*

En-Nukat: Sherb Zijadati-z-zijadat,³⁹ *Sherb Muhtesar et-Tabaui*,⁴⁰ dhe *Esbratus-sa'a*.⁴¹ Shumica e këtyre janë komentime sistematike mbi shkrime të mëhershme hanefite.⁴²

(Tehran, 1947), 2:1014; Tashkaprizadeh, *Tabakat el-Fukaha*, 75-6; idem, *Mensu'at mustalabat miftah el-sa'adeh*, 235; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; J. Schacht, "Notes," 1; Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-8; EI1, s.v. "Sarakhsi". Norman Calder identifikon veprat *Mebsut*, *Sherb Sijar el-Kebir* dhe *Usul* si tre veprat më të rëndësishme të Sarahsiut. Shih EI2, s.v. "Al-Sarakhsi" (Calder)

39. Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; J. Schacht, "Notes," 1;

40. Ibn Kutlubugha, *Taxh el-Teraxhim*, 52-3; Haxhi Khalifa, *Keshf el-Zunun* (Tehran, 1947), 2:1628; Tashkaprizadeh, *Mensu'at mustalabat miftah el-sa'adeh*, 235; Shih po ashtu Brockelmann, GAL, S1, 1:294. Sipas Brockelmann, Sulejmania ka një kopje të *Sherb Mukthesar et-Tabaui* (Suleym. 595). Kjo është e pasaktë, siç demonstroi Fuat Sezgin në *Geschichte des Arabischen Schrifttums* 1 (Tutje: GAS), 1:441. Dorëshkrimi i *Sherb Muhtesar et-Tabaui*, siç sugjeron edhe Ibn Kutlubugha (*Taxh el-Teraxhim*, 52-3), nuk gjendet në tërësi. Vëllimi i dytë i dorëshkrimit është në bibliotekën Chester Beatty. Detajet e saj citohen nga Arberry si në vijim: "Foll. 339. 25.7 x 16.5 cm. Clear scholar's naskh. E padatur, shekulli 7të/13të. Brockelmann suppl, 1, 294". Shih Aruthr J. Arberry, *A Handlist of the Arabic Manuscripts*, vëll. 4, mss. 3751 deri 4000, fq. 60, tema nr. 3923; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; J. Schacht, "Notes," 1;

41. Bibliothèque Nationale, Arabe/2800; shih de Slane, *Catalogue des manuscrits Arabes de la Bibliothèque Nationale*, 2:504; shih po ashtu Brockelmann, GAL, 1:460-1; T. Okic, "Önsöz,"; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12.

42. Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:10.

Sipas biografëve të tij, Sarahsiu i diktoi nxënësve të tij prej memories veprat *Mebsut*,⁴³ *Usul*,⁴⁴ dhe një pjesë të madhe të *Sherh es-Sijerul-kebir*,⁴⁵ gjersa ai ishte i burgosur dhe pa qasje në referenca. Schacht e vë në dyshim këtë pikë, duke pohuar se është e pakapshme që Sarahsiu të ketë mundur t'i diktojë veprat e tij gjatë katërmbëdhjetë viteve të burgosjes së tij prej memories. Për këtë arsye, Schacht sugjeron se Sarahsiu duhet të ketë marrë asistencë të konsiderueshme nga nxënësit e tij, përfshirë qasje në burime. Kjo është e mundshme, pasi ne dimë që nxënësit e tij kanë bashkëpunuar me të në kompozimin e veprave të tij.⁴⁶

Sarahsiu punoi në disa trajtesa njëkohësisht. Ai prodhoi disa pjesë të *Mebsut* para dhe disa pas punës së tij në *Sherh es-Sijerul-kebir*. Fakti që ai shpesh i referohet kapitujve të *Mebsut* në *Usul*-in e tij sugjeron që ai shkroi *Usul*-in pasi përfundoi *Mebsut*-in. Gjendja e tanishme e dijes tonë na e pamundëson që të vërtetojmë një kronologji ekzakte të veprave të tij.

43. Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; EI1, s.v. "Sarakhsi".

44. Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; EI1, s.v. "Sarakhsi".

45. Salahad-Din al-Munexhid, "El-Mukaddimeh," 15-18; Ebu el-Uafa "Mukaddimet el-Kitab," 10-12; EI1, s.v. "Sarakhsi".

46. J. Schacht, "Notes," 5.

El-Mebsut

Me gjasë, vepra më e rëndësishme⁴⁷ e Sarahsiut, *Mebsut*, është njëri prej teksteve ligjore hanefite më të plota. Është e bazuar kryesisht në veprat e Muhammed ibn Hasan Esh-Shejbaniut (vd. 189 h./805).

Një tjetër dijetar hanefi, El-Hakim Esh-Shahid El-Meruazi (vd. 334 h./946), i shkurttoi veprat e Shejbaniut për t'i bërë ato më të lehta për nxënësit për t'i studiuar, ndaj edhe shkurtimi i tij quhet *Mubtesar*.⁴⁸ Afër 150 vite më vonë, Sarahsiu ndjeu që nxënësit po i shmangen *fikbut* dhe ai vendosi se ishte koha për të hartuar një formulim tërësor të jurisprudencës. Ai u përkushtua në përpilimin e veprës *Mebsut* që të justifikonte dhe shtjellonte fikhun në *Mubtesarin*⁴⁹ e El-Meruazit. Sarahsiu ofroi tre arsye kryesore pse nxënësit nuk ishin duke mësuar *fikb*:

1) Mungesa e entuziazmit,

47. EI1, s.v. "Sarakhsi".

48. *Mubtesari* (përmbledhja) e Meruazit është po ashtu e njohur si *El-Kafi* (shih J. Schacht, "Notes," 2; Chafik Chehata, *Études de droit musulman*, 22. Sipas Meron, vepra e Meruazit është komentim, jo përmbledhje, mbi veprat e Shejbaniut. Në këtë pikë, Meron dallon nga J. Schacht dhe Chafik Chehata, dhe, në fakt, me vetë Sarahsiun, i cili e identifikon trajtesën e Meruazit si përmbledhje. Kredit në pikë duhet dhënë për Schacht dhe Chehata, të cilët janë në pajtim me Sarahsiun. Cf. Sarahsi, *Mebsut* (Kajro, 1324 H), 1:2-4; J. Schacht, "Notes," 2; Chafik Chehata, *Études*, 22; Meron, "Zhvillimi i mendimit ligjor në tekstet hanefite," 80.

49. *El-Mubtesar* është kanali përmes së cilit Sarahsiu kërkonte lidhjet mes ligjit të tij dhe atij të juristëve të hershëm hanefij.

2) pedagogjia sterile e mësuesve të cilët përdornin argumentime të gjata dhe të parëndësishme (*el-nikat el-tardijeh*) që nuk kishin rëndësi ligjore dhe,

3) fakti që disa dijetarë i kishin bërë studimet ligjore shumë komplekse, duke futur terma filozofike në definime ligjore.⁵⁰ Pasi jep vlerësimin e tij të problemit, Sarahsiu thekson përgjigjen e tij si në vijim:

*E pashë që gjëja më e mirë në këtë rast është të shkruaj një komentim mbi Muhtesarin dhe të mos shkoj përtej kuptimit që ka efektin kryesor (në fikh) për të shpjeguar çdo çështje, duke u mjaftuar me tregimin se çka është vendimi i mbështetur (mu'temed) në çdo kapitull. Më pas kur, përveç qëllimit tim (për të shkruar një komentim), disa miq të mi të cilët më ngushëlluan me shoqërinë e tyre gjatë burgimit tim, më kërkuan që t'ua diktoj një vepër të tillë atyre, unë pranova. I lutem Zotit që të më japë sukses në të vërtetën dhe të më mbrojë nga gabimi dhe prej çdo gjë që mund të shkaktojë ndëshkimin tim në botën tjetër. Zoti pranoftë atë që kam synuar në shkrim si arsye për lirim në këtë botë dhe lumturi në botën e përtejme.*⁵¹

Renditja e tanishme e kapitujve në *Mebсут* me gjasë nuk është renditja e vendosur nga autori.⁵² Fillimi i *Kitabul-Me'akil* (vëll. 27) daton 14 Rabi'uth-thani 466,⁵³ dhe fillimi i *Kitabur-Reda*

(vëll. 30) daton 12 Xhumade'th-thani 477. Siç ka observuar Schacht, është e pagjasë që Sarahsiu të ketë kaluar njëmbëdhjetë vite për të përfunduar një të dhjetën e veprës së tij masive.⁵⁴ Ai me gjasë ka shkruar pjesë të ndryshme të *Mebсутit*, pa ndjekur rendin e tanishëm të kapitujve, dhe pastaj i ka vendosur kapitujt në radhitjen e tashme pasi shkrimi i librit ka përfunduar.

Versioni i shtypur i *Mebсутit* është në tridhjetë vëllime, përmban më shumë se pesëdhjetë kapituj kryesorë, secili me një numër të madh nënndarjesh. Fillon me *Kitabus-Salat* dhe vazhdon në tema që kanë të bëjnë me adhurimin (ibadat) deri te çështjet ligjore më përmbajtjesore. Vëllimi i dhjetë përmban *Kitabus-Sijer*, e cila merret me ligjet e luftës dhe paqes, ndërkombëtare dhe kombëtare dhe *Kitabul-istihsan*, e cila koncentrohet në çështjet që kanë të bëjnë me femrat. Vëllimi i tridhjetë përfshin *Kitab Ibtilaf Ebi Hanife ue Ibn Ebi Lejla* dhe *Kitabul-Kesb*. Secili prej këtyre kapitujve, me përjashtim të *Kitabul-Istihsan*, është ekuivalent i një trajtese në vete. *Kitabul-kesb* është unik në atë që, gati tërësisht, merret me asketizmin, në vend të çështjeve ligjore standarde.

Në *Mebсут*, Sarahsiu shpesh thotë se metoda e tij në interpretimin e ligjit është të gjej *Asl-in*, kauzën ose kuptimin kryesor, në një çështje.⁵⁵ Në hyrjen e tij në *Usul*, ai thotë se ai synon qartësi

50. Sarahsi, *Mebсут* (Kajro, 1324H), 1:2-4; J. Schacht, "Notes," 1-2.

51. Sarahsi, *Mebсут* (Kajro, 1324H), 1:4.

52. J. Schacht, "Notes," 1;

53. Sarahsi, *Mebсут* (Kajro, 1324H), 17:124; J. Schacht, "Notes," 1;

54. J. Schacht, "Notes," 1;

55. Sarahsi, *Mebсут* (Kajro, 1324H), 1:4, 7:59, 10:144, 12:108, dhe 30:244.

dhe koncizitet në veprat e tij.⁵⁶ Mirëpo, qëllimi kryesor i Sarahsiut është të vendosë një justifikim koherent mbi doktrinën ligjore hanefite.⁵⁷ Schacht e përshkruan *Mebсут*-in e Sarahsiut si në vijim:

“*Mebсут-i është, në fakt, e para e atyre trajtesave të mëdha që janë të preokupuara, jo me vendosjen e doktrinës së pranuar të shkollës dhe të vërtetojnë që është “e dubura (e vërteta)”, por që me paanësi të analizojnë implikimin sistematik të secilit opinion. Me fjalë tjera, qasja e tyre është, sikur të jetë “filozofike”, dhe Sarahsiu është shpikës i kësaj qasjeje në shkollën hanefite.*”⁵⁸

Sherh es-Sijeril-Kebir

Sherb es-Sijeril-Kebir është komentimi i Sarahsiut të veprës *El-Sijerul-Kebir*, vepër elaborimi e Shejbaniut në ligjin internacional islam.⁵⁹ *Sherbi* i përkushtohet gati tërësisht temave të luftës, paqes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Sarahsiu shkroi komentimin e tij pak para dhe pak pas daljes nga burgu në vitin 480 h./1088.⁶⁰ Teksti është përkthyer në turqisht nga Muhamed

Munib Ajntabi (vd. 1238 h./1822)⁶¹ dhe botuar në vitin 1241 h./1825.⁶² Versioni origjinal arabisht është botuar gati një shekull më vonë në vitin 1916-1917 në katër vëllime në Hyderabad.⁶³ Botimi më i përdorur arabisht është ai i Salahud-din El-Munexhidit dhe Abdul-aziz Ahmedit, botuar në Kajro në vitin 1971-1972.⁶⁴ Ky botim ka pesë vëllime, 218 seksione, 4573 paragrafë dhe 2312 faqe.⁶⁵ Versioni i fundit i botuar në arabisht është ai i Ebu Abdallah Muhammed Hasan Muhammed Hasan Isma’il Esh-Shafi’ij, botuar në Bejrut, në pesë vëllime.⁶⁶ Një përkthim në gjuhën frënge nga Muhammed Hamidullah, i titulluar *Le grand livre de la conduite de l’etat*, është botuar nga Türkiye Diyanet Vakfi në Ankara në mes 1989

61. Muhammed Munib Ajntabi përktheu këtë vepër në vitin 1796-97. Shih M. Hamidullah, “Serahsi’nin Devletler,” 20.

62. Tayyib Okic, “Şemsu’l-Eimme es-Serahsi’nin Şerhu’s-Siyeri’l-Kebir’inin Türkce Tercemesi ve Mütercim Muhammed Munib Ayıntabi’nin Diğer Eserleri,” 27-42, tek 30; M. Hamidullah, “Avant-Propos,” LI; M. Khadduri, “Translator’s Introduction,” 56.

63. M. Hamidullah “Avant-Propos,” L; M. Khadduri, “Translator’s Introduction,” 56; T. Okic, “Şemsu’l-Eimme es-Serahsi’nin,” 27;

64. Vëllimi i parë, dytë dhe tretë janë edituar nga Salahad-Din al-Munexhid, i katërti dhe i pesti nga Abd el-Aziz Ahmed (Kajro: Metba’at Shirkat el-Planat el-Sharkijje, 1971-72).

65. M. Hamidullah “Avant-Propos,” L.

66. Dar el-Kutub el-Ilmijje, 1997.

56. Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:10;

57. Shih Sarahsi, *Mebсут* (Kajro, 1324H), 1:120, 122, 2:61, 64, 152, 3:83, 103, 10:146-7, 157, 161-2.

58. J. Schacht, “Notes,” 2;

59. M. Khadduri, “Translator’s Introduction” (Parathënia e përkthyesit), në *The Islamic Law of nations: Shaybani’s Sijar*, 42 të Shejbaniut.

60. M. Hamidullah, “Serahsi’nin Devletler,” 21-2; J. Schacht, “Notes,” 5.

dhe 1991.⁶⁷ Në këtë artikull, të gjitha referencat janë nga botimi i Kajros i Munexhidit dhe Ahmedit.

Vëllimi i parë [1971-1972 botimi i Kajros], përkushtuar ligjit të luftës, përmban material në lidhje me përgatitjet për luftë, legjitimitetin e saj dhe përdorimin e forcave të armatosura. Temat e mbuluara përfshijnë një varg prej përgatitjes së kuajve për luftë deri te armatimi i luftës, me një theks mbi legjitimitetin e luftës, e cila, në mënyrë të parashikueshme, rezulton në fitore në emër të Islamit. Vëmendje po ashtu i jepet organizimit dhe udhëheqjes së forcave të armatosura, dhe për detajet e *eman* (sigurisë), e cila është çështje e ligjit të paqes. Vëllimi dytë zhvillon ligjin e *eman* në detaje, ndonëse fokusi kryesor është në ligjet në lidhje me plaçkat (*enfal*) e marra nga forcat myslimane. Vëllimi i tretë i përkushtohet tërësisht ligjeve të plaçkave dhe presë (*el-ghanima*) të marra nga forcat myslimane. Vëllimi i katërt po ashtu merret me robërit e luftës dhe, përveç kësaj, me dispozitat ligjore në lidhje me marrëveshjet e mbrojtjes dhe bashkëpunimet ushtarake, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ligjin e luftës dhe paqes. Vëllimi i pestë fokusohet në traktatet e paqes dhe çështjet e ndërlidhura me bashkekzistencën në mes myslimanëve dhe jo-myslimanëve, përfshirë

formulimet e traktateve të paqes. Po ashtu merret me problemet në lidhje me *murtedd*-ët (renegatët), *dhimmij* (banor i përhershëm jo-mysliman në territor mysliman), *muste'min* (banor i përkohshëm jo-mysliman në territor mysliman) dhe *harbij* (banor i përhershëm jo-mysliman në territor jo-mysliman).

Marrëdhënia ekzakte në mes *Es-Sijerul-kebir* të Shejbaniut dhe komentimit të Sarahsiut nuk është e qartë.⁶⁸ Është tepër e vështirë për të veçuar tekstin e Shejbaniut nga komentimi i Sarahsiut dhe të dallohen opinionet e Shejbaniut nga deklaratimet e Sarahsiut, përveç nëse vetë Sarahsiu i atribuon ndonjë opinion, direkt ose indirekt, Shejbaniut.

Marrëdhënia në mes tekstit të Shejbaniut dhe komentimit të Sarahsiut ka shkaktuar pak paqartësi në mesin e dijetarëve. Në vitin 1827, Joseph Hammer von Purgstall studioi përkthimin në gjuhën turke të Sarahsiut *Sherh Sijeril-Kebir* (vetëm dy vite pasi u botua së pari) dhe deklaroi Shejbaniun (jo Sarahsiun) si Hugo Grotius i Islamit.⁶⁹ Më pas, në vitin 1955, Hans Kruse provoi të sigurojë vendin e Shejbaniut si Hugo Grotius i Islamit, duke themeluar Shaybani Society of International Law' (Shoqëria e

68. M. Khadduri, "Translator's Introduction," 43.

69. H. Kruse, "The Foundation of Islamic International Jurisprudence," 231-67, tek 238; M. Khadduri, "Translator's Introduction," 56-7.

67. *Le grand livre de la conduite de l'État* [text by] ach-Chaibani, commenté par as-Sarakhsi, traduit par M. Hamidullah, 4 vëll. (Ankara: Turkiye Diyanet Vakfi, 1989-91).

Ligjit Internacional Shejbaniu⁷⁰). Kruse komenton mbi komentimin e Sarahsiut si në vijim:

“... Është gati e pamundshme që të ndërmarrësh një ndarje të pakontestueshme të tekstit bazë (metn), me origjinë nga Shejbaniu, nga shtesat komentuese të Sarahsiut. Kllapat e shtuara në tekst nga botuesit duket se japin një shenjë se cilat pjesë të tekstit duhen atribuar Shejbaniut sipas mendimit të tyre.”⁷¹

Mexhid Khadduri vjen në një përfundim të ngjashëm:

“Komentimi i Sarahsiut përbën gati një libër të ri; ai nuk arriti të riprodhojë tekstin origjinal të Shejbaniut, qasja ndaj të cilit i është ndaluar në burg, ndonëse mund të konsiderohet si ekspozim i doktrinave të Shejbaniut në shtesat siç ai i kishte kuptuar ato. Teksti i Shejbaniut, edhe përkundër përpjekjeve nga botuesit për ta dalluar atë prej komentimit, mund të konsiderohet si i humbur. Komentimi i Sarahsiut paraqet doktrinat hanefite siç janë kuptuar në shekullin e pestë të epokës islame (shekulli njëmbëdhjetë gregorian) dhe jo në shekullin e dytë (tetë gregorian) kur Shejbaniu ishte gjallë.”⁷²

Në *War and Peace in the Law of Islam*, Khadduri ia atribuon disa pjesë të *Sherh es-Sijeril-kebir* Shejbaniut,⁷³ dhe

70. M. Khadduri, “Translator’s Introduction,” 56-7.

71. H. Kruse, “The Foundation,” 237. Për komente të ngjashme, shih idem, “Islamic Doctrine of International Treaties,” 152-8, tek 154.

72. M. Khadduri, “Translator’s Introduction,” 44.

73. M. Khadduri, “War and Peace in the Law

shton paqartësinë në bibliografitë e tij: në *War and Peace in the Law of Islam*, ai paraqet *Sherh es-Sijeril-kebir* të Sarahsiut nën emrin e Shejbaniut;⁷⁴ në *The Islamic Law of Nations*, ai e paraqet të njëjtën vepër nën emrin e Sarahsiut.⁷⁵

Sarahsiu na tregon se ai ka studiuar *Es-Sijerul-kebir* nën mësuësin e tij El-Haluanin.⁷⁶ Sidoqoftë, duhet pasur parasysh, se teksti i Shejbaniut është kopjuar dhe ri-kopjuar shumë herë gjatë dy shekujve e gjysmë para se të ketë qenë e qasshme për Sarahsiun,⁷⁷ dhe që mund të ketë pësuar ndryshime në redaktimet e shumta të tij para se Sarahsiu ta pranojë nga El-Haluanin. Prej kësaj mund të nxjerrim dy konkluzione:

1) Asnjë deklaram në *Sherh es-Sijeril-kebir* nuk mund t’i atribuohet me siguri Shejbaniut përveç nëse konfirmohet nga ndonjë burim tjetër ose nga vetë Sarahsiu.

2) Ndonëse *Sherh es-Sijeril-kebir* është bazuar në veprën e Shejbaniut *Es-Sijerul-kebir*, ky *Sherh* mund të konsiderohet vepër në vetë Sarahsiut.⁷⁸

of Islam,” 56, 62, 82, 84-85, 104, 106-08, 113-15.

74. Ibid., 304.

75. M. Khadduri [ed], *The Islamic Law of Nations: Shaybani’s Sijar*, 304

76. Sarahsi, *Sherh el-Sijar el-Kebir*, 1:5.

77. Për detaje, shih Sarahsi, *Sherh el-Sijar el-Kebir*, 1:4-5; H. Kruse, “The Foundation,” 238-9; M. Khadduri, “Translator’s Introduction,” 43.

78. Vepra e Sarahsiut, sidoqoftë, mund të përmbajë nocionet e Shejbaniut për ligjin ndërkombëtar ose, në disa raste, pjesë të tekstit të Shejbaniut që janë kamufluuar nga

Joseph Hammer von Purgstall, Hans Kruse dhe Mexhid Khadduri janë të justifikuar në theksimin e kontributit madhështor të Shejbaniut në teorinë e ligjit islam, pasi Sarahsiu nuk mund ta kishte përpiluar *Sherh es-Sjjeril-kebir* po të mos kishte pranuar tekstin e Shejbaniut nga Haluani. Mirëpo, ata janë gabim kur atribuojnë disa pjesë të *Sherh es-Sjjeril-kebir* ndaj Shejbaniut, pasi pjesët në fjalë janë vënë në kllapa ose janë theksuar me ngjyrë të zezë nga botuesit, bazuar në supozime. Vërtetë, njëri prej botuesve, Salahud-din El-Munexhid thotë: “*Ne dalluam atë që duket si fjalë e Shejbaniut prej fjalëve të Sarahsiut. Fjalët e të parit i vumë në shkronja të mëdha dhe të dytë në shkronja të vogla. Në botimin indian të veprës, fjalët e Shejbaniut janë vendosur në kllapa.*”⁷⁹

El-Usul

Siç është theksuar, Sarahsiu filloi ta shkruaj *Usul*-in në Uzaxhand në vitin 479 h./1087,⁸⁰ ndonëse ne nuk e dimë kur e ka përfunduar atë. Botimi më i përdorur i *Usul*-it është ai i Ebul-Uefa El-Afganit, botuar në Hyderabad⁸¹, në dy vëllime, prej 416 dhe 387 faqesh, respektivisht. Mirëpo, botimi më i ri i *Usul*-it është ai i Rafik el-Axhem, botuar në

komentimi.

79. Salahad-Din al-Munexhid, “El-Mukaddimeh,” 27;

80. Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:9;

81. Metba’at Lexhnat el-Me’arif el-Nu’manijje, 1372 h.

Bejrut⁸² në dy vëllime prej 393 dhe 327 faqesh, respektivisht.⁸³

Sarahsiu përshkruan *Usul*-in si justifikim të metodave ose procedurave të aplikuara në interpretimin e tij të ligjit praktik:

1) Interpretimi i tij i ligjit praktik në formë të komentimit mbi jurisprudencën hanefite prej teksteve të Shejbaniut, dhe

2) *Usul*-i i tij është mbrojtja sistematike e mëvonshme e metodës së përdorur në komentimet ligjore.⁸⁴ Në hyrjen e tij, Sarahsiu shpjegon se është e rëndësishme që të kuptohet metodologjia e fikhut hanefi dhe si dhe vetë ligjit praktik. Çështjet e fikhut, sugjeron ai, janë shumë, por parimet (*usul*) janë të pakta në numër. Nuk është qëllimi i tij, thotë ai, që të shtojë asgjë të re në fikh, pasi juristë të mëhershëm hanefi tashmë kishin përpiluar libra të shumta

82. Dar el-Ma’rife, 1998.

83. Vepra *Usul* e përdorur në këtë artikull është botimi Hyderabadit ١٣٧٢H nga el-Afgani. Përveç këtij botimi dhe atij të Refik el-Axhem, është edhe një botim i Ebu Abd el-Rahman Salah ibn Muhammed Arida, botuar në vitin ١٩٩٦ nga Dar el-Kutub el-Ilmijje, Bejrut, në dy vëllime (٢٧٧ dhe ٢٥٦ faqesh, respektivisht), me titullin *El-Muharrer fi Usul el-Fikh*. Ky titull nuk përmendet prej asnjë prej biografëve të Sarahsiut. Ebu Uefa el-Afgani, edituesi i botimit të Hyderabadit, thotë që titulli fillestar i *Usul* ishte *Temhid el-Fusul fi el-Usul*; më vonë, u bë e njohur si *Usul el-Sarhsi*. Shih Ebu el-Uefa el-Afgani [“El-Mukaddimeh”], në Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:3-8 tek 4.

84. Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:10;

(*mexhmu'at*). Por, - vazhdon ai, - ai preferon që të jetë prej atyre që ndjekin (*muktedirin*) [shtegun e krijuar nga paraardhësit].⁸⁵ Me përmbajtjen e pasur dhe justifikimin racional të interpretimeve ligjore, *Usul-i* është një kontribut i rëndësishëm i jurisprudencës hanefite.

Usul-i i Sarahsiut ofron shpjegim koherent të marrëdhënies në mes metodës së interpretimit ligjor dhe ligjeve praktike (*furu*). Kjo pikë është sqaruar qartë nga Uael b. Hallaq:

“Një *ekzaminim i afërt i Usulit të tij* (Sarahsiut) *zbulon vëmendjen e kujdesshme dhe konstante të ligjit praktik dhe praktikës ligjore. Libri është potbuajse njëmendësisht ligjor dhe referencë e vazhdueshme ndaj çështjeve furu' tradhton afinitetin në mes ligjeve praktike të Sarahsiut dhe metodologjisë së tij dhe teorisë së interpretimit ligjor.*”⁸⁶

Në këtë drejtim, *Usul-i* i Sarahsiut, siç ka observuar U. Hallaq,⁸⁷ është i krahasueshëm me bashkëkohësin e tij Pezdeuiun. Edhe Sarahsiu edhe Pezdeuiu i referohen parimisht Ebu Hanifes, Ebu Jusufit dhe Shejbaniut për të vërtetuar metodologjinë hanefite të interpretimit ligjor. Dhe ata i referohen Shafi'ut për ta dalluar qasjen e tij prej asaj të juristëve të hershëm hanefi. Mirëpo, për dallim nga Pezdeuiu, Sarahsiu më shpesh

i referohet ligjeve praktike (*furu*) për të vërtetuar metodologjinë e fikhut. Është meritë e Sarahsiut, që referencat e tij ndaj ligjit praktik në *Usul-in* e tij, shpesh mund të përcillen në veprat e tij të kaluara mbi ligjin praktik.⁸⁸

Përktheu: Fatih Ibrahim

Burimi:

“*Islamic Legal Thought: A Compendium of Muslim Jurists*”, edituar nga: Oussama Arabi, David S. Powers dhe Susan A. Spectorsky, ff. 239-251.

88. Për referencat e Pezdeuiut ndaj Ebu Hanifes, Ebu Jusufit dhe Shejbaniut, shih Pezdeuiu, *Usul*, në margjinat e Abd el-Aziz el-Bukhari, *Keshf el-Esrar*, 4 vëll. ([Istanbul]: Mekteb el-Sanaji, 1307H), 1:4-11, 2:336, 342, 377, 468, 559; 3:764-5, 866; 4:1472, 1483. Për referencat e Pezdeuiut ndaj Shafiut shih Pezdeuiu, *Usul*, 2:591, 623, 632; 3:963, 1013-14, 1098; 4:1270; për referencat e Sarahsiut ndaj Ebu Hanifes, Ebu Jusufit dhe Shejbaniut, shih Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:36, 73, 125, 230, 2:113, 133, 213, 231, 295, 337, 348. Për referencat e Sarahsiut ndaj Shafiut, shih Sarahsi, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:119, 315, 2:106, 207; Për ligjet praktike të përmendura nga Sarahsiu që tregojnë lidhje në mes interpretimit të tij të ligjit praktik (*furu el-fikih*) dhe metodologjisë së tij të interpretimit (*usul el-fikih*), shih Sarahsiu, *Usul* (Hyderabad, 1372H), 1:351; cf. *Mebсут* (Kajro, 1324H), 16:121; *Usul*, 2:48-9; cf. *Mebсут*, 11:169 ff.; *Usul*, 2:133; cf. *Mebсут*, 16:60-3 ff; *Usul*, 2:201; cf. *Mebсут*, 9:61-2; *Usul*, 2:201; cf. *Mebсут*, 9:147-8; *Usul*, 2:204; cf. *Mebсут*, 2:8; *Usul*, 2:205; cf. *Mebсут*, 12:161 ff.

85. Ibid.

86. Uael B. Hallaq, “*Usul al-Fiqh: Beyond tradition*,” 172-202, te 182.

87. Ibid., 82.

Rreth autorit

Osman Taştan është profesor në Departamentin e Fikhut Islam në Fakultetin e Shkencave Fetare në Universitetin e Ankarasë. Ai shkroi disertacionin e tij të doktoraturës mbi Sarahsiun. Publikimet e tij përfshijnë një kapitull ‘Feja dhe minoritetet fetare’ në Turqi dhe artikujt mbi teorinë dhe historinë ligjore islame. Kërkimi i tij po ashtu përfshin ligjin e popullimit dhe luftën e paqen në ligjin islam. (Burimi: Islamic Legal Thought,” f. XV).

Rreth anës teknike të përkthimit

Të gjitha shënimet në kllapa dhe fusnota janë të autorit dhe/ose të edituesve, dhe jo të përkthyesit. Gjatë përkthimit jemi munduar t’i qëndrojmë besnik tekstit në maksimum, përveç rasteve kur përkthimi i fjalëpërfjalshëm do të rezultonte absurd në gjuhën shqipe. Në mungesë të një terminologjie të unifikuar në shqip, termat në vijim, i kemi përkthyer kështu: *Fikb* - Jurisprudencë, *Usul el-Fikb* - Teoria (ose Metodologjia) ligjore, *Furu el-Fikb* - ligji praktik, ndonëse autori përdor fjalët “Law” për *Fikb* dhe “Positive Law” për *Furu el-Fikb*. Përkthimi tekstual i këtyre termeve, sipas mendimit tonë, nuk do të ishte në pajtim me kuptimin terminologjik të fjalëve. Variante të tjera të përkthimit të *Furu el-Fikb* mund të jenë ligj aplikativ, ligj sekondar/degësor (për kontrast me ligjin bazik/rrënjësor, d.m.th. *Usul el-Fikb*).

Sheh Ibrahim Karbunara (1879-1947)

Klerik, patriot e politikan i pushkatuar nga komunizmi

Abstrakt

Sheh Ibrahim Karbunara lindi në fshatin Karbunarë të Lushnjës në vitin 1879, në një familje fisnike me ndjenja atdhetare. Mësimet e mesme i mori në medresenë e Beratit, ku u shqua si nxënës i shkëlqyer. Pastaj shkoi për studime të larta teologjike në Stamboll, ku mori një arsim të plotë, të lartë, si klerik me pesë gjuhë të huaja: arabisht, osmanisht, persisht, anglisht dhe frëngjisht, si edhe i pajisur me një kulturë të gjerë të gjithanshme bashkëkohore.



Studimet dhe qëndrimi me kërkesa e punë intensive kombëtare, e bënë shehun e ri, Ibrahim Karbunarën, mjaft të njohur në rrethet politike të kohës në Stamboll. Ai u njoh atje dhe punoi përkrah rilindësve për çështjen kombëtare, prandaj edhe me t'u kthyer në teqenë e tij në Karbunarë, në vitin 1909, e internuan në Peqin, duke e cilësuar si «turbullues i milletit».

Teqeja halveti e këtij shehu ishte jo vetëm qendër për edukimin e tarikatit halveti, të shtrirë në shumë vise të Shqipërisë, por kur e donte puna edhe qendër për çështjen kombëtare shqiptare. Kështu sheh Karbunara

me atdhetarë, si Nebi Sefa e të tjerë, ndihmuan kalimin pa rrezique të Ismail Qemalit në nëntorin e vitit 1912 drejt Vlorës. Ai përkrahu pa rezerva Ismail Qemalin, me të cilin ishte njohur që në Stamboll dhe qëndronte përkrah tij në ngritjen e flamurit dhe shpalljen e pavarësisë më 28 Nëntor 1912.

Nuk është rastësi që firmën e Ibrahim Sheh Karbunarës, këtij atdhetari të flaktë dhe politikani të pjekur, e shohim në krye të protestës që i drejtohet qeverisë së Durrësit në mbështetje të Dibrës e Çamërisë e mbetej në protestën që i drejtohet Turhan Pashë Përmetit, që kryesonte delegacionin në Konferencën e Paqes në Paris, për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë.

Sheh Ibrahim Karbunara ishte ndër organizatorët kryesorë të Kongresit të Lushnjës dhe si delegat i vendit mikpritës hapi punimet e tij, duke u uruar mirëseardhjen përfaqësuesve nga e gjithë Shqipëria. Kësisoj ai mbeti kryetar nderi dhe ndër figurat e pashlyera në histori, si deputet dhe senator në atë kongres. Ai ishte dhe mbeti i tillë deri në fund të jetës, shok dhe mik i ngushtë i Fan S. Nolit, prandaj edhe mbështeti me të gjitha mundësitë e forcat opozitën dhe qeverinë e tij demokratike. Por fati e caktoi që pas dështimit të revolucionit të merrte udhën e mërgimit në Bari të Italisë. Megjithatë asnjëherë nuk i shkëputi marrëdhëniet me vendin dhe shokët e miqtë. At Gjergj Fishta qëndrimin e parë për në Vatikan, e fillonte në shtëpinë modeste të tij në Bari, ku kalonin ditë të tëra së bashku.

Ai u kthye nga mërgimi në qershor 1939, i fundit nga të riatdhesuarit, siç

duket në pritje të ndonjë deklarate në përkrahje të fashizmit, të cilën ai nuk e bëri kurrë. Kthimi i tij u festua edhe nga populli i Lushnjës. Shpejt teqeja u gjallërua edhe më shumë nga vizitat e popullit të Myzeqesë, e të mbarë Shqipërisë. Është kjo arsyeja që teqja e Karbunarës bëhet që në fillim një nyje lidhëse e LNÇ ku rriheshin probleme të rëndësishme të ditës. Shtëpia e tij me gjithë teqenë u dogj nga fashizmi në gusht të vitit 1943, ndërsa nazistët e burgosën më 1944, por këto nuk e dobësuan më këtë burrë sa të urtë aq edhe trim. Ai e vazhdoi punën deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, me besimin se do të realizohej ajo që kish ëndërruar prej shumë vitesh, për një Shqipëri të lirë dhe demokratike, por ja që doli më shumë se i zhgënjyer. Për kontributin e dhënë në favor të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe të simpatisë që gëzonte në popull, ai zgjidhet deputet i rrethit të Lushnjës, në fushatën elektorale të 2 dhjetorit 1945. Kur erdhi momenti ai bindjet e tij për një Shqipëri të lirë nga komunizmi dhe për demokraci të vërtetë i shfaqti dhe i mbrojti me guxim së bashku me një grup deputetësh në parlamentin e pasçlirimit, por e pagoi shtrenjtë: para syve të tij ia pushkatuan të birin, Hysenin, e pastaj, ndërsa po mërmëriste një ajet të Kur'anit për atë që ndodhi, plumbat godasin gjoksin e këtij tribuni, duke u rrëzuar mbi trupin e të birit. U bënë kështu dëshmorë të demokracisë. Eshtrat e tyre nuk dihen ende edhe sot.¹ Ata u pushkatuan në vitin 1947.

1. Karbunara, Shemsi Sheh, gazeta "Drita Islame", nr. 20, 1992: 2.

Nisjativa te reja për bashkëpunim midis feve

Abstrakt

Mbassi shoknimi universal është një qëllim i dëshëruar, njerëzit e fës dubet t'i drejtojnë forcat e tyre drejt zhvillimit të këtij shoknimi e të përmbledhen rreth realizimit të tij me seriozitet e besim të plotë. Ky seriozitet dubet t'i drejtohet vetëdijes fetare, për të cilën kemi folë ma sipër edhe të përfitojë nga influenca e fuqishme që kjo vetëdije i bën shpirtit të besnikëve e nga gjanësija e qëllimit të saj si edhe nga instinkti që ka skalitë natyra në shpirt të njeriut. Këtu dubet me e fillue zhvillimin e shoknimit universal.

Plotsimi i këtij qëllimi të madh për vëllaznin universale e zhvillimin e saj mund të kryehtë me anë të vetëdijes fetare të të gjitha feve dhe nëpër mjet të virtytit praktik e të parimeve të mira shoqërore që gjenden në çdo fë.

Në të gjitha fët gjenden principe hyjnore që shërbejnë për të mirën dhe dobën e njerëzsis e me këtë mënyrë çdo fetar dubet të jetë një organ i dobishëm për shoqëri.

Si ç'dihet, nëpër kryeqytet e mëdhenj të Evropës po bëhen vit për vit Kongrese të shpeshta, ku po epen konferenca mbi thema të ndryshme me qëllim që me i afrue popujt e me i shdukë grindjete mos marrëveshjet që shkaktojnë lufta e gjakderdhje midis tyre.

Ndër të këtilla kongrese të vitit vazhduës, po përmendim edhe atë të të gjith feve të botës, që u mbledh në London në muajin e Korrikut të

kaluem, ku ndër të tjerë delegatë islam kje thirrë edhe Rektori i Universitetit të Al Az'harit në Kajro, i cili tue qenë i zanun me punë të tepërta ka lypë ndjesë pse s'ka mundë me marrë pjesë personalisht për t'a këndue në Kongres Konferencën e vet mbi theme që kje caktue delegoi të vëllan Abul Aziz Mustafa Maragijun.

Ketë lutje të Zotnis së Tij e pranoi Kongresi dhe ashtu u bën.

Këtu poshtë po botojmë konferencën e Zotnis së Tij të përkëthyme tekstualisht:

SHOKNIM¹ UNIVERSAL

I.

Një përshëndetje Kongresit Botnuer të Besimeve

Ka qenë një nder i madh për mue ftesa qi më bâni trupi organizuës i Kongresit Botnuer të Besimeve. Pata dëshirë të madhe me u ndodhë une vetë në këtë Kongres qi të takonja përfaqsuësit e shkëlqyeshëm të religjioneve dhe të besimeve të botës. Për fat të keq rrethana e arsye të forta e të paprituna më pengojnë qi t'a plotsoj këtë dëshirë. Prandaj u shtrëngova t'a dergoj konferencën t'eme edhe të delegoj qi t'a lexojë n'emën t'em Sheh Abdyl Aziz Mustafa Muhammedin, Professor në Universitetin Al-Az'har.

Ju lutem të pranon të falat e mija mâ të nxehta, shprehjet e vullnetit të mirë edhe dëshirat e mija mâ të sinqerta për plotsimin e objektivës së madhe, për të cilën po përpiqet Zotnija e Juajë.

II.

Ideja e shoknimit është natyrale

Ideja për shoknim leu në komunitetet primitive dhe e tregoi vehten e saj tue zbutë mundimet e jetës në format e saj të thjeshta. Me zhvillimin e Komuniteteve u rrit edhe këjo ide, e cila e shtriu influencën e sja sa qi përfshini fiset

1. Shoqërim, vëllazërim universal (shënim i redaksisë).

e pastaj u zgjanue edhe mâ, deri sa mbështuëll popujt e kombet.

Sod, kur nevoja e kombeve për njani tjetrin është ndjerë prej të gjithëve, kur është kuptue detyra me e sigurue jetën publike të njerzís nga mjerimet, edhe, kur është çfaqë nevoja me hetue kërkesat ekonomike civile, shkencore e shpirtnore, të cilat nuk mund t'i plotsoje një popull me fuqín e vet por ka nevojë për bashkëpunimin e krejt njerzís, ideja e shoknimit ka marrë një hov dhe është zgjanue e shtrí sa me përmbledhë në gjí të vet krejt racën njerzore. Pra, ideja e shoknimit nuk është një teori filosofike, por një nevojë natyrale lindun në fisin e njerizt qysh në fillim të jetë e qysh se njerzija e kuptoi qi bashkëpunimi midis individëve do t'a ndihmonte për të kalue me siguri e me avantazhe mâ të mdhaja rreziqet e jetës.

III.

Shkaqet e mosmarrveshjes janë natyrale

Me gjith se njeriu e ka kuptue nevojën e shoknimit, e me gjith se edhe arsyaia këtë gjâ kërkon, faktorët e mosmarrveshtjes kurdoherë kanë qenë bashkë me këtë ndjenjë. Sepse njeriu në këtë jetë nuk është i udhëhequn vetëm prej arsyes, por me të bashkë është i shtytun edhe prej disa instikteve shtâzore qi ka me vehte, prej të cilave egoizma, xhelozija, frika e dyshimi janë disa shembulla.

Ndryshimi i feve dhe i besimeve ka formue një faktor tjetër për mos marrveshje e kështu atyne qi bâjnë

fjalë për vëllaznimin e njerzís, kur i u kujtohen këta faktorë të fortë të mosmarrveshtjes, i u duket se kjo dëshirë e tyne është një kërkesë e porealizueshme në këtë jetë, sidomos kur shofin se botën e sundojnë mënyrat brutale dhe barbare të atyne që s'kanë as zemër, as ndërgjegje.

IV.

Feja është i vetmi shërim

Un nuk besoj se përparimi shkencuër e filosofik të mundet me i shtypë këta faktorë e me i çdukë efektet e tyne. Jemi tue pa gjithnji se sa më tepër përparon shkenca aqë ma të rrehta e më të tmershme bëhen luftat. Sa keq! Shekenca është bënë arma më të tmershme e luftës. Të them të vërtetën, un nuk besoj që të vijë Dita, në të cilën të realizohen idealet e njerzís; sepse, edhe sikur të jetë e mundur me çdo mjet me ja pre hovin zjarmit të luftës që shkaktojnë instiktet natyrale të njeriut, prapë se prapë nuk është e mundur që të fiket fare ky zjarm.

V.

Mirpo ky besim nuk dubet të na ndalojë nga studimi i mjeteve që i zbusin këta instinkte dhe që i frenojnë fuqit brutale të tyne. Asht punë e dobishme që të vazhdojmë me studjue mjetet që i shërbejnë këtij qëllimi.

Në zgjidhjen e këtij problemi të vështirë fetari duhet të ketë para sysh: a) se fét që të gjitha janë mbështetur

në prirjen e instiktit fetar që ka njeriu në natyrë të vet, b) se fét e kanë shtytun njerinë të besojë se bota është tansí e armonizuese qeverisun prej një Fuqije Rregulluese, të Urtë e të Dretjë që kontrollon e gjykon qëllimet e tinzít e njerëzve, c) e se këjo jetë udhton drejt një mbarimi me pergjegjsí e me shpërblim.

Pra në fé ka faktorë, si besimi në një Zot, përkulja dhe të menduëmit për Të edhe të kujtuëmit e gjygit të Zotit, faktorë këta që nuk janë me ma pak rëndësi e me më pak efekt në shtytjen e njeriut kah e mira e mëshira, se ata faktorët e tjerë që e përcjellin njerin në të këqija dhe e shtyjnë në luftë e ambicje dhe në korruptimin e shoqëris njerzore.

Nuk ka dyshim se beimi në jetën e Ahiretit më e gjatë se këjo – besimi që ajo është një e mirë e kullueme që fitohet me punë të mira, ose një e keqe absolute që është si konseguencë natyrale e të bënimit keq, – ky farë besimi pra – e bënë zemrën e njeriut të qetë e të kënaqun për fatin e keq që i takoi në këtë botë edhe e ndryshon krejt pikpamjen e tij që ka pasë për këtë jetë.

Pastaj, të besuëmit që e mira dhe e keqja zbresin mbas një mase të caktueme mbassi të peshohen nëpër një terezí të drejtë, e cila është terezija e të Plotpushtedshmit dhe të Plotditurit Zot, e shtyn njerinë në shumzimin e punve të mira dhe e largon nga punët e liga.

IV.

Frika e Zotit dubet të jetë kontrolluesja dhe mbikqyrësja e punës së njeriut

Kur me anë të edukatës e të kulturës arinë me e zgjue ndërgjegjen njerzore e me e bâ njerinë qi t'a dojë të mirën vetëm pse është e mirë e ta neverisin të keqen vetëm pse është e keqe, atëhere moralistët thonë se nuk ka nevoj për fë. – Porse ky pretendim mbetet vetëm në theorie e nuk mund të vihet në praktikë. E ç'efekt mund t'i u bâje edukata karakterkëqive, të cilët qysh në fillim të jetës kanë pasë nevojë për forcë.

Pra është mâ e lehtë me u këthye kah instikti fetar. Këjo, konshiençë fetare, kur të thellohet e të përmirsohet është mâ e fuqishme – ose së pakut nuk është mâ e ligisht – se frika, lakmija e ziliya qi shkaktojnë lufta. Këjo vetëdije e ngrën njerinë në një shkallë shumë mâ të naltë se t'atyne qi duen të lavdohen e të preferohen për arsye të ngjyres, të gjakut, të pozitës, të klasës e të pasurisë. Këjo ka fuqi me shtypë mënin, cmirin e egoizmin. Feja ka pushtet me paksue magrurllëkun që shkakton pasunija; feja ka fuqi me lehtësue barën e vobegsis e me e paksue kryengritjen e varferisë.

Kjo vetëdije fisnikëron shpirtin e njeriut, e shtyn atë në dituni edhe e ban ignorancën dhe pasionin të pa shishme para tij. Feja e ka provuar që këto rezultate munden, me të vertetë, të arrihen në kondit qi faktorët tjerë mos të marrin pjesë. Është shkaku i kësaj të vertetë që njeriu fetar është inkurajuar të shpresojë për arritjen e atij qellimit të mirë ruajtur për shoknimit njerëzor. Sa do e vështir qi të jetë të kryemit te saj fetari do ta kryejn; por vetëm aq sa natyra e tij është e zonja të bejnë një mudi të këfillë.

VII.

Njerëzimi akoma përsërit n'imaginatën e tij atë konflikt të frikshëm dhe shumë të shëmtuar, shkaktuar prej ndryshimeve fetare – një konflikt në të cilin ndërgjegjia dogmatike fetar e pa mësueme kje një forcë e pa kujdes-shme dhe e pa mend qi tërhoqi njerëzin në violencë të tmershme dhe shkatëronjse. Njerëzimi shikon prapa me dëshpërim mbi civilizimin mijra shekujsh, i cili nuk e pruri atë aspak mâ afër qellimit, për vëllaznimin botnuer. Jo aq por edhe sot dëshpërohet për pakryemjen e tij. Mirpo, me gjith ketë, shpresa sqohet butërisht në zemren e njeriut fetar. Ky kupton se këto kujtime mundonjse dhe kjo largësi e hidhët e qellimit fisnik nuk janë nga shkaku i një mungese në vet-natyren fetare, porse në të vërtetë janë nga shkaku i sundimit të fakteve të forta të jetës mbi idalizmin e fës.

Jeta sundon fen kurse feja duhet t'a sundoj jetën.

Ketë sundim të pa merituar e kanë shkaktue ata njerëz të pandërgjegjshëm qi ndjenjën fetare e bânë vegël të pasioneve të tyne për me sigurue nevojat materjale të vetat.

Shkurt mund të themi se të ligat qi kanë ndodhën në shekujt qi ka sundue feja edhe të parelizuemit e shpresës së shpëtimit shpirtnuer nuk janë shkaktue nga vetë natyra e fës, por përkundrazi është përfundimi i të shtëmangunit nga ndjenja fetare.

Ligji i evolucionit natyral na shkoqit se mjerimet dhe mundimet e së kaluemes kanë qenë gjendja e nevojitun e shkallës së përparimit të mbritun në ato kohë.

Sod jeta me shkallën e saj qi ka mbri fiton të drejtë me përfitue nga vetëdija fetare për t'ju afrue qëllimit të desheruëm tue qenë të siguruëm nga rreziku i korupsionit e i largimit nga rruga e drejtë. Përparimi moral e mental ka mundë me bâ jo pak punë për të paksue efektin e shkaqevet të kundërshtimeve midis njerzís, të ashtuquajtura konsiderata fetare. Ky përparim tani vetëdijes fetare i ka dhanë një drejtim má të mirë e një manifestim i kësaj tendence është ky kongres i besimeve edhe përpjekjet qi bâjnë njerzit e fës drejt zhvillimit të shoknimit universal.

VIII.

Për ketë arsye oranzimi i këtij kongresi më kënaqi aqë shumë. Sepse ky kongres má tepër se përpjekjet qi bân për të studjue mjetet qi sigurojnë idealin e naltë njerzuer, i cili ideal është shoknimi universal midis individëve e popujve, përmbush edhe një qëllim themeltar të fevet, qëllim të cilit Islami – feja qi un ushtroj – i nep rëndësi të madhe.

Kurani flet për unitetin prinduër të njerzís i cili shkakton miqsinë, përkrahjen dhe ndihmën e përbashkët edhe largon mosnjoftjen, mosmarrëveshtjen e ngatresat. Kurani s'i ka dhanë ndonji vleftë fisnikërisë e lindjes, por ka stabilizue një kriter për të çmue vleftën e njeriut e ky kriter është "Takvaja – me i ndejtë besnik urdhnit të Zotit, me pasë frigë Zotin – kriter ky qi má para s'ka qenë i njoftun.

Në Kurantin e Naltë urdhënohet:

"O njerëz me të vërtetë ne ju kemi krijuë të gjith ju nga një mashkull e një femën, - prej Ademi e Havaës – edhe ju kemi bâ popuj e fise qi të njëfni shëshoqin e má i vlerëshmi ndër ju përpara Zotit është aj qi ka má shum takvá."

Kurani u kerkon muslimanëve të sillen bujarsiht kundrejt njerëzve të të gjith besimeve e feve për veç në kohë lufte.

Kurani urdhënon:

"Zoti nuk ju ndalon t'ju bâni mirë e të përdorni drejtësi për ata qi nuk ju luftojnë e nuk ju kanë nxjerë jashtë atdheut, me të vërtetë Perëndija i do të drejtet. Perëndija ju ndalon kundër atyne qi ju luftuen fën e ju nxorën prej atdheut edhe kanë ndihmuem në nxjerjen t'uej për t'u bashkue me ta e ata qi bâhen shok me ta janë keqbërës."

Këjo sjellje e mëshirëshme kundrejt popujvet të feve tjera qe praktikue prej Profetit të Madh Hazreti Muhammedit e prej khalifve të naltë e të mençëm e bile aqë është praktikue këjo sjellje sa qi është lejue edhe krushqija me popull të feve të tjera tue i u lanë liri të plotë bashkëshorteve qi të ndjekin ritet e fës së tyne.

IX.

Shoknimi midis njerëzve të fës lypset të precedojë

Shoknim Universal.

Mbassi shoknimi universal është një qëllim i dëshëruar, njerzit e fës duhet t'i drejtojnë forcat e tyne drejt zhvillimit të këtij shoknimi e të përmbliiden rreth realizimit të

tij me seriozitet e besim të plotë. Ky seriozitet duhet t'i drejtohet vetëdijes fetare, për të cilën kemi folë ma sipër edhe të përfitojë nga influenza e fuqishme që kjo vetëdije i bën shpirtit të besnikëve e nga gjanësija e qëllimit të saj si edhe nga instinkti që ka skalitë natyra në shpirt të njeriut. Këtu duhet me e fillue zhvillimin e shkollimit universal.

Plotsimi i këtij qëllimi të madh për vëllaznin universale e zhvillimin e saj mund të kryehet me anë të vetëdijes fetare të të gjitha feve dhe nëpër mjet të virtytit praktik e të parimeve të mira shoqërore që gjenden në çdo fë.

Në të gjitha fë gjenden principe hyjnore që shërbejnë për të mirën dhe dobën e njerzís e me këtë mënyrë çdo fetar duhet të jetë një organ i dobishëm për shoqëri. Duhet të përhapet ndjenja për t'u përpjekë për të mirën e njerzís e për t'ja largue të këqiat e kështu midis individualëve

me sigurie një lidhje e dashuní të ngushtë ashtu si dëshiron i Plotdituni Krijues që ngjall, vdekson, ushqen e mëshiron të pasurin e të vobegun, dhe atyne që kanë punue të mira j'u nep një jetë të lumtun mbas vdekjes.

Përpara apelit për zhvillimin e vetëdijes kolektive duhet të precedojë shoknimi midis kryetarëve të fevet, të cilët janë në një pozitë ma të mirë për t'a çmue më tepër vleftën e këtij qëllimi të naltë; ata janë më të zotët për t'a kuptue ma para se kushdo tjetër që rreziquet që mjerojnë njerzínë nuk rrjedhin prej ndryshimeve të feve e të besimeve por rrjedhin prej atheizmit e prej doktrinave materjaliste që shenjtërojnë e adhurojnë landën e që tallen me mësimet e hynjuëshme të fevet.²

(Vazhdon në numrin e ardhshëm).

2. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 10-11, viti XI, tetor-nëntor 1936, f. 293-312.

Abstracts in English

Islamic sciences

1. The Quran at the present time

Dr. Enes Karić

Faculty of Islamic Studies, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina

Abstract

It was impossible that the traditional method of commentary and interpretation of the Qur'anic thought could have a permanent value. It has been defined and conditioned by the circumstances of the specific time it was first revealed. The initial stages of elaborating, commenting, and applying Qur'anic thought - even if they were the most adequate possible - would have to account for the nature and level of the society at that period. Who would dare to assert that the Qur'anic thought - which is important for every time, place and situation although it is a divine word - regards to all times? Such a claim would be completely nonsense. Every historical moment takes from the Word of God as much as it needs at a given moment, according to the degree of social development.

Every generation must give its contribution to the elaboration of Qur'anic thought as long as they wish to live according its spirit and also seek from it to resolve the challenges that life - which is very dynamic – displays and consequently, facing in this permanent spirit the new problems and cluttered dilemmas encountered during the lifetime.

2. The need for the re-vitalization of intellectual-spiritual heritage

MA. Ervis Jangulli

Abstract

Modern and postmodern era have been built over some concepts, paradigms and worldviews. The modern era provides various challenges and problems in its structure. Even the Muslim society - if we are supposed to imagine it as a separate body - is facing many challenges. In the face of many contemporary problems, Muslim society must offer the cure and provide solutions for problems within the limits of the Islamic heritage. The illness of this century is the preponderance of a scientific-technological development based on the

materialistic and egocentric worldview, and at the same time, alienated from ethics and spirituality. The Muslim society is in an inferior position due to the lack of intellectually-spiritual heritage of Islamic tradition. Intellectual-spiritual heritage is an urgent need for Muslim societies in order to turn it into an important actor in providing solutions to the life's challenges.

This inheritance can be named as “passage of traditional Islam”, that is, of the primary sources of religion and the wealth of elaboration of these resources by thinkers, theologians, mystics, philosophers and wizards throughout the centuries. This not only prevents further downfall in the forts creates by radical or modern Muslims, but it also recalls a vision in Muslim societies to deal with the time challenges and ultimately acquire the true meaning of life in each individual. The ultimate goal of Islamic tradition is to achieve spiritual excellence to the individual.

Key words: modernism, science, revival, heritage, Islamic legacy.

3. The Concept of Reform in Islam **Haki Sahitaj, Bedër University**

Abstract

*Islam is a religion that has already turned into an important part of a wider society, and Muslims altogether bestowed to the entire world a great civilization, at a delightful speed and quality. From religious sciences to empirical ones, from art, music, literature, philosophy and methodology to architecture, Islam challenged all civilizations and time achievements. But today, Muslims have turned into a society that is regarded by all as backward, regressive, spiritually eroded and morally corrupted. Far from the great scientific achievements, Muslims are stuck in the theological self-criticism, in the enclosure of *ijtihad*; politically dependent and economically feasible. Since Islam as a religion was not born as a result of social factors, nor was it urged as an incentive for a culture, but it manifested in itself only an effort to live the new proclamation that was revealed during the time of Prophet Muhammad, this makes it (Islam) - with its own worldview - overcome time and space. And precisely due to this fact, Islam is not regarded anymore as a historical factor and its achievements are undermined; it is considered as a religion which had emerged long time ago and now is approaching its end, and which must accept other cultures, ideas and practices. Islam remains the law of God that is intended to be lived until the end, and it is precisely this worldview that has urged Muslim intellectuals to invoke reforms in Islam. But this divine word has sparked debates and crashes amongst many Muslims, as some even rejected it as such. The calls for reform in Islam are not lacking even by non-Muslim groups, such as orientalist, cognizers and critics of Islam who come from different academic circles. But this concept today - as well as many other concepts - lies within a terminological fog, such that it is difficult to decide what discourse about “reform” is involved.*

Studies

4. Mawlana Jalāl ad-Dīn Muhammad Rūmī Symbol of Love (I) Dorian Demetja, Muslim Community of Albania

Abstract

Although nearly eight centuries have passed since his time, Mawlana's messages never get old, still keeping their original freshness and vitality within us. Designed to convince people that they can do miracles through love, Mawlana has been studied for centuries by many universities and renowned researchers around the world. According to him, the divine love implies a mutual love: God's love for humans and humans love for Him. Such mutual love, between God and humans has a common nature, it is a light that shines everywhere and always, it represents the sincere light of existence and the invitation to existence in reality. According Mawlana, the paths that lead to the Creator are open to all who strive hard enough. The only thing to do is throwing away the treasures of this world in order to be enriched by the Lord's love. As he always emphasized, "Man needs two things: love and teared eyes".

5. An analysis of the works of Hodja Hasan Tahsin Burbuqe Meta

Abstract

Hodja Hasan Tahsin is regarded as one of the most prominent personalities of the Albanian world. He was the most knowledgeable and educated who helped a lot in spreading the knowledge, in the defense of the homeland and in the national affair. Hodja Tahsin is a personality that comes back through research and re-discovery. Indeed, he has never been forgotten, despite his name was merely mentioned as a wise man by his 19th-century contemporaries. He was the winner of many awards and hold many titles as well. Hodja Hasan Tahsin had two types of lives: his simple and almost ascetic life as a human between his birth and his physical death, and the life of his books and his intellectual work, which disregards the times and is in no way time-limited. The first life is the human temporality, the second life is his immortality. Hodja Tahsin is not a scholar of form but a scholar of content. He was a mature scholar, convinced that knowledge and science are, in substance, universally. This universality gives also a meaning to the today's term of globalization. Nobody among Albanians and his contemporaries, did not know the exact sciences like Hodja Tahsin. He is the greatest estimator of the exact sciences such as mathematics, physics and chemistry. The exact sciences constitute his true love and attribute – are exactly these sciences that comprise the "mental constitution" of his entire activity.

**6. Analysis of Salih Vucitern's articles in the
"Zani i Naltë" magazine
Zamira Islami, Bedër University**

Abstract

Albania has a very bright and exemplary past in terms of both intellectuals and imams domestic personalities. Many of them, in many respects, are today a source of inspiration. They were people who were formed in the schools of or country and abroad as well, and later their skills and energy poured over the Albanian society, where they became the promoters of many positive developments in this country.

Salih Vuciterni, was one of these outstanding personalities of our society. Through the intellectual background, vision and the knowledge he possessed, Salih Vuciterni played a very important role in the institution of the Muslim Community of Albania.

Key words: Religion, reform, institution, Islam.

History

**7. History of the Albanian personalities from Vilayet of Ioannina
(1859-1909)
Syrja bej Vlora**

Abstract

The book of Syrja bej Vlora "The story of the Albanian personalities from Vilayet of Ioannina (1859-1909)" is an encyclopedic work of an indisputable value for the Albanian historiography. This because firstly, it was the first attempt made on this issue, at a time when our scientific institutions were not established yet; and secondly, the information provided in it regarding some historical personalities constitutes a novelty.

In a footnote of the preface of the manuscript in Albanian regarding these biographies, the translator Jonuz Tafilaj writes that they were prepared as an annex to the work of Syrja bey Vlora previously translated by Ali Asllani. However, based on their volume, these biographies constitute a separate book. Therefore, given that they have not previously been integrated into any version of the already published book of Syrja bey Vlora, we are bringing it for publication for the first time in the scientific journal "Zani i Naltë".

This script is written in the Ottoman language and, together with the translation into Albanian, is found in the Central State Archive of Tirana. He has in total 78 pages in Ottoman and 120 pages in Albanian, translated by the renowned Orientalist Jonuz Tafilaj. In the inventory compiled by the head of the Ottoman manuscript sector in the historical archive, the orientalist Haki Sharofi, it is written the date of receipt of this translation (June 26, 1963). As for the time when it was written by Syrja bey Vlora, we still have no data.

Although this manuscript translation is in the northern (Gheg) dialect and contains a considerable amount of errors, we have tried to intervene only where it was indispensably necessary. This, because the dialects, in addition to the translations done in a given period, are a tremendous asset and bear the stamp of the time.

The book provides information on the most prominent personalities of Southern Albania, who, from an administrative point of view, were included in Vilayet of Janina at that time. Here is briefly written, and sometimes even longer, about the formation, role and contribution of the famous personalities of the Albanian world. Furthermore, in this book one can find a lot of details, which, given that they are written as an integral part of a memorial book, cannot be found in any other book. This enriches and makes it more beautiful to the reader, but also more valuable as a historiographical source for scholars.

Despite the level of translation and mistakes, we think that publishing this part of the book at the "Zani i Naltë" magazine, is necessary. This is a homage to the forgotten and unjustly anathemated author, to the honored translator, orientalist Jonuz Tafilaj and, finally, to Albanian historiography and memorialistics.

Dr. Hasan Bello

8. As-Sarahsi, Shamsul-aimmah (Sun of the scholars)

(D. 483 h./1090)

Dr. Osman Taştan

Abstract

Shamsul-aimmah As-Sarahsi was born around 400 h./1010 in a family of merchants, probably in Sarahs, a town between Mashhad and Marwi (in present-day Turkmenistan, near the Iranian border).

Sarahsi's writings include: al-Mabsut, al-Usul, Sharh as-Sierul-kabir, an-Nukat: Sharh Zijadati زجادات, Sharkh Muhtesar at-Tahawi, and Asbratus-sa'a. Most of these are systematic commentaries on Hanafi's earlier writings.

According to his biographers, As-Sarahsi dictated to his students the memories of Mabsut, Usul, and a large part of Sharkh as-Sieril-kabir, while he was imprisoned and without access to references. However, Schacht doubts this point, claiming that it is inconceivable that As-Sarahsi could have dictated his works to the others during the fourteen years of his imprisonment. For this reason, Schacht suggests that As-Sarahsi should have received substantial assistance from his students, including access to resources. This is possible, as we know that his students have collaborated with him in composing his works.

Sarahsi worked simultaneously, writing several works at the same time. He wrote several pieces of Mabsut before and some others after his work Sharkh as-Sierul-kabir. The fact that he often refers to the Mabsut chapters in his work "Usul" is an indicator that he wrote Usul after completing Mabsut. With the actual information we have, it is quite impossible for us to prove an exact chronology of his works.

Personality

9. Sheikh Ibrahim Karbunara (1879 - 1947)

A cleric, patriot and politician fucilated by the communist regime

Abstract

Sheikh Ibrahim Karbunara was born in Karbunara village near Lushnja in 1879, at a noble family with patriotic background. He received the secondary education at Berati's madrassa, where he was noted as an excellent student. Then went to the high school of theological studies in Istanbul where he received a full-time, high-level education degree as a clergyman, also knowing five foreign languages: Arabic, Ottoman, Persian, English and French, and equipped with a vast contemporary culture.

Retrospective

10. New Initiatives for Cooperation between Religions

Abstract

Since universal friendship (fellowship, brotherhood) is a desirable goal, people of faith must guide their forces towards the development of this companionship and summarize its accomplishment with seriousness and full confidence. This seriousness must address the religious consciousness – for which we have discussed to - and benefit from the powerful influence that this awareness has to the spirit of the faithful and from the legacy of its purpose as well as by the instinct that skins the nature of the human beings soul. It is necessary to start from here the development of a universal fellowship.

The accomplishing of this great goal for the universal brotherhood and its development can be done through the religious awareness of all religions as well as through the practical virtue and good social principles found in each religion.

In all religions there are many divine principles that serve the good and the benefit of mankind and therefore, every religious should be a useful social organ.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.